

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

92

B21

ETA E

JEANS  
NOLIT


VEHBI BALA

2  
103  
21

VEHBI BALA

JETA  
E  
FAN S. NOLIT

(Portret — monografi)



SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT POLITIK

## PARATHËNJE

*Historia vonon po nuk harron. Dhe gjyqi i saj i pamëshirshëm është i tillë, që ndan e vë në anë të kundërta edhe ata njerëz që në të gjallë të tyre pandehnin se kanë qenë shokë armësh dhe mendimesh në fushën e patriotizmit dhe të përparimit. Në një shënim tepër dhelparak shkruar për Nolin nga Faik Konica, intelektuali kozmopolit dhe pa parime të qëndrueshme e vinte veten pranë dhe krah për krah Nolit dhe kundërshtimet e tyre të gjata politike dhe në patriotizëm e kulturë i konsideronte si çaste të shkurtëra mospajtimi, si ato pauzat dhe grindjet te «heronjtë e Homerit që shkëmbejnë fjalë të ashpra, pastaj bashkohen, si më parë. . .» Dhe më tutje e kaptandis vlerën e Nolit në disa thërmokla, si «i ditur në muzikë, . . . si burri që arriu i pari të kllasi zyrtarisht gjuhën shqipe në meshë. . .»*

*Për ne sot, kur Fan Noli ka mbushur 90 vjeç, që nga dita kur lindi, ai është larg çdo ngatërrese e lero-sjeje me njerëz të tillë që e kultivonin kulturën për të fituar para dhe pozitë.*

*Noli mbeti tërë jetën e tij një kalorës shqiptar, një «kalorës i Skënderbeut», siç e quante ai veten, dhe ashtu si çdo luftëtar tjetër i denjë i Skënderbeut sa-*

krifikoi gjithshka për Shqipërinë dhe shqiptarët. Noli «është një botë e tërë», një jetë e tërë me ngjyra shqiptare dhe me puls shqiptar. «Pishën e tij Noli e ndezi tamam në ato vite kur vdiq Naimi», po ai shkoj shumë më larg se idealet dhe realizimet e Rilindjes. Ai i pasuroi vlerat ideore dhe estetike të popullit tonë, bibliotekën shqiptare me një ngulm të jashtëzakonshëm, duke i nisur krijimet dhe veprimet në të mirë të kulturës dhe të popullit tonë pa i mbushur të njëzet vjetët dhe duke mos i ndërprerë ato gjatë tërë jetës. Fan S. Noli është së pari një personalitet i rëndësishëm politik, një nga udhëheqësit më të avancuar e më të vendosur të lëvizjes patriotike dhe demokratike shqiptare në të gjithë dhjetvjeçarët e parë të këtij shekulli. Qysh në nisje të këtij shekulli e deri në mesin e viteve tridhjetë historia jonë është e mbushur me përpjekjet e tij të mëdha për të vënë në jetë aspiratat dhe ëndërrimet e rilindasve tanë. Si burrë shteti dhe ideolog, si udhëheqës veprimesh konkrete historike dhe si përfaqësues i vegjëlise demokratike shqiptare Noli luftoi krah për krah patriotëve dhe demokratëve më të mirë të popullit tonë në një nga periudhat më të koklavitura të kombit tonë. Me gjithë momentet e ngurrimit dhe të paqartësisë së përkohshme politike, Noli luftoi me konsekuencë për përparimin e kombit dhe të popullit tonë. Për më shumë se njëzet vjet ai priu në luftën kundër forcave më të vjetra shoqërore, kundër feudalizmit dhe marrëdhënjeve ekonomike feudale-mesjetare, kundër të gjithë përfaqësuesve të klasave të pasura që e kishin shitur veten e tyre plotësisht tek të huajt. Noli luftonte njëherazi për forcimin e pavarësisë kombëtare që aq shpesh u vu në rrezik dhe për vendosjen

e një regjimi politik e social shumë më të përparuar. Si një luftëtar demokrat ai u vu në krye të masave në Revolucionin domokratik-borgjez të vitit 1924 dhe fitoi një simpati të madhe në shtresat e thjeshta të popullit. Edhe pas dështimit të atij revolucioni, dështim që e ndjeu shumë thellë, ai u vendos pa hezitim në krahun revolucionar të emigrantëve politikë dhe vazhdoi të demaskonte me shumë guxim klikën reaksionare që erdhi në fuqi. Për vite me radhë ai qe kryetar i Konares dhe i Komitetit të Clirimit Nacional. Në ato vite ai u radhit në armatën e intelektualëve përparimtarë e antiimperialistë evropian dhe afirmoi me optimizëm sukseset e Bashkimit Sovietik.

Noli mbeti një njeri politik në të gjitha fushat ku derdhi kontributin e tij.

Pa Nolin kulturës dhe letërsisë sonë do t'i mungonte një gjymtyrë. S'ka shqiptar të këtij shekulli që të mos ketë jetuar sado pak me Nolin. Noli (poliedrik është si një lumë i madh degëshumë që e shpërndan ujin e tij të bollshëm nëpër të gjitha fushat e mendimit, shoqëror shqiptar. Ta kuptosh e ta vlerësosh atë në të gjithë këtë poliedër do të duhej të studjosh të gjitha kontributet që ka dhënë ai në këto fusha. Ndryshe ai mbetet gjithmonë i pazbuluar deri në fund.

Personalitetin njeriu nuk mund ta krijojë vetëm me forcat e tij të brendshme. Lypsen doemos edhe disa kushte shoqërore. Po kur këto nuk janë është doemos një meritë shumë e madhe që njeriu me mundin e tij të jashtëzakonshëm përpiqet dhe ja del që ta ngrerë veten në lartësi të tilla sa ta gjykojnë jo vetëm bashkatdhetarët e tij, po edhe të

huajt. Në këtë pikëpamje ai është si ato majëmalet e larta, vigane që zotërojnë mbi një hapësirë të tërë gjeografike dhe vështrohet nga të gjitha pikat dhe nga distanca të largëta. Po gjithmonë ky mal është më i dukshëm e më i qartë në hapësirën përreth. Për shqiptarët Noli është një mal që shikohet me sy të lirë. Ai është i qartë, i kuptueshëm, i afërt.

E tërë jeta dhe aktiviteti i Fan Nolit dëshmojnë për një gjë shumë të rëndësishme; njerëzit që i venë gjithmonë pas progresit të popullit të tyre kuptohen gjithmonë nga ky popull dhe rrethohen nga një dashuri e zjarrtë. Ata rriten edhe vetë nëpër hapat e këtij progresi dhe kjo rritje do të shfaqet doemos në të gjitha krijimet e tyre.

Noli artist dhe Noli njeri politik janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin. Vlerat e tij të mëdha kulturore dhe artistike janë të lidhura me përjetimet e tij historike. Te Noli ka shumë pak krijime të shkruara për qejf. Fjala e tij kudo e ngado, në poezi dhe në fjalime, në përkthime dhe në artikuj «shërbeu më shpesh si ajo e një Tirteu». Çdo krijim i Nolit, veçanërisht deri më 1932 (vit në të cilin siç e thotë edhe vetë në autobiografi «u tërhoq nga jeta politike»), ka veç vlerave të tjera një qëllim të dukshëm politik. Po politika nuk e vrau kurrë artistin Noli. Përkundrazi. Sa herë që Fan Noli kthjellohet politikisht apo merr pjesë në veprime aktive revolucionare, bëhet më i fuqishëm, më konsekuent, më toksor, më shqiptar edhe në artin e tij. Këtë e dëshmojnë sidomos poezitë, fjalimet, introduktat dhe përkthimet e tij aq në funksion të ngjarjeve të kohës. Te vepra e Nolit qartësia politike është një kusht shumë i rëndësishëm për ripërtëritje artistike. Ngjarjet sho-

qërore derdhin në shpirtin e tij artistik emocione të jashtëzakonshme. Në themel të sensibilitetit të tij si artist qëndron sensibiliteti i tij si njeri shoqëror. Krijimet e tij artistike janë më së pari përjetime të thella politike. Jeta intime është e përzier tek ai kudo me jetën shoqërore. Dhe çdo tentativë për t'i ndarë ato dështon. Asgjë nuk shkruhet prej Nolit, po që se më parë ai vetë nuk ka një masë të mjaftueshme mbresash, faktesh, të vërtetash jetësore dhe sensibiliteti. Është për këtë arsye që në çdo fushë ai derdh e shpraz dupe shpirtërore, buçima fjalësh që kanë gjithmonë një bukuri dinamike. Fjalët e Nolit kudo që ato shprazen janë të rënda si masa protonesh. Noli është shkrimtar dhe artist që ka pushtet absolut mbi fjalën. Fjalët vetë aty ku vihen bëhen edhe ato të gjithëpushtetshme dhe s'mund të lëvizin. Sepse ato nuk lidhen me njëra tjetrën nga fqinjësia apo nga rendi sintaktik, po së pari nga rrjedha logjike nga rëndësia reale, nga situata, nga dufi i poetit, dhe përveç këtyre nga një harmoni akustike që nuk është kurrë qëllim formal. Forca e Nolit qëndron në gërshetimin e këtyre të gjithave. Rrëkeja e mendimeve të Noli ndiqet pothuajse gjithmonë nga një gurgullimë tingujsh, «nga një shtërngatë fjalësh shqiptare». Këtë kërkesë estetike Noli e ka mishëruar më shumë se çdo artist i yni. Po Noli asgjekundi nuk është poet formalist. Forma e tij e përsosur shkëlqen më e fortë se kudo në tipin më të lartë të krijimeve të tij: në poezitë politike, në vargjet e tragjedive dhe të përkthimeve të tjera, në ligjëratat e tij jo efektuoze po realiste. Noli asnjëherë nuk e mpak fuqinë e mendimit për hir të harmonisë së tingujve dhe fjalëve. Sepse mendimi për të është gjithmonë themelori. Po men-

dimi pa formën e ujdísur është për Nolin artist, si një daltë pa majë apo me majë të deformuar që as çan as gërryen gjëkundí. Sínteza e lartë e përmbajtjes dhe e formës është një apogje i artit dhe i kulturës shqiptare, një apogje i ngritur fill dhe shumë shpejt pas pesë shekujsh prapambetjeje dhe stanjacioni.

Noli është po aq poet sa në krijimet origjinale edhe në fragmente përkthimesh. Ka të drejtë të plotë Dh. S. Shuteriqi kur pohon se rrallë vend në botë mund të krenohet me përkthime të tilla të veprave të Shekspirit siç i kemi ne në shqipe prej Nolit. Me përkthimet e tij madhore Noli demonstroi praktikisht në ato kushte dhe nivele të zhvillimit tonë kultural dhe artistik se gjenitë e njerëzimit janë të denjë dhe të kapshëm për popullin shqiptar. Se qysh në ato kushte Shqipëria dhe shqiptarët janë të etur për gjenitë dhe vlerat më të mëdha njerëzore. Në përkthimet e tij Noli është një luftëtar revolucionar. Noli përkthyes apo shqipërues është një shembull i madh. Në vitet e fukarallëkut të tmerrshëm shqiptar, të fukarallëkut ekonomik dhe kultural, ideologjik dhe letrar Noli vinte në bibliotekën shqiptare Khamamin dhe Shekspirin, Servantesin dhe Ibsenin, Hygonë dhe Ibanezin dhe përgatite kështu shtratin për t'u derdhur në shqipe përkthime të shumta dhe madhore. Në errësirën dhe injorancën e viteve të pavarësisë Noli me guxim llamburiti para shqiptarëve me drita shumë të forta, pa pasur frikë se mos nga kjo dritë e shumë të verbonte shqiptarët. Në këtë pikëpamje guximi i tij krijues si përkthyes militant është një shembull i madh.

Përkthimet e Nolit janë krijime popullore. Popullore në kuptimin e dyfishtë: në idealet që përm-



bajnë dhe në petkun me të cilin janë dhënë. Noli tregoi me to se kultura dhe arti botëror mund të tregohen në Shqipërinë e sapodalë nga gjumi dhe robëria. Ku e pat sigurinë Noli për një veprim të tillë? Te njohja e thellë e shpirtit dhe e potencialit shpirtëror të popullit tonë. Ai ishte një fshatar shqiptar dhe me këmbëngulje arriti në majat e larta të diturisë njerëzore. Përse t'ja mohonte këtë forcë popullit nga kishte dalë?

Në përktimet e tij ashtu sikurse edhe në krijimet origjinale të habit jo vetëm gjerësia kulturale po edhe pasuria dhe energjia e fjalës shqipe. Kur lexojmë Nolin dhe kemi parasysht qëndrimin e tij shumë të paktë në Shqipëri na lind me të drejtë pyetja se si ka arritur ai ta njohë kaq thellë shqipen. Megjithëse Fan Noli qe një «bir i mërgimit tragjik shqiptar», tërë jetën e pat mëndjen dhe shpirtin te Shqipëria. Ai e përvetësoi shqipen përmes jetës së gjallë praktike qysh në moshën e fëmirisë dhe të rinisë së parë. «Për Fan Nolin nuk kishte pushim... Ai i mësoi mësimet gjatë tërë jetës» po e mësoi më shumë akoma përmes qëndrimit të tij shumë aktiv në dekada të tëra. Dashuria e thellë për gjuhën amtare përbën një nga ato pasione që janë gati të përjetshme në jetën e Nolit.

Ç'tregojnë të gjitha përktimet e Nolit dhe zelli i tij i përhershëm për të mësuar gjithmonë dhe nga çdo vend? S'ka poezi të madhe pa kulturë të madhe. Sensibiliteti i hollë artistik dhe pikëpamjet e vërteta progresive lindin dhe pasurohen duke njohur vlerat ideore dhe estetike kombëtare dhe ndërkombëtare. Noli i mbledh dhe i nxjerr këto vlera nga sferat më të ndryshme. Nga jeta dhe nga historia. Po vlerat më

të mëdha ideore dhe estetike që ka krijuar ai janë nga jeta dhe historia shqiptare. Noli mbeti shqiptar edhe kur gjykoi botën. «Një artist shqiptar gjykoi dhe gjykoi drejt, një artist të madh të botës», te «Betoveni dhe revolucionin frëng». Vetë titulli i këtij libri është një konceptim i mrekullueshëm dhe shumë materialist. Noli ynë e lidh jetën dhe krijimtarinë e gjeniut më të madh të muzikës botërore me revolucionin më të madh që qe kryer gjer në atë kohë. Po nuk e kemi fjalën këtu. Duam të vemë në dukje diçka tjetër. Fan Noli doli në arenën ndërkombëtare pasi kishte sprovuar forcën e tij në truallin amtar. «Ai që s'i përket atdheut të tij s'i përket as njerëzimit» thoshte Belinski. Noli i përkiste thellësisht vendit të tij. I përkiste në të gjitha për gati tre çerek shekulli: në mjerimet dhe gëzimet, në luftrat dhe tragjeditë, në fitoret dhe përparimet, në lëvizje dhe në stanjacion. Dhe sprovoi të zgjidhte disa nga problemet më të mëdha të vendit të vet. Nuk mund të kuptohen vlerat e huaja, pa njohur vlerat e tua kombëtare. Një nënë që s'do e s'njeh fëmijtë e saj, vështirë se mund të kuptojë ata të botës.

Noli trokiste te bota me dorën e popullit shqiptar, vështronte te bota me sytë e shqiptarëve dhe prandaj ai është gjithmonë i kuptueshëm për popullin tonë.

Në introduktat dhe në studimet e tij pa zbehur për asnjë çast kuptimin e tyre të gjerë, Noli përpiqet të përcaktojë edhe lidhjet që ato mund të kenë në vendin e tij dhe me realitetin bashkëkohor. Prandaj introduktat e tij janë tërë nerv politik, tërë sfida dhe pohime të vërtetash të ndaluara nga koha kur i shkroi, ashtu siç janë edhe plot kulturë dhe shije të

lartë estetike. Kudo te Noli kultura e tij e gjerë i nënshtrohet me shumë koshiencë synimeve të larta të patriotit dhe demokratit revolucionar. Noli mbetet edhe sot e gjithnjë kritiku i parë shqiptar që ballafaqonte jetën me veprat, që e shikonte letërsinë të lidhur shumë ngushtë me detyrat imediate politike të shoqërisë. Dhe kjo gjë nuk i dha veprës së tij karakterin pragmatist. Shumë pak gjëra të panevojshme ose të dëmshme i shpëtuan në këtë fushë sitës së dendur noliane. Si kritik Noli ka një racionalizëm të fortë nacional. Ai është armik i artit anadollak por nuk përbuz asgjë të vërtetë kombëtare. Është krejt i kundërt me kritizerin Konica që gjoja nga «lartësi të mëdha estetike» i shoqti Shqipërisë çdo vlerë e traditë letrare dhe kulturele, i ktheu ato në thërmokla. Te vepra e Nolit tradita merr frymë lirisht. Po ajo traditë të cilën e do ende koha dhe zhvillimi.

Noli është një poet i madh novator por gjithmonë mbi një bazë të fortë kombëtare. Klimatet e ndryshme kulturele ashtu si edhe tek De Rada dhe Naimi edhe te Noli nuk e mposhtin atmosferën shqiptare. Në fushën e krijimeve artistike, ai është një agronom praktik aq sa edhe një bujk me përvojë që sharton drunj, bimë, farëra, lule, po ama ruan gjithmonë cilësitë e shëndetshme të llojeve të veta dhe i mbjell e i provon të gjitha ato te trualli i tij amtari. Nga absorbimi serioz që ai i ka bërë kulturës së huaj kuptojmë shumë gjëra. Progresi kombëtar është i lidhur gjithmonë me progresin ndërkombëtar. Nuk mund të ketë një ndërgjegje të vërtetë demokratike nacionale pa njohjen dhe absorbimin e vlerave progresiste internacionale. Nuk mund të ketë progres të vërtetë nacional dhe shoqëror që t'i takojnë vetëm

një populli. Nuk mund të ketë një emancipim të plotë nacional pa njohur dhe absorbuar edhe vlera të progresit internacional. Po bërthama kombëtare mbetet gjithmonë më e rëndësishmja. Vetëm mbi ekzistencën e kësaj bërthame mund të shtohet diçka tjetër.

Progresi shoqëror është hambari themelor ku ushqehet Noli. Praktika e tij krijuese na bind e na dëshmon për një gjë të rëndësishme: nuk mund të ketë progres shoqëror që të mos përmbajë vlera të reja ideore dhe estetike. Në çdo lëvizje shoqërore ku ka progres lindin edhe vlera kulturele dhe estetike. Dhe artisti që shoqëron këtë proces dialektik të jetës përfton doemos edhe ai vetë ndryshime pozitive. Edhe brenda kufive të pak viteve Noli shfaqet para nesh me ndryshime të thella dialektike. Poezia e tij është një pasqyrë e plotë e këtij procesi disa dekadash.

Megjithëse edhe ai si shumë patriotë të tjerë u ngjante «zoqve të shpërndarë nga tramundanat» u integrua shpejt në lëvizjen patriotike dhe kulturele shqiptare dhe për tri dekada rresht shprazi papushuar gjyle të rënda mbi çifligarët, kolltukofagët dhe sulltanët e kohës, mbi të gjithë larot dhe këpushat që i thithnin gjak popullit.

Tri dekadat e para të këtij shekulli janë të mbushura me luftën e Nolit si demokrat revolucionar dhe patriot i zjarrtë, si udhëheqës kultural dhe shpesh politik, që u përpoq të qëndronte sa ma afër popullit. Në këtë luftë ai shpesh pat edhe kufizime dhe inkonsekuenca disa herë dhe të rëndësishme. Por esenca e Nolit nuk është këtu. Tërë jetën ai u mundua të mposhte dobësitë e veta dhe me gjithë kufizimet që

i mbetën afirmoi fitoren e Republikës tonë dhe i dhuroi asaj qysh në fillim «Albumin», perlat e krijimtarisë së tij.

Noli është një përfaqësues poliedrik i kulturës sonë. Në çdo fushë ku shkeli la gjurmën e tij. Fushat ku ai shkëlqen janë të shumta dhe përbëjnë që të gjitha tradita të kulturës dhe të arteve tona. Noli është historian dhe poet i madh. Ai solli pikëpamje të reja shoqërore në letrat tona. Poezia e Fan Nolit është në thelbin e vet një poezi tribunale, politike, qytetare. Noli e ngriti vjershën tonë në tone madhore, patetike. Poezia e tij është e mbushur me shpërthime të vërtetash historike që kanë dalë nga ngjarjet më të mëdha të popullit. Poezia e tij është tërë tonalitete të larta, me gjerësi mendimesh dhe idesh. Veçanërisht vjershat e Nolit pas vitit 1924 mund të quhen një biografi në vargje e një revolucioni demokratik-borgjez. Në to shohim rritjen e Nolit si ideolog dhe poet. Vjershat e tij të fundit pohojnë gjëra që ai nuk i bëri dot në atë revolucion, po që duhet t'i bënte. Lëvizja antifashiste dhe komuniste evropiane dhe përvoja e tij historike i hoqën Nolit shumë pikëpamje idealiste dhe kufizime. Ai erdhi gjithmonë duke u rritur. Dhe erdhi deri te «Rend or marathanomak» dhe thirrja e tij për dhunë klasore revolucionare «Ngrehuni dhe bjeruni — katundarë e punëtorë!...»

Inisiativa e shokut Vehbi Bala për të shkruar këtë portret monografi të parë duhet përgëzuar, aq më tepër që autori është munduar të hulumtojë materiale të panjohura më parë dhe t'u hedhë një vështrim tërë visareve noliane. Me pasion prej shkrimtari dhe studentuesi ai është munduar të grumbullojë sa më shumë të dhëna e materiale të shpërndara andej këndeje, ose

të panjohura për lexuesin e gjerë. Studimi i katërcip-  
të i veprës së Nolit mbetet detyrë e përhershme. In-  
teresimi për figurën e Nolit është rritur shumë bren-  
da dhe jashtë Shqipërisë. Duhet kontributi i shumë  
studjuesve nër fusha të veçanta të krijimit të tij dhe  
pastaj doemos një analizë e sintezë më e plotë. Ky li-  
bër është një nismë e mirë e kësaj pune.

Qershor 1972

**Adriatik Kallulli**

## KAPITULLI I PARË

### NGA QYTEZA E EDRENESEË NË ATHINË

Në agimin e shekullit XX, një djalë fshatar nga Qyteza e Edrenesë niset të bëhet «Kalorës i Skënderbeut» në gjirin e popullit shqiptar.

Theofan Stilian Noli lindi më 6 janar 1882 në Ibrik-Tepé, shqip Qytezë, fshat shqiptar në Trakë, jo shumë larg nga Edreneja.

Qyteza dhe katër fshatrat e tjera shqiptare të atij rrethi<sup>1</sup> kishin ruajtur me kohë gjuhën, doket, zakonet dhe kostumet e të parëve. Ka shumë të ngjarë që të parët e tij dhe të bashkëfshatarëve të jenë shpërngulë nga Qyteza e Kolonjës dhe të jenë vendosë në Ibrik-Tepé. Noli gjithmonë do ta mbajë veten me prejardhje shqiptare dhe pikërisht nga Qyteza e Kolonjës<sup>2</sup>.

I ati, Stilian Gjergj Noli, ishte psallt në kishën e vogël ortodokse të fshatit; e ëma, Marie Gollaqi,

15


ishte shtëpiake. Theofani erdhi i dyti i trembëdhjetë fëmijëve, nga të cilët pesë ishin djem dhe tetë çupa. Shtatë prej fëmijëve vdiqën pa u rritur mirë. Familja rronte me tokat që kishte si pronë. Me mall e nderim do ta kujtojë Noli atë rreth shqiptarësh të fshatit të lindjes, edukimin shqiptar që mori nga gjyshe Sumba, Kapedan Gerda dhe Xha Tasi. Portretet e këtyre tri fytyrave shqiptare që pikëzoi ai më vonë na japin një përfytyrim të qartë të qëndresës me gjuhë, zakone e kostume shqiptare, mu në zemër të Turqisë. «Gjyshe Sumba kapej me fanatizëm pas kostumit të saj shqiptar, që vishet në malësitë e Shqipërisë Jugore akoma sot e kësaj dite, sidomos në Dardhë, afër Korçës dhe në krahinën e Lunxhërisë, pranë Gjirokastrës. Ajo e kishte zakon ta qepte vetë, në atë modën e saj të vjetër, çdo pjesë rrobeje që mban-te. Kishte zakon të vishte një fund, në trajtë këmbane, që mbahet akoma sot në të gjithë malësitë e Shqipërisë, veçanërisht në Veri. Ajo nuk kishte pranuar të vishte rrobat turke, të qepura me coha të endura në fabrikë e që kishin qenë pranuar nga të gjitha gratë e reja dhe elegante të fshatit<sup>3</sup>». Gjyshe Sumba, vazhdon ta përshkruajë autori, ... «Ishte e para që fillonte vallet piktoreske popullore, në të cilat ajo shquhej mbi të gjitha, bile dhe kur u bë shtatëdhjetë vjeç grua. Tundte shaminë, këndonte, hidhej përpjetë dhe vinte rrotull sikur të ishte e re, pa mbushur të njëzetat. . . Këto valle shqiptare ajo përpiqej vazhdimisht t'ja mësonte nipit të saj, Theofanit». 4) Por këto valle, aq të ndërlikuara dhe të shpejta, qenë për Theofanin e vogël, ende të brishtë, shumë të rënda e lodhëse, sa ky, pasi kërcente dhe rrotullohej një copë herë, e marrur mendësh, lëshohej dhe binte në



shesh. Atëhere, gjyshja arriti në përfundimin «se, hëpërhë, do të kishte qenë më mirë që t'ja ndërpriste mësimet e saj të vallëzimit».

Një edukator tjetër i Theofanit të vogël në edukimin shqiptar ka qenë kapedan Gerda, një burrë që ruante me fanatizëm, si gjyshe Sumba, krenarinë e kombësisë së vet. Ai dinte, rrëfen Noli, historitë e dynjasë, ndiqte shfaqjet, që jepeshin nga nxënësit e shkollës së fshatit dhe që kishin në program këngë e lexime vjershash nga klasat e ndryshme, greqisht. Kapedan Gerda, që nuk e zotëronte greqishten «... përherë ngrihëzj në këmbë në mes të shfaqjes dhe protestonte me zë të lartë: «Shqip, or shqip!» që do të thoshte «Në shqip!» Na jepni një shfaqje shqip! Në mos po, do mos kuptojmë dot asnjë fjalë». Pjesa më e madhe e publikut i mbante krahun kapedan Gerdës, sepse as ata nuk kuptonin fare greqisht. «Kjo gjë i kujtonte kurdoherë Fan Nolit të ri se atyre djemve shqiptarë u duhej mësuar shqip e jo greqisht». <sup>5</sup>.

Edukatori i tretë ishte Xha Tasi, biri sakat i gjysh Mitrushit. Noli e përshkruan Xha Tasin si njeri të pazotin për punë bujqësie, por të zellshëm për të lexuar libra dhe për të mbajtur bibliotekën më të madhe në të gjithë fshatin. Ky burrë e tërhiqte Theofanin e vogël me librat që kishte, sidomos me veptrat që përshkruanin figura të ndryshme, siç qe një «Histori e Skënderbeut» greqisht. Djali i lexonte me etje të madhe ato libra, aq sa erdhi dhe u dobësua mjaft, duke e trishtuar shumë nënën. Noli tregon për vete: «Një ditë, djali qe shtrirë barkas mbi sixhade, bërrylat mbështetur në dysheme, librin mes tyre, dhe qe zhjytur në lexim. Nënë Muria po e vinte re me një shprehje trishtimi në fytyrë. Ajo tundi kokën dhe



i tha: «Më vjen keq, mor biri i gjorë, por nuk është faji yt. Faji është tërë i imi. Se unë të mora në krah e të shpura në shkollë. Por nuk më shkonte ndër mend kurrë që shkolla do të të shkatërronte kështu siç po të shkatërron»<sup>6</sup>. Xha Tasi i ushqente djalit të vogël jo vetëm dashurinë për librat, por edhe për Shqipërinë dhe historinë e saj të lashtë. Ndërsa i jati Stilianit, i mburrte Napoleon Bonapartin, Xha Tasi Gjergj Kastriotin. «Nuk kam ndër mend aspak të kritikoj babanë tënd, — i tha një ditë Xha Tasi Theofanit, — po unë, personalisht, mendoj që, kur të kesh për të marrë ndonjë vendim, ti nuk duhet ta pyesësh veten: «Ç'farë do të bënte në këtë rast Napoleoni?» po duhet ta pyesësh: «Ç'farë do të bënte Skënderbeu?» Sepse ai ishte shqiptar dhe do të bënte ato, që do të qenë për të mirën e Shqipërisë e të popullit shqiptar. . . Napoleoni i korri fitoret me një ushtri të madhe, të cilën ai e trashëgoi nga paraardhësit, kurse Skënderbeu i korri fitoret me një ushtri të vogël, të cilën ai e krijoi vetë. Jo vetëm kaq, por ai luftoi kundër dy sultanëve të mëdhenj, që udhëhiqnin ushtritë më të mëdha të asaj kohe»<sup>7</sup>. Ky vlerësim i Xha Tasit për Skënderbeun ju ngulit djaloshit në mendje si një mësim i madh në edukimin e tij shqiptar dhe, që atëherë, Fan S. Noli vendosi të bëhej «kalorës i Skënderbeut» në gjirin e popullit shqiptar. Brenda familjes, Fan S. Noli nuk shpëtoi pa telashe të ndryshme. Ai kujton nga ajo kohë grindjen midis atit të tij, Stilianit, me gjysh Mitrushin dhe Xha Tasin për punën e disa tokave, gjë që shkaktoi prishjen e tyre dhe largimin e Stilianit me gjyshe Sumbën, nënë Marien, vëllanë Dhimitër dhe motrat, për t'u ngulur në një shtëpi tjetër. Por Theofani i mbajti vazhdimisht lidhjet shpirtëro-

re me shtëpinë e vjetër, ku qe lindur dhe rritur, ku vazhdonte të banonte gjysh Mitrushu me Xha Tasin. Gjyshi e priste krahëhapur dhe, kur ky ndodhej në punë nëpër ara, ishte xha Tasi ai që e tërhiqte në shtëpinë e vjetër me librat e vet magjepës.

I jati, Stiliani, psallti simpatizues i Napoleonit, ishte më i përmbajtur ndaj të birit, kurse e ëma, Maria, e trishtuar për shëndetin e dobët të të birit, ishte më e dhënë pas tij. Nga i jati, ndër të tjera, Theofani i vogël mori elemetet e para të muzikës, që do t'i vlejné më vonë për t'ju vënë këtij arti me passion dhe zell; nga e ëma, ai fitoi ndjenjat e holla, që do t'i shfaqen sidomos në veprat lirike të së ardhmes.

Në Qytezë, Fan S. Noli qëndroi deri më 1900, d.m.th. deri në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare. Në fshatin e lindjes ndoqi shkollën fillore greqisht për shtatë vjet me radhë. Në atë shkollë kishte hyrë tetëvjeçar, për shkak të një sëmundjeje që kishte hequr në femini. Aq i dobët vinte nga shëndeti, sa prindët, në një rast që u sëmur rëndë, e humbën fare besimin se do të jetonte më. Thuhet se vogëlushi, në fillim, kundërshtoi të shkonte në shkollë, sepse kishte frikë nga një mësues grek, që i rrihte nxënësit, sipas disiplinës skolastike të kohës. E ëma, e dëshiruar që i biri të bëhej nxënës i rregullt, e hodhi në krah dhe e çoi në klasë me pahir. Pasi kreu filloren në Qytezë, prindët e dërguan në gjimnazin grek të Edrenesë, ku qëndroi katër vjet. Pushimet verore i kalonte në Qytezë. «Grekët — shkroi më vonë Fan S. Noli — i konsideronin të gjithë të krishterët ortodoksë të Perandorisë Turke si grekë, pavarësisht racës dhe gjuhës së tyre. Për këtë arsye edhe mësonjësit grekë përpiqeshin t'i bënin patriotë grekë të gjithë nxënësit or-

todoksë, që ata kishin nëpër shkollat e tyre. Si ndodhi atëherë që Fan S. Noli, i cili kishte ndjekur për shtatë vjet shkollën fillore greke dhe katër vjet gjimnazin grek, mbeti një djalë fshatar shqiptar, si për inat të të gjithë këtij edukimi grek?»<sup>8</sup>. Noli e spjegoi këtë me edukimin shqiptar që mori në gjirin e familjes e të farefisit, në mjedisin fshatar të Qytezës, nga traditat e ruajtura shqiptare, nga librat e historisë së të parëve. Përballë këtyre «mësuesve» shqiptarë, dhaskenjtë grekë i dukeshin tepër të vegjël.

Në gjimnaz, ai erdhi në kontakt me letërsinë e pasur klasike greke, nga e cila do të ndikohet në formimin e stilit të tij letrar, dhe pjesërisht me letërsinë europiane, sidomos me veprat e Shekspirit, nga i cili do të shqipërojë me shije të rrallë katër tragjedi. Që në bankat e shkollës u shfaq karakteri i tij i pavarur dhe shpirti i tij i revoltës. Tek ndiqte gjimnazin, mori pjesë në një grevë nxënësish. Në vitin e fundit, drejtoria pushoi nga puna, pa të drejtë, një nga mësuesit e shkollës. Noli organizoi një demonstratë nxënësish, për të përkrahur mësuesin e pushuar dhe për të kundërshtuar vendimin e drejtorisë. Drejtoria, në shenjë ndëshkimi, nuk ja dha Nolit dëftesën e pjekurisë në qershor, por në shtator. Me këtë shkak, zyra e shkollave të Edrenesë, jo vetëm që e shtyu emërimin e tij si mësues nga qershori në shtator, por edhe e pengoi që ai të gjente një punë të tillë atë vit. «Qe tepër vonë, — rrëfen Fan Noli, — të gjitha shkollat ishin pajisur me mësonjësit e tyre shumë kohë përpara shtatorit. Jo vetëm kaq, por a kishte vallë ndonjë shpresë për t'u emëruar mësonjës në ndonjë shkollë vitin tjetër? Jo, nuk kishte aspak. Zyra e shkollave e kishte vënë atë në listën e zezë

dhe nuk kishte për t'i dhënë rekomandimin e nevojshëm për të shërbyer në ndonjë shkollë tjetër greke të Turqisë». <sup>9</sup>

Qysh në këtë kohë vendosi të marrë rrugën e mërgimit për të kërkuar punë dhe shkollë të lartë. Ishte nëndëmbëdhjetëvjeçar kur, me një torbë në krah, mori trenin për në Stamboll, me qëllim që, prej andej, të nisej për në Athinë. Por, teksa treni u vu për rrugë, Theofanin e zunë një palë ethe të forta, aq sa, kur zbriti në Stamboll, u detyrua të shtrohej në një spital. Nga spitali doli i shëruar, por pa bukë, pa strehë, pa punë e pa përkrahje. Në këto çaste i doli mik një djalosh që kishte njohur në gjimnazin grek të Edrenesë, i cili i gjeti punë krahu në një ëmbëltore, ku Theofani filloi të robëtohej dymbëdhjetë orë ditën vetëm për të siguruar bukën e gojës dhe strehën në qilarin e dyqanit. Nuk qëndroi shumë ditë aty. E solli hera që, ndërsa po kalonte Urën e Gallatës, e cila lidh qytetin e vjetër me të riun, të takohet me ish-mësuesin e vet në gjimnaz dhe t'i qajë hallin. Mësuesi vendosi ta ndihmojë me shpenzimet e udhëtimit deri në Athinë dhe t'i japë një letër porosie për një mik të vetin atje, që ta regjistronte në fakultetin e filozofisë. Theofani nuk ngurroi më. U kthye në Qytezë dhe vendosi të nisej. Por sërish e zunë ethet. Ai nuk priti në fshatin e lindjes që t'i kalonin ethet, as mjek nuk qe e mundur të merrej për të në qytetin më të afërt, as vajti në Stamboll të shtrohej sërish në spital, as mundi t'i hypë kalit të dashur të shtëpisë, Balashit, për të udhëtuar pesë orë deri në stacionin hekurudhor Ouzun-Kepru, ku, pastaj, të merrte trenin për në Stamboll, por i hipi qerres së mbyllur dhe, shtrirë

mbi një dyshek, mbështjellur me një mbuloje, i mbrojtur kështu nga shiu i rrëmbyeshëm i asaj vjeshte, djaloshi i sëmurë me ethe të forta mori rrugën e mërgimit, u largua nga Qyteza e dashur, që s'do ta shihte më kurrë, u largua me dhimbje të madhe, duke u dhënë lamtumirën shtëpisë së vjetër, ku qe lindur, dhe shtëpisë së re, ku kishte banuar pas grindjes në familje, të afërmeve, kushërinjëve dhe migve, njerëzve dhe kafshëve, Me mallëngjim të thellë e ka përshkruar ai, më vonë, këtë ndarje nga Qyteza: «*Ish e trishtme dhe mallëngjenjëse t'i lije lamtumirën fafesisit të dashur, me të cilët Fan Noli kishte kaluar tetëmbëdhjetë vjet të jetës së tij dhe pa të cilët jeta as që mund të merrej me mend. Atij ju copëtua zemra kur vajti e i tha mirëmbec Larashit, qenit, Zioshit, daciit, Balashit, kalit, qeve dhe buajve të zinj, dhe viçave. Dukej sikur të gjithë ata e kuptonin instinktivisht që Theofani po ndahej prej tyre përgjithmonë. Sidomos Larashi, qeni, dhe Balashi, kali, që ishin më të zgjuarit nga të gjitha kafshët, me siguri që e kuptonin se po afrohej një katastrofë e vërtetë. Këtë e tregonte shprehja e trishtuar e syve të tyre*»<sup>10</sup>. Me një dashuri dhe mjeshtri të veçantë ka portretizuar ai sidomos Balashin, kalin e shtëpisë, në trajtën e një monologu të brendshëm lamtumire. Për ta përcjellur djaloshin në nisjen drejt shtigjeve të panjohura të mërgimit vajtën gjysh Mitrushi dhe Xha Tasi, të cilët nuk kishin shkelur më prakun e shtëpisë që pas ndarjes për punë të tokave. «*Ne e kemi dashur gjithmonë djalin, dhe sot erdhën ta shikojmë duke u nisur, ndofta për të fundit herë, — tha Xha Tasi*»<sup>11</sup>.

Kapedan Gerda vajti gjithashtu të falej me Theofanin dhe i dha këtë këshillë: «*Mos qëndro shumë gjatë në Athinë. Që andej hidhu e shko në Shqipëri. Atje është atdheu ynë i vjetër. Dhe bie tamam në veri të Greqisë*»<sup>12</sup>. Të gjithë, të prekur thellë, i dhanë lamtumirën me mall: gjyshe Sumba dhe nënë Maria, gjysh Mitrushin dhe Xha Tasi, Kapedan Gerda dhe dajallarët, tetot dhe fëmijët e tyre. Vetëm i jati, Stiliani, me karakterin e tij aq të përmbajtur nuk shprehu ndonjë shenjë tronditjeje në fytyrë. Më në fund, Dhimitri, vëllai i madh, që do të udhëhiqte qerren, vringëlloi kamxhikun në ajër dhe qerrja u nis. Fan Noli që atë ditë u largua nga fshati i lindjes dhe nuk u kthye më kurrë atje. Qyteza, me atë rreth bashkëfshatarësh shqiptarë të ngulur tej atdheut të të parëve, mbeti një kujtim i largët, i ëmbël dhe i dhimbshëm njëheri, deri në fundin e jetës së tij.

Kur ai u largua nga fshati i lindjes, ku mori edukimin e parë shqiptar, po ngrysej shekulli XIX dhe po agonte shekulli XX. Ngjarje të ndryshme po ndodhnin në Shqipëri dhe jashtë saj. Që nga viti 1882, kur lindi, deri më 1900, kur vajti në Greqi, lëvizja jonë kombëtare e çlirimit shënoi një rritje të vazhdueshme në planin kulturor e politik, me gjithë reaksionin e pareshtur turk, pas shpërndarjes me forcë të Lidhjes së Prizrenit, me gjithë politikën shoviniste dhe grabitqare të fuqive të mëdha dhe të shteteve ballkanike ndaj shqiptarëve. Në vitet 1883-1884, rrethet reaksionare greke ishin ato që, pas qeverisë turke, zhvilluan veprimtarinë më të madhe armiqësore ndaj lëvizjes sonë kombëtare të çlirimit. Qëndresa shqiptare kundër synimeve gllabëruese të reaksionit grek u pasqyrua edhe në masën fshatare

shqiptare larg atdheut, si në Qytezë të Edrenesë e gjetiu. Brenda viteve 1884-1887, lëvizja u karakterizua nga lufta për shkollën kombëtare dhe zhvillimin e letërsisë shqipe, pa reshtur kryengritjet kundër reformave qendëruese turke në krahinat malore të vendit. Në vitet 1888-1894, lëvizja mori një hov të madh në kolonitë e mërgimit. Më 1899 doli në dritë traktati ideologjik dhe politik i Sami Frashërit «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe çdo të bëhetë», të cilin, si do ta shohim, Noli do ta përkthejë greqisht, për ta bërë më të njohur në botën e jashtme.

Në Greqi, qysh më 1900, kohë kur vajti dhe u ngul përkohësisht djaloshi nëndëmbëdhjetëvjeçar shqiptar nga Qyteza, qarqet qeveritare të Athinës dhe organizatat shoviniste greke, që vepronin brenda vendit, po shfaqnin një kundërshtim të hapur ndaj vijës politike që kishte përcaktuar Ismail Qemali lidhur me marrëdhënjet shqiptaro-greke, mbi bazën e barazisë së plotë të të dy palëve, përkundër politikës qendëruese të Turqisë.

Kjo lëvizje e gjerë kombëtare shqiptare, politike dhe kulturore, shpejt do të ndikojë te djaloshi, që doli nga Qyteza e Edrenesë me ndjenjën e kombësisë dhe me vrullin për t'u hedhur në punë, në studime, në botën e madhe të diturisë dhe të arteve, në luftën e rreptë për jetën.

---

1 USHT, IHGJ: «Historia e Shqipërisë», vëllim i dytë, Tiranë, 1965, f. 277.

2 Noli F.S.: «Letër» Këshon K. Priftit, më 9 vjesht' e parë 1937, nga Bostoni, nënshkruar «F.S. Noli nga Qyteza e



---

*Kolonjës*». Origjinali gjindet në dorën e marrësit, në Rehovë.

3 Noli F. S.: «Edukim shqiptar», në «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 47.

4 Noli F. S.: Po aty, f. 47

5 Noli F. S.: Po aty, f. 48

6 Noli F. S.: Po aty, f. 49

7 Noli F. S.: Po aty, f. 49

8 Noli F. S.: Po aty, f. 46

9 Noli F. S.: Po aty, f. 50

10 Noli F. S.: Po aty, f. 51

11 Noli F. S.: Po aty, f. 52

12 Noli F. S.: Po aty, f. 52

## KAPITULLI I DYTË

### NËPËR GREQI DHE EGJIPT

Ndeshjet e para me vështirësitë e jetës.  
Përpjekjet e para në lëvizjen kombëtare  
shqiptare të çlirimit.

Nëpunësi i tramvajit dhe kopisti, sufleri,  
aktori dhe dramaturgu, mësuesi dhe publi-  
cisti.

Fan S. Noli qëndroi nëpër Greqi deri aty nga fillimi i vitit 1903. Vajti në Athinë. Trokiti te dera e shtëpisë së mikut të ish-mësuesit të vet. Ai e priti mirë dhe i gjeti vend si nëpunës në një shoqëri belgjane, që kishte në Athinë koncesionin e tramvajeve me kuaj. Ca kohë shërbeu aty nuk dihet. U regjistrua në Fakultetin e filozofisë të Universitetit të Athinës, por, për mungesa ekonomike, nuk mundi ta ndiqte. Që andej kaloi pranë një trupe teatri, me të cilën u end nëpër Greqi, për afro dy vjet me radhë. Pranë kësaj trupe punoi si kopist, sufler dhe aktor. Kjo punë i vlente sa për të mbajtur veten me bukë të go-

511-27  
N. 119

ISRAËLITE DHE FILISTINE

DRAMEME 3 AKTE

1907  
VAN HOLST

SHKURTIM I DRAMIT  
DHE KËNDITËS  
DHE KËNDITËS  
DHE KËNDITËS

1907

DRAMA N. 11

SHKURTIM

DRAMA


DRAMA

DRAMA

DRAMA

DRAMA

Israelitë dhe filistinë



jës, por, sidoqoftë, ishte më e mirë se sa ajo në tramvajet me kuaj, aq më shumë sepse e lidhi me teatrin, të cilit i kushtoi një pjesë të madhe të energjive krijuese si autor dhe shqipëruar. Ishin vitet e para të ndeshjes me vështirësitë e jetës, por edhe të një sprove për t'i përballuar ato me ngulm dhe shkathësi. Në këto vite, lëvizja kombëtare dhe letërsia e saj shënuan disa ngjarje me rëndësi: në Sofje nisi të botohet fletorja «Drita», në Egjipt doli «Baba Tomorri» i A. Z. Çajupit, kurse në Mitrovicë, më 1903, shpërtheu një kryengritje e armatosur. Qeveria turke mori masa të rrepta për ta shtypur lëvizjen me anën e forcës. Në këto rrethana, F.S. Noli merr kontaktet e para me lëvizjen kombëtare shqiptare dhe letërsinë e saj. Që kur shërbeu si sufler dhe aktor, ai shkroi dhe vuri në skenë një dramë greqisht me titull «To ksipnima» (Zgjimi), e cila u luajt nga trupa ku bënte pjesë, në qytetin Pirgos të Peloponezitet. Shfaqja e dramës, që fliste për lëvizjen kombëtare shqiptare, u ndalua nga autoritetet greke. Mjerisht, në ende nuk e njohim këtë vepër.

Po në të njëjtën kohë, më 1902, kur është në moshën njëzetvjeçare, shkruan një dramë tjetër, kësaj radhe shqip, me titull «Israelitë dhe filistinë», që do ta botojë pesë vjet më vonë<sup>1</sup>. Kjo është një nga dramat e para të letërsisë shqipe dhe ka rëndësi për të kuptuar mendimet, që e frymëzonin autorin e ri në këtë periudhë, kur, nga plani kulturor, lëvizja kombëtare po hidhej përsëri në veprimet me armë. Vepra dëshmon për lidhjet e tij me lëvizjen kombëtare shqiptare. Subjekti e mori nga përralla biblike, por figurat dhe motivet i ngjeshi me brendi filozofike dhe politiko-shoqërore. Duke pasqyruar

përpjekjet e izraelitëve për të detyruar filistinët që të ndryshonin bindjet e tyre, autori shtroi problemin e përdorimit të forcës si mjetin e sigurtë të përhapjes së ideologjisë. Ky koncept nuk mund të mos i bënte jehonë gjendjes politike, në fillimin e shekullit XX, kur në gjirin e lëvizjes kombëtare rrihej në mënyrë të zjarrtë çështja e rrugëve, që duheshin zgjedhur, për të arritur çlirimin e vendit nga Turqia. Sami Frashëri, ideologu më i shquar i Rilindjes, në veprën «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe çdo të bëhetë,» botuar tre vjet më parë, thoshte se shqiptarët, për të fituar lirinë, kishin në dorë edhe të drejtën edhe fuqinë. Në dramë, në qendër të veprimit, qëndron izraeliti Samson, i cili është i mendjes se filistinët duhen bindur me anë të fjalës. Të gjithë izraelitët pranojnë që Samsoni të niset te filistinët, vetëm plaku Rabin është kundër këtij plani. Sipas Rabinit, me fjalë nuk do të arrihej qëllimi. Që të mund të ngadhënjejë një e vërtetë, pleqëron ai, duhet të mbështetet në fuqinë. Samsoni dhe pasuesit e tij nuk e dëgjojnë këshillimin e Rabinit. Mbreti i filistinëve thërret Dalilën, vashën magjepëse që, me bukurinë dhe lajkat e saja, ta ndihmojë për të zhdukur Samsonin. Për këtë Dalilës i duhet të hetojë se ku fshitet te Samsoni fuqia e mbinatyrshme trupore. Si e zbulon se flokët dhe mjekra janë ato, që i japin këtë fuqi, Dalila arrin ta vërë në gjumë me anë të verës. Filistinët, që e prisnin me padurim këtë çast, i turren Samsonit, e lidhin me vargonj hekuri, ja qethin flokët, ja rruajnë mjekrën dhe, së fundi, e verbojnë. Në aktin e tretë, veprimi zhvillohet përsëri në anën e filistinëve, që janë mbledhur në tempullin e Baallit, për të festuar fi-

toren. Aty sjellin Samsonin të lidhur. Tani, filistinët nuk kanë më frikë prej tij, ndaj edhe e përqeshin me shpotitje të ndryshme. Sakaq, Samsoni ndjen se po i rriten flokët dhe mjekra, se fuqia po i kthehet përsëri. Ai ka vendosur që edhe kështu, i verbuar, të vrasë sa më shumë kundërshtarë. Nga fuqia përrallore e Samsonit tempulli i Baallit përmbysset. Bashkë me të vdesin edhe qindra filistinë nën gërmatat e tempullit.

Samsoni është vizatuar si një njeri i mbinatyrshëm, që, për t'ja arritur qëllimit, është gati të bëjë gjithshka, qoftë duke flijuar edhe veten. Ai thotë: «Gjithë bota të ngrihet kundër meje, prapë do të mos kisha frikë, as nuk do të ndërroja mendje. Dua ta përhap në gjithë botën (të vërtetën — V.B) dhe asnjë fuqi nuk mund të më qëndrojë». I pajisur me atë fuqi trupore fantastike, Samsoni na paraqitet si një hero joreal, si pjellë e kultit të mbinjeriut. Me sa duket, që nga kjo kohë Noli ka filluar të lexojë veprën e Fridrih Niçes, që, më vonë, edhe do ta përkthejë shqip pjesërisht. Synimi për t'ja kushtuar veten një qëllimi të caktuar bie në kundërshtim me të dhënit pas ëndjeve të ndryshme. Kur shkon te filistinët, Samsoni jepet pas Dalilës, e cila e verbon me bukurinë dhe lajkat e veta, duke e bërë të harrojë misionin. Vetë Samsoni e pranon, më vonë, se njeriu, që kishte të drejtë, ishte plaku Rabin. Kështu, te Samsoni më në fund, zotëroi pikëpamja e plakut të regjur në jetë, se e vërteta, për të ngadhënjyer, duhet të shoqërohet me fuqinë. I zgjuar, i matur, Rabini ka grumbulluar një përvojë të madhe jetësore dhe i njeh njerëzit, prandaj pleqëron më mirë të veprojë. Ai ishte kundër vajtjes së

Samsonit fill i vetëm në vendin e filistinëve: «Në vend që të dërgojmë Samsonin vetëm me të vërtetën është mirë të vemi edhe ne të gjithë bashkë me shpata...».

Përveç çështjes së përdorimit të forcës, autori rreh në dramë edhe çështjen e së drejtës që kanë njerëzit për të mos pranuar ato mendime, të cilat u sjellin skllavëri shpirtërore. Filistinët kundërshtojnë fenë monoteiste që duan t'ua imponojnë izraelitët, sepse ajo, thotë autori me guxim, i shtrëngon njerëzit të rrojnë me frikë të përhershme. Drama mbeti e papërpunuar deri në fund ose një «*skelet drame*», siç thotë autori në pasthënje. Prandaj, edhe pasi e shkroi, ai e mbajti pesë vjet në dorëshkrim, duke pritur, me sot e nesër, që të gjente kohë për ta përpunuar dhe për t'i trajtuar më gjerë problemet dhe mendimet që shtron, sepse, në dorën e parë, ideja qëndrore nuk doli plotësisht e qartë dhe pozitiva e autorit jo krejt e përcaktuar. Personazhet nuk janë portretizuar sa duhet, por, me disa skena të gjalla, me dialogun e shkathët e të vetëvetishëm, autori i ri dëshmoi prirjen për teatrin, të cilit do t'i kushtojë më vonë disa shqipërime veprash të njohura të letërsisë botërore. Gjuha e veprës, një tërësi e thjeshtë, me ndërtime dhe shprehje sipas frymës dhe natyrës së shqipes së folur, është mjaft e pasur, por ndeshen në të edhe fjalë të huaja. Që në këtë vepër të parë shihet lidhja e autorit me problemet kryesore të lëvizjes kombëtare të kohës dhe me gjuhën e gjallë të popullit, por, ndërkaq, edhe mospërcaktimi i qartë i ideve dhe i rrugëve që do të ndjekë.

Me një formim të tillë, biri i fshatarit psallt të



Qytezës së Edrenesë, studenti universitar, që s'arriti të vazhdonte studimet në Athinë për filozofi dhe që, për të nxjerrë jetesën, punoi si nëpunës tramvaji me kuaj, si kopist, sufler dhe aktor, u largua nga Greqia, aty nga fillimi i vitit 1903, dhe vajti në Egjipt, ku gjeti punë si mësues lëvizës i greqishtes dhe, me shtytjen e përkrahjen e Thanas Tashkos, Jani Vruhos, etj., u hodh në veprimtari atdhetare, shkroi artikuj greqisht me pseudonimin Theofan Mavromati dhe shqip me pseudonimin Ali Baba Qyteza, në dobi të lëvizjes kombëtare shqiptare, përktheu greqisht, më 1903, veprën madhore të Sami Frashërit «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë». Që në këtë kohë ai del ballë për ballë turkomanëve dhe grekomanëve.

Në Egjipt qëndroi tre vjet. Atje ju shfaqën priret për krijimtari në fushën e përkthimit dhe të fletorizmit. I zgjuar, energjik, dhe i talentuar, ai fitoi menjëherë përkrahjen e mjedisit atdhetar shqiptar të Egjiptit. Atje, më 1894, u themelua një shoqëri me emrin «Vëllazria e shqiptarëve», e cila grumbulloi rreth vetes masën e të mërguarve atdhetarë të vendit, hapi degë nëpër qytete të ndryshme. Atje, nga 1900 deri më 1904, u botua nga Milo Duçi «Besa-Besën», një nga organet kryesore të publicistikës shqiptare në fillimet e shekullit tonë. Atje luftonin për lëvizjen kombëtare dhe lavronin letërsinë e saj Filip Shiroka, A.Z. Çajupi, etj., që e çuan më tej luftën kundër rrymave përçarëse: turkomanizmit dhe grekomanizmit. Çajupi u shqua si kundërshtar i hap-të i feudalizmit dhe i feudalëve reaksionarë. Gjithë kjo veprimtari atdhetare dhe letrare ndikoi shumë te Fan S. Noli. Në autobiografi do të shënojë më vo-

në se, kur arriti moshën njëzetenvjeçare, «*mësoi gjendjen e Shqipërisë prej disa patriotëve të përndarë në Egjipt dhe gjetkë*», duke përmendur Nikolla Naçon, që botonte në Bukuresht fletoren «*Shqiptari*», Shahin Kolonjën dhe Kristo Luarasin, që botonin në Sofje fletoren «*Drita*», ku bashkëpunoi edhe ai vetë me artikuj publicistikë. Në Fajum të Egjiptit u njoh me Thanas Tashkon dhe Jani Vruhon, që e ndihmuan me shpenzimet e tyre të nxirrte në dritë përkthimin e veprës ideologjike të S. Frashërit dhe të shkante në Amerikë, për t'i dhënë dorë lëvizjes kombëtare të të mërguarve shqiptarë të ngulur atje. Tashkon dhe Vruhon i kujtoi më vonë me mirënjohje të thellë, duke i quajtur «*pionierë të Rilindjes shqiptare*». Si dihet, janë këta të dy që do të nxjerrin, brenda viteve 1906-1909, fletoren «*Shkopi*», duke e përhapur falazi me shënimin: «*Kush të dojë, sa të të dojë*».

Në periudhën midis viteve 1903-1906, ndodhën disa ngjarje për t'u përmendur: më 1904 shpërtheu një kryengritje e re në Kosovë dhe u botua përmbledhja e parë poetike e Asdrenit «*Rreze drite*», më 1905 ra dëshmor, i therur mizorisht nga andartët grekë, atdhetari dhe shkrimtari Kristo Negovani, u mbajt në Bukuresht një kongres shqiptar, u formua në Manastir Komiteti i fshehtë shqiptar me emrin «*Për lirinë e Shqipërisë*» dhe nisi të botohej në Raguzë «*Shpnesa e Shqypnis*», kurse, më 1906, u krijuan çetat e para, të drejuara nga Komiteti i Manastirit.

Pas tre vjetësh qëndrimi në Egjipt, Fan S. Noli nisët për në SHBA. Nga Napoli, më 15 maj 1906, i shkruan Thanas Tashkos: «*Ndër tri ditë arrimë në Napoli, të shtunë. Çfarë qyteti, çfarë bukuri, çfarë*

udhëra edhe sheshe me shatërvane... Po mua këto bukurira s'më bëjnë asnjë impresion, se edhe s'e di mirë ku do më dalë puna... Por na e kemi shpresën të madhe — dhe fat'i Shqipërisë s'flë»<sup>2</sup>. Përveç përshkrimit të gjallë të qytetit të Napolit, në këtë letër spikat skalitja e fytyrës së një shqiptari të thjeshtë nga Dibra, të cilin nevoja e jetës e kishte hedhur në dhë të huaj dhe të cilin Noli e takoi dhe e njohu në doganë të Aleksandrisë. Në dialogun midis Dibranit dhe Nolit shihet ngulmi i njeriut të thjeshtë, që i frymëzon autorit të ri qëndresën në idealin atdhetar: «Kur na shkonin nga karantina, pashë një Dibran të gjorë, një trim të bukur me fletë, që s'na ditke asnjë gjuhë përveç shqipes, pak turqisht vetëm fliste, por edhe atë sëpatë. Çdo gjë që e pyesnin, përgjigjej i ngrati: «Selanik». Më zu gazi dhe i vajta pranë dhe e pyeta: Mos je shqiptar, ore vëlla? — Po, — më tha, — nga Dibra. — Eja, i thashë. — Si ta thonë emrin? — Gani Elmas — Mirë. Ku e ke biletën? Rrëfeja atij që shkruan aty. Tashti eja të shkojmë tek heqimi të na shëkonjë. Po ç'të më shëkonjë mua? — tha — Unë s'kam gjë prej gjëje. — S'ke — i thashë — po ashtu është namuzi. — Mirë, t'a shëkojmë edhe këtë namuz.

Po heqimi s'qenke atje, dhe presim. — Pyet—më tha — ku është heqimi.

Pyeta, unë dhe më thanë: «Ka punë brënda...»

— Eja të hyjmë brënda! — thotë — Ç'punë tjetër na paske? — Duro — i thashë — se dhe unë shqiptar, dhe unë të kulluar e kam gjaknë si ty, po ja tek po pres këtu tash.

— Mirë— më tha — po nga të kemi zotërinë tënde?

— Nga Kolonja — i thashë. — Gëzohem shumë — më tha — dhe vuri njerën dorë në mest, dhe me tjetrën drodhi mustaqezën e rustë, një mustaqe të bukurëz, ngriti ballët përperjetë dhe më shikonte me një madhëri prej ushtari të vjetër të Romës, dhe me një dashuri dhe me një ngashërim të vërtetë, aqë sa nisnë dhe i dridheshin buzët dhe lëvezhëgat e syvet, si një foshnjëje, që është gati të qanjë.

— Po ku vete? — më tha. — N'amerikë.

Dhe, menjëcopëherësh, ardhni arapi dhe na ftoi të vemë të na ankonjë heqimi. Unë u nisçë... Po aju më mbajti nga dora e më tha: — Rri. Ku vete? Neve jemi më të shëndoshët e dynjasë. Namuzi, bre vëlla — i thashë — Dhe pampori shkon pas gjysmë sahati. — Mirë — më tha — të shkojmë, po unë ja... t'ëmën pamporit, një herë u poqmë dhe u — gjetmë vëllezër.

Na pa heqimi, dhe shkova unë, se s'më mbetej kohë. Tek hikënje, dëgjonj: — Shko me shëndet, të qoftë udhë e mbarë, të na kujtosh!». <sup>3</sup>.

Në një letër tjetër që ja dërgon nga Nju Jorku Thanas Tashkos, më 1 qershor 1906, fill pas arritjes atje, F.S. Noli i tregon edhe disa skena nga udhëtimi, të cilat paraqitin interes për njohjen e pikëpamjeve të tija rreth jetës dhe njerëzve, si dhe për mjeshhtërinë e tij në dhënjen e mbresave të udhëtimit. Një pamje rënqethëse është ajo që jep përfytyrimin e nisjes në mërgim të qindra punëtorëve të papunë italianë. Ata ndahen me dhimbje të thellë nga të afërmit dhe vendlindja, për të nxjerrë jetesën, duke shitur mundin e krahëve dhe duke lë-

në eshtrat në dhé të largët e të huaj. Noli shpreh keqardhjen dhe një farë revolte ndaj kësaj plage të rëndë të shoqërisë borgjeze. Por, ndërkohë, ai ende nuk e ka përcaktuar qartë qëndrimin ideologjik. Përkërisht në këtë letër i rrëfen mikut të vet se vazhdon të mbajë Fridrih Niçen në dorë.

Por simpatia për idetë e filozofit gjerman të kultit të mbinjeriut, që gjeti pasqyrim edhe në drama «Israelitë dhe filistinë» dhe që do të shprehet me shqipërimin e disa fragmenteve nga «Ashtu foli Zarathustra», nuk do të jetë përcaktuese në botëkuptimin dhe veprimtarinë e tij praktike. Noli po shkonte në gjirin e bashkatdhetarëve të mërguar në SHBA me besim në të ardhmen, me vendosmëri dhe guxim për t'u hedhur ndër beteja të rrepta që kërkonte lufta çlirimtare. Në letrën e mësipërme ai i shkruan mikut të vet këto radhë: «Zura miqësi vetëm me një italtjan dhe i thashë se jam shqiptar revolucionar. Menjëcopëherësh më rrethuan të tërë dhe më shikonin me çudi. Unë u përgjigjesha në çdo gjuhë që më pyesnin, dhe ata mbeteshin me gojë hapët. Ca më thoshin ku gjindet kjo Shqipëri, ca s'dinin fare dhe më shëkonin në sytë. Sa më kushtuan këto pyetje, ti e merr vesh, po ç'të bësh. Dhe, pasi u larguan, u ngritçë (nënvizuar nga F. S. Noli) nga poltrona, vajta anës vaporit dhe kështu i foli qiellit me sy të përlotur përpyetë: Shëkon se si na shajnë neve më të shëndoshët e dynjasë, moj Perëndi? Dhe, në u shurdhove, do të hipim gjer në fron tënt të të lëkundim të zgjuhesh dhe të na dëgjosh: Ardhi koha!»<sup>4</sup>).

- 
- 1 Noli F. S.: «Israelitë e filistinë», dramë me 3 akte. Boston Mass., typ. e «Kombit», 1907. Citatet janë nxjerrë nga ky botim.
  - 2 Noli F. S.: «Letër» Thanas Tashkos «Nëndori», Nr. 4 1965, ff. 40-41.
  - 3 Noli F. S.: «Letër» Thanas Tashkos, po aty.
  - 4 Noli F. S.: «Letër» Thanas Tashkos, po aty.

## KAPITULLI I TRETË

### NË BOSTON DHE GJETIU, AGJITATOR I LËVIZJES KOMBËTARE TË ÇLIRIMIT

Pjatarësi, punëtori i krahut, shkruesi dhe editori i gazetës, studenti, gojëdari dhe shqipëruesi, themeluesi i «Vatrës» dhe «punët e mërziçme të priftërisë».

Vajtja në SHBA, në gjirin e shqiptarëve të mërguar, qe, për Fan S. Nolin njëzetekatërvjeçar, një kthesë me rëndësi në veprimtarinë atdhetare dhe kulturore.

Jemi në prak të shporrjes së sunduesit shekullor turk nga atdheu. Lëvizja kombëtare mori hov përpara në të gjitha fushat. Më 18 mars 1907 zhvillohet Lufta e njohur e Mashkullores, më 24 nëntor 1908 mbahet Kongresi i Manastirit, në maj 1909 malësitë e Gjakovës përballojnë ekspeditën gjakatare të Xhavit Pashës, më 2 shtator të po atij viti hapet në Elbasan një Kongres atdhetar, kurse, më 1

dhjetor, shkolla e parë «Normale». Viti 1910 shënon një ngritje të mëtejshme të lëvizjes në fjalë: më 27 shkurt një miting i madh në Korçë hedh poshtë alfabetin me shkronja arabe, në prill shpërthen kryengritja e Kosovës, nga 1 deri më 3 maj zhvillohet beteja e njohur e Kaçanikut, kurse në korrik-gusht Shqipëria e Veriut dhe e Mesme përballojnë ekspeditën famëkeqe të Shefqet Turgut Pashës. Vrulli i lëvizjes rritet veçanërisht më 1911: më 23 mars nis Kryengritja e malësisë së mbi Shkodrës, më 29 korrik bien si burrat gjashtë dëshmorët e Orman Çiflikut. Viti 1912 shënon kulmin e këtyre përpjekjeve: në prill-maj fillojnë përleshjet e armatosura midis shqiptarëve dhe trupave turke në Kosovë dhe në Shqipërinë e Veriut, nga 21 deri më 25 maj kuvendi i Junikut harton programin e kryengritjes, në korrik bien në duar të kryengritësve qytetet kryesore të Kosovës, më 14 tetor, një javë pas fillimit të Luftës ballkanike, bëhet mbledhja e atdhetarëve shqiptarë në Shkup, për të siguruar tërësinë tokësore dhe autonominë e Shqipërisë, më 5 nëntor zhvillohet mbledhja e kolonisë shqiptare të mërgimit në Bukuresht nën kryesinë e Ismail Qemalit, më 25-27 nëntor, përpara hyrjes së ushtrive serbe, Elbasani, Durrësi, Tirana, Kavaja dhe Lushnja shpallin pavarësinë, pasi edhe Shkodra përballonte rrethimin serbo-malazez; më 28 nëntor, përpjekjet shumëshekullore të popullit shqiptar u kurorëzuan me sukses: Kuvendi kombëtar shpalli në Vlorë pavarësinë e Shqipërisë dhe, të nesërmen, Ismail Qemali, që ngriti flamurin kombëtar, u zgjodh kryetar i qeverisë së përkohshme. Në kuadrin e këtyre ngjarjeve historike, që ndodhën në atdhe, dhe në kuadrin e veprimtarisë së ko-



lonive shqiptare të mërgimit, edhe kolonia shqiptare e mërgimit në SHBA nuk ngeli pas. Në vitet 1905 dhe 1906 u ngritën shoqëritë «Malli i Mëmëdheut» në Bufalo dhe «Koha e lirisë» në Nju Jork, kurse, në Boston, më 1907, «Besa-Besën», «Lidhja» në Sen-Lui, etj. Më 24 shkurt 1903 në SHBA u themelua kisha ortodokse shqiptare duke u shkëputur nga kisha greke. Nga 1906 deri më 1908 u botua fletorja «Kombi», që u çasua, më 1909, nga fletorja «Dielli» në Boston. Në prill të vitit 1912, me shkrirjen e shoqërive atdhetare në SHBA, u themelua federata pan-shqiptare «Vatra». Një rol të madh për organizimin e këtyre shoqërive dhe për bashkimin e tyre luajtën Petro Nini Luarasi, Bajo Topulli, Sotir Peci dhe, tok me ta, Fan S. Noli. Në atë kohë numri i shqiptarëve, që jetonin dhe punonin në Amerikë si të mërguar ekonomikë, arrinte në rreth 20.000 vetë.

Pas dy muajve e gjysmë të nguljes në Amerikë, më 17 gusht 1906, Fan S. Noli i shkruan nga Bostoni Thanas Tashkos: «Në Bufalo, ato ditë bëhesha gati për këtu, më kish rënë më 18 dollarë në javë në Filadelfi. Këtë punë e gjeta vetë me letra, dhe më shkroj që të veja. Agjent për të shitur në tërë qytetet e Amerikës një soj koresh prej më të mirëve piktorë. Dhe tamam për mua të gjezdisja dynjanë. Po përpara «Kombit» e lashë dhe as iu përgjegjëç... Nuk më pëlqen Amerika, pa thuj zotëria jote se zura pleshta dhe këtu. Kur ke kohë, shkruaj nga nonjëherë, se këtu m'u shtrëngua shumë zemra. M'u nxi dynjaja. S'qenka Bot'e Re këtu, po Bot'e fëlliqur». .1).

Kështu, për të nxjerrë jetesën, ai bënte punë krahu dhe këtë me ndërprerje, në një fabrikë të sharrës. Robëtohej nëntë orë ditën për katër dollarë në

javë. Këtë gjë e vazhdoi tre muaj. U vu menjëherë në lidhje me lëvizjen atdhetare, bashkëpunoi të «Drita» e Sofjes dhe, bashkë me Sotir Pecin, atdhetarin nga Dardha e Korçës, filloi botimin e fletores «Kombi». Peci s'e bënte dot vetëm këtë punë si editor. Ai kishte nevojë për një shkruar të aftë. Dhe shkruar u bë Noli. As njëri as tjetri s'kishin të holla për të përballuar shpenzimet. Kushtet ishin të për të vështirë. Mezi gjetën qilarin e një dyqani në rrugën Hadson Strit, Nr. 100, për të vendosur shtypshkronjën e varfër të «Kombit». Mezi ja dolën të ushqeheshin dhe të visheshin. Thonë se dimrit dilnin jashtë qilarit veç e veç, sepse kishin vetëm një pallto. «Kombi» aty shtypej dhe aty postuhej. Editori dhe shkruar aty flinin dhe aty ushqeheshin. Për të përmirësuar gjendjen, ata vendosën të dilnin nëpër kolonitë shqiptare të Nju-Inglendit. Pasi vizituan shtetet e ndryshme, Men, Nju Hampshajr, Rod, Island dhe Massachusetts, u kthyen në Boston vetëm me shumën prej 15 dollarësh si ndihmë për fletoren «Kombi». Noli qëndroi afro një vit si shkruar i fletores, pastaj gjeti sërish punë krahu si pjatolarës, që e fillonte në tetë të mbrëmjes dhe e mbaronte në pesë të mëngjezit, me një rrogë prej pesë dollarësh në javë. Këtë punë e vazhdoi gjashtë muaj. Por veprimtarisë atdhetare nuk ju shmang. Më 1907, në SHBA vajti Bajo Topulli. Nëpër kolonitë shqiptare të Nju -Inglendit e shoqëroi Noli. Kur Bajo Topulli u kthye në atdhe, Noli mbeti sërish pa punë. Kështu, dy vitet e para të nguljes në SHBA, pati ngushtica të mëdha.

Në fillim, ai dëshmon se nuk kishte bindje fetare, mādje shfaqet kundër rolit prapanik të institu-





cioneve të tilla. Fill pas arritjes atje, më 1906, në një ligjëratë që mbajti në Bufalo ai tha, ndër të tjera: «*Sytë shëndritën porsì vetëtimë, veshët na u hapën, që na i kishin shurdhuar këmbanat e kishave dhe ulërimat e hoxhallarëve.*»<sup>2)</sup> Kurse në një letër, drejtuar Thanas Tashkos, arriti të thoshte: «*Perëndisë, që s'e besonin i arthtë keq*<sup>3)</sup>. Duke forcuar lidhjen me lëvizjen politike dhe kulturore të kohës, ai ndalet te çështje të ditës, që shqetësonin atdhetarët për bashkimin dhe çlirimin kombëtar. Ngrihet me të madhe dhe bën thirrje për të zgjidhur sa më shpejt divergjencat rreth alfabetit të përbashkët të shqipes: «*Për të bërë vjersha është shumë punë e kollajshme, vetëm një kalem duhet, po me ç'shkronja? me të Stambollit, me të Bashkimit, me të Dijes, me të De Radës apo...? Mjaftni, se na u mërzit jeta: kështu as një çapë nukë vemë dot përpara! Po, kur s'u muarëm dot vesh për abecenë, është e para e punës, si do të mirremi vesh më tutje?*». Dhe përfundon me kërkesën: «*Një abece për të gjithë shqiptarët dhe si të dojë le të jetë!. Kjo është thirrja e tërë shqiptarëve!*»<sup>4)</sup>.

Është koha kur Noli fillon edhe krijimtarinë poetike. Në numrin e 25 janarit 1907 të fletores «Kombi» botoi me pseudonimin Ali Baba Qyteza vjershën e parë me titullin «Fryn, moj erë...», e cila ju frymëzua nga një ngjarje lënduese. Një gruaje, pasi i ka vdekur burri, i vdes edhe vajza. Çupën e ndryjnë në një qivur, hapin dëborën dhe e varrosin pa ceremoni, atje, në fushë të Korçës. Vjersha është ndër-tuar në trajtën e një dialogu midis poetit dhe erës, që vjen nga Shqipëria. Në të, poeti shpreh dhimbjen e thellë për humbjen e vajzës së njomë në atdhe:

«E kur të kthehesh nga Shqipëria  
Atje në kopshtin, atje t'qëndrosh,  
Dhe lott' e mia si vesë qjelli  
Dale nga dale do t'i pikosh.  
Qaj, moj erë, moj' er'e shkretë qaj,  
Derthmi lottë atje mi varr' e saj».

Duket këtu romantizmi me nota sentimentale, si dhe një kujdes i veçantë për ritmin dhe simetrinë e vargjeve. Vjersha është larg nivelit ideo-artistik të poezisë së tij të mëvonshme, qoftë nga brendia, qoftë nga konfiguracioni.

Njëkohësisht, F.S. Noli nis veprimtarinë si gojëtar, agjikator i lëvizjes së bashkimit dhe çlirimit kombëtar. Më 10 shkurt 1907 vihet në krye të një mblejeje shqiptarësh të fshatit Natik, për të themeluar një degë të shoqërisë «Besa-Besën». Aty mban një ligjëratë të shkathët, ku, ndër të tjera, thotë: «Këtu, në këtë fshat, shoqëria «Besa-Besën», që është foshnje tani, këtu do të bëjë çapn' e parë të saj foshnjërisht dhe kjo çapë lipset të jetë e shëndoshë... Këtu, në këtë fshat, zogu «Besa-Besën», që memzi iu vesh në krahët, bën fluturimin e parë. Natiku është një degë e parë përmi të cilën qëndron gjer sa t'i forcohen krahët. Vini re mirë, t'a bëni të ikinj që këtejza shqiptonjë, fajkua, dhe të mund, me një të goditur krahësh, t'i lerë në vent gjerprinjtë dhe nepërkat e farmakosura, që na ndjekin... Le t'u rrëfejmë se s'është rabeckë, po fajkua. Fajkua dhe shqiptonjë do t'i dërgojmë mëmës Shqipëri, që t'i apë shpresë dhe kurajë, duke thënë që djemat e saj punojnë dhe nukë flenë. Dhe në pyetë nonjë «Ngaj na vjen kjo shqipo-

një e rrebtë dhe 'trime?'» do të përgjigjet: «Në Boston linda dhe q'andej vinj, po në Natik mësova të fluturonj»<sup>5</sup>).

Në veprimtarinë fletorare dhe gojëtare shfaqen disa nga mendimet e tij kryesore, në to duket personaliteti i tij i hershëm politik, kulturor dhe artistik. Por disa nga këto nxjerrin në pah edhe dobësi jo të vogla, që shprehin qëndrime kontradiktore. Kështu, në një miting të mbajtur po më 1907, ai kërkoi të bëhej propagandë te bejlerët, bajraktarët dhe baballarët — mendim patriarkal ky, që i binte ndesh traditës së shëndoshë të ideologjisë përparimtare të Rilindjes, që forcën e çlirimit e kërkonte te populli: «Në ka njerëz, që bëjnë prapagandë në Shqipëri, le të dëgjojnë edhe nga mua një fjalë. Në vend që të bëjnë propagandë ne populli, le të bëjnë ne bejlerët, ne bajraktarët, ne baballarët. Një bej ose një bajraktar ose një baba është sikur hodhe gur' e parë për themeli».<sup>6</sup>)

Këtë vit, gjithashtu, ai botoi në Boston dramën «Israelitë e filistinë». Në shënimin që bënte me rastin e botimit, ai rrëfente se e mbajti pesë vjet pa e nxjerrë në dritë, duke pritur kohën që ta përpunonte, megjithatë: «Ajo kohë jo vetëm që s'vinte, por edhe largohet dhe kështu mbeti libra, bashkë me dy motra të tjera të përleshura në valicë, ku nisnë t'a humbinin durimin se i zoti do të mirte kujdes për të, duke e parë të përvijosë të tjera piktura më të reja dhe gjithë një të pambaruara».

Puna e dendur, ngushticat ekonomike, mjedisi mbytës në të cilin jetonte në SHBA, e bënë të ndjejë angushti dhe vetmi: «Për fat të keq — i thotë Thanas Tashkos më 1908 — jam edhe unë shumë liksht nga

shëndeti i zemrës dhe i shpirtit. Një ngathtësi dhe një ngushtim më ka pllakosur dhe s'di kur do të jem i zoti t'a shkund e të çlirohem. Jam i helmuar gjer në vdekje dhe shkaku i helmit është i paçkoqiturshim si ngaherë. Ndofta duhet të ndrroj erën. Kjo Amerika e shkretë më mbyti në këto dy vjet dhe m'a përpiu tërë fuqinë dhe gjallërinë e shpirtit. I rrethuar prej njerëzish që s'më kuptojnë me një tavllator e lodrar të Athinës si gazetar, më duket që s'ka vend për mua këtu dhe luftonj më kot të themelohem në mes të kafshëve si kryekafshë. — Ikë, ikë së këtejmi!... ja thirrja dhe ngushëllimi i përhershëm i vehtes s'ime. Dhe, nga ana tjetër, kuptonj detyrën që duhet të mbetem se s'bëhet ndryshe, dhe, duk parë, rri unë i vetëm këtu, unë i huaji, unë pa miq»<sup>7)</sup>. Megjithatë, veprimtarinë nuk e ndërpreu. Përkundrazi, duke u nisur nga konsiderata politike, megjithëse nuk kishte bindje të ngulta fetare, më 8 mars 1908 u dorëzua prift dhe nisi luftën për ta shkëputur kishën ortodokse shqiptare nga Patrikana e Stambollit. «Nga vëra e motit që vjen shkonj në Shqipëri dhe do nis luftën e parë kundër klerit grek, që do t'a quaj «Kryqëzatë e parë e historisë shqipe»,<sup>8)</sup> i rrëfen Thanas Tashkos po atë vit. Dhe, me qëllim që të gjitha shërbesat të bëheshin në gjuhën amtëtare, më 1908 nis të shqipërojë libra fetarë, njëri nga të cilët, «Libri i shërbesave», u botua një vit më vonë, në Bruksel. Këto i quajti «punë të mërzicme të priftërisë», por me to rrihte t'i priste rrugën ndikimit të qarqeve shoviniste greke nëpërmjet shërbimit fetar greqisht të ortodoksët shqiptarë, jo vetëm në Shqipëri, por edhe nëpër kolonitë e mërgimit në Amerikë e gjetiu,



Në këtë drejtim, Noli vazhdonte punën e Konstandin Kristoforidhit me shokë. «Një nga detyrat themelore të shoqërive patriotike të mërgimit vazhdonte të ishte lufta jo vetëm kundër zgjedhës turke në Shqipëri, por edhe kundër politikës asimiluese e përçarëse të Patrikanës së Stambollit, e cila e kishte shtuar veprimtarinë e saj jo vetëm në Shqipërinë e Jugut e të Mesme, por edhe në kolonitë shqiptare të mërgimit<sup>9</sup>». Në këtë kuptim, në ato rrethana, të përdorurit e shqipes si gjuhë shërbimi kishtar nuk ishte thjeshtë një veprim fetar, por edhe politik. Si institucion kulti, edhe kisha ortodokse u bë një barrë e rëndë shfrytëzimi lëndor dhe shtypjeje shpirtërore mbi masën e njerëzve të thjeshtë. Duke krijuar lidhje me të mërguar shqiptarë nëpër qytete dhe fshatra të ndryshme të SHBA, duke mbajtur ligjërata mbi tema atdhetare të kohës, jo vetëm u shfaq talenti i rrallë i Nolit si gojëtar, po edhe figura e tij u bë shumë e njohur. Në mars 1908 e shohim të flasë në fshatin Far Rokuej. Në maj të atij viti mban në Filadelfi, përpara 500 shqiptarëve, fjalën «Për kujtim të të madhit shqiptar dhe të atit të filologjisë shqiptare, Konstandin Kristoforidhit». Jehonën e kësaj fjale e dha Sotir Peci në «Kombi»: «... duke mbajtur fjalën e përkujtimit të të pavdekurit Kristoforidh, i bëri shqiptarët të mallëngjehen e t'u mbushen sytë me lotë. Duke u treguar jetën dhe veprat e tija, u dha të kuptojnë se si një shqiptar i mirë, duke punuar për atdhenë me mish e me shpirt, do të jetë përjetë i gjallë e i paharruar në zemër të çdo shqiptari»<sup>10</sup>. Po atë muaj, në Boston mbajti një fjalim të fuqishëm mbi jetën dhe bëmat e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut, duke ngritur lart luftërat e lavdishme

të të parëve nën udhëheqjen e tij. Edhe këtë ligjëratë e çmoi shumë «Kombi» i 16 majit.


Ndërkohë, për të përmbushur ëndrrën e vjetër, që të kryente studimet universitare, ndonëse në kushte të vështira pune e jetese, u regjistrua në universitetin e Harvardit.

Harvardi ishte universiteti më i njohur i Amerikës. «Këtu, zakonisht, i dërgojnë bijt e tyre mbretërit e naftës, baronët e qymyrgurit dhe manjatët e çelikut. Ata e dinë fare mirë se djemt e tyre, duke ndjekur për katër vjet mësim sporti, në luks dhe në «studimin gjakftohtë të shkencës gjakftohtë», do të kthehen me një ndërgjegje, që i shpëton krejt edhe ndikimit më të vogël të radikalizmit. Pikërisht në këtë mënyrë dhjetra mijëra amerikanë të rinj shndërrohen nëpër kolegjet dhe universitetet në mbrojtës të rendit në fuqi — në roje të bardha të reaksionit». 11.

Noli u ndesh me këta bij të klasës së pasur, dëgjoi leksionet e pedagogëve idealistë të sociologjisë e të historisë, predikimet e profesorëve më të njohur të ekonomisë politike të rendit kapitalist, por nuk u bë skllav i tyre, epigon dhe ithtar i tyre, as «roje e bardhë» e reaksionit borgjez. Ndërkohë, ai zu vendin e Sotir Pecit si editor i «Kombit», detyrë që e mbajti deri në janar të vitit 1909. Një muaj më vonë, më 15 shkurt, ai me shokë nxori fletoren «Dielli», duke kryer edhe këtu punën si editor. «Dielli» u bë një tribunë e çështjes kombëtare në atë kohë, luftoi klerin grekoman dhe elementët e tij, që orvateshin të përçanin lëvizjen kombëtare, demaskoi synimet e huaja ndaj Shqipërisë dhe bëri një punë të mirë për organizimin dhe bashkimin e forcave atdhetare shqiptar-



Fan S. Noli



re të mërgimit. Ndonëse i ri, Noli u bë shpejt një nga udhëheqësit më në shenjë të lëvizjes së kolonisë shqiptare të mërgimit në Amerikë.

Pikërisht në këtë kohë nisi edhe shqipërimet artistike. Këtë punë të vyer, me të cilën do të shfaqet prirja e tij e veçantë, ai do ta fillojë me tregime të Bjornstern Bjorsonit, me komedinë «Martesa me pa hir» të Moljerit, me novelën «Vanina Vanini» të Stendalit, etj. Ai dëshmoi me këtë punë jo vetëm njohjen e thellë të gjuhës amëtare, por edhe të një tok gjuhëve të tjera. Energjik dhe i palodhur në punë, F. S. Noli nuk la rast pa shfrytëzuar për t'i dhënë hov përpara lëvizjes kombëtare. Më 1911, dënoi ndasitë fetare dhe ndikimet e huaja përmes feve të ndryshme, duke thënë, ndër të tjera, se «krerët e feve kanë qenë armiq të popullit shqiptar» dhe se «asnjë s'mundet ta mohojë sot që fetë në Shqipëri janë vegla politike», se «Ca biskupë grekër na kanë mallkuar gjuhën... (por) do t'i kuptojnë dhe ata më të paditurit që mallkim'i gjuhës shqip s'që një nga urdhërat e Krishtit, po një dinakëri e poshtër e politikës greke». <sup>12</sup>

Më 9 qershor 1911, në një miting të madh të shqiptarëve të mërguar në SHBA, për të pritur disa përfaqësues të kryengritësve malësorë të Veriut, Noli mbajti një fjalë të zjarrtë, në të cilën tha edhe këto: «Duhet të fitojmë se, ndryshe, jemi të humbur... Të gjithë, djema të rinj, plot shpresë, vini dhe po kalbeni këtu nëpër fabrikat e botës, se vendi i juaj s'është i zoti t'ju apë bukë... Një zë thërret: «Luftë, luftë gjer në fund!». Po lufta, zotërinj, do të holla dhe këtë ndihmë s'na e ep njeri. Evropu po shëkon luftën heroike të atyre trimave malësorë dhe s'bëri asnjë

*lëvizje që t'a ndihë... Luftëtarët t'anë janë urët dhe pa fishekë. Si do të luftojmë pra? ... Shqipëria na kërkon ndihma. Shqipëria kërkon luftëtarë. Le të re-ndim te thirrja e saj. Le të sulemi nënë flamurin e e kuq në flagë të luftës, që të na drithësohet trupi nga dehja e barutit, që të na ndizet shpirti nga zjarri i shenjtë i Lirisë dhe të vdesim duke thirrur: Rroftë Shqipëria!»<sup>13</sup>*

Po këtë vit ai vjen në Evropë, pas pesë vjetësh që ishte ngulur në SHBA, dhe viziton kolonitë shqiptare të mërgimit në Rumani dhe në Bullgari, ku flet si agjikator i njohur në dobi të bashkimit kombëtar, kundër rrymave përçarëse. Aleksandër Xhuvani rrëfente se në Bukuresht ishte takuar me patriotët e atjeshëm dhe me Luigj Gurakuqin, Dervish Himën e Fan S. Nolin, i cili i kishte thënë se bashkimin kombëtar nuk do ta sillte feja e përbashkët, por evolucioni i ndërgjegjes së popullit. Kristo Luarasi e përshëndeti në fletoren «Liria» me entuziazëm punën e Nolit në gjirin e shqiptarëve të mërguar në Bullgari. Në Sofje erdhën për t'u takuar me të i jati, Stilian Gjergj Noli, dhe e ëma, Marie Gollaqi. Tanimë, biri i tyre, i larguar qysh nëndëmbëdhjetëvjeçar nga familja dhe fshati i lindjes, ishte bërë tridhjetëvjeçar, i njohur si patriot i ri demokrat, fletorar, gojëtar dhe shqipëruës, i çmuar dhe i nderuar nga rrethet shqiptare anembanë. Njeriu e merr me mend se si do të jenë shmallur prindët e përgjëruar, pas njëmbëdhjetë vjetësh ndarjeje, me birin e tyre të rritur e të pjekur para kohe, dhe me sa dhimbje do ta kenë përkëdhelur, duke e përcjellur

për të fundit herë. Dhe, në të vërtetë, ashtu ndodhi. Bir e prind nuk u panë më. Edhe në moshë të thyer, në veprat madhore, Fan S. Noli nuk do të mungojë ta kujtojë nënën në shenjë mirënjohjeje të thellë.

Në 1912, të gjitha organizatat atdhetare të shqiptarëve në Amerikë u bashkuan dhe themeluan federatën panshqiptare «Vatra». Fan S. Noli qe një nga frymëzuesit dhe nismëtarët e saj kryesorë. Në vazhdim të studimeve të pandërprera, po këtë vit mori diplomën «Bachelor of Arts cum laude» në Universitetin e Harvardit.

Duhet thënë, ndërkaq, se jo për të gjitha çështjet e ndërlikuara politike dhe ideologjike të lëvizjes kombëtare të kohës Noli kishte mendime të shëndosha, sepse ende nuk ishte çliruar nga disa pikëpamje patriarkale, siç qe ajo që shprehu më 1907 dhe që e përsëriti më 1911, lidhur me «baballarët» dhe bajraktarët si forcë kryesore, ku, gjoja, duhej mbështetur lufta për çlirimin nga Turqia. Në vazhdim të kësaj pikëpamje, më 17 tetor 1912, nga frika se, me shkatërrimin e Turqisë, Shqipërinë do ta copëtonin fqinj-të shovinistë, arriti të lutej për sulltanin dhe perandorinë e tij: «Zot i drejtë, fali mundje (fuqi, V. B.) të shkëlqyer Perandorisë dhe ushtrisë s'onë, që lëfton në kufiret kundër armiqve, dhe jetë të gjatë e të lumtur perandorit t'onë, që të mundim t'a shohim Shqipërinë ashtu si dëshirojmë». <sup>14</sup> Natyrisht, me ngritjen e flamurit kombëtar në vlorë, me krijimin e qeverisë së parë kombëtare dhe shpalljen e pavarësisë, Fan S. Noli nuk ju përmbajt më kësaj pikëpamjeje të gabuar, përkrahu qeverinë e, si do ta shohim më pas, çmoi lart luftën e popullit shqiptar për çlirim, si dhe udhëheqësit e saj atdhetarë demokratë.

- 
- 1 Noli F. S.: «Letër» Thanas Tashkos, «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 45
  - 2 Bala V.: Letërsia shqipe e periudhës 1912-1939, dispencë, Tiranë, 1956, f. 50.
  - 3 Bala V.: Po aty.
  - 4 Sp. Kastrati J.: Lufta për mësimin e alfabetit shqip në vitet 1878-1905, në «Kongresi i Manastirit», Shkodër, 1969, ff. 29-30.
  - 5 Ligjëron Fan Noli mbledhur nga Lefter L. Dilo, Tiranë, 1944, f. 51.
  - 6 Bala V.: Po aty, f. 51
  - 7 Bala V.: Po aty, f. 53
  - 8 Bala V.: Po aty, f. 50
  - 9 USHT, IHGJ: Historia e Shqipërisë, v. II, Tiranë, 1965; f. 377
  - 10 Ligjëron Fan Noli, f. 21
  - 11 Viljam A., Biografia e Xhon Ridit, në librin Xhon Rid: *Dhjetë ditë që tronditën botën*, e përktheu Mumtaz Shehu, Tiranë, 1958, f. 363.
  - 12 Ligjëron Fan Noli, ff. 28-30
  - 13 Ligjëron Fan Noli, ff. 361-41
  - 14 Bala V.: Vepër e cituar, f. 52



## KAPITULI I KATËRT

### TAKIMI I PARË ME SHQIPËRINË

**Luftëtar për sigurimin e pavarësisë dhe të tërësisë tokësore të atdheut.**

Me shpalljen e pavarësisë kombëtare nuk u siguruan liria dhe tërësia tokësore e Shqipërisë, ndonëse qeveria e përkohshme, e kryesuar nga Ismail Qemali, bëri përpjekje të mëdha, duke u përkrahur nga forcat përparimtare të vendit.

Më 20 dhjetor 1912, ushtritë greke pushtuan Korçën. Më 22 mars 1913, Konferenca e ambasadorëve caktoi kufitë verior dhe lindor të Shqipërisë, duke lënë jashtë, me të padrejtë, shumë toka shqiptare, ashtu si më 11 gusht në kufirin jugor. Më 23 prill, kryefeudali tradhëtar, Esat Toptani, ja dorëzoi Shkodrën Malit të Zi; më 8 maj u bë marrëveshja e fshehtë midis Austro-Hungarisë dhe Italisë për pushtimin e Shqipërisë; në shtator shpërtheu në Dibër dhe u përhap në Rrafshin e Dukagjinit kryengritja kundër trupave pushtuese serbe, e cila vazhdoi edhe në tetor; më 17 dhjetor Protokoll

i Firencës përcaktoi përfundimisht kufitë e shtetit shqiptar. Në vitin 1914 gjendja e vendit u ndërlikua edhe më shumë. Më 22 janar qeveria e Ismail Qemalit dha dorëheqjen, më 2 mars ushtria shqiptare hyri në Korçën e çliruar, më 7 mars princi i huaj, Vilhelm Vidi, arriti në Durrës i caktuar nga një marrëveshje e fuqive të mëdha imperialiste, më 17 maj filloi kryengritja në Shqipërinë e Mesme kundër regjimit të Vilhelm Vidit, i cili u largua nga vendi ynë më 3 shtator.

Ndërkohë kishte filluar Lufta e parë botërore. Më 23 nëntor shpërtheu kryengritja fshatare kundër Esat pashë Toptanit, kurse më 25 dhjetor Italia imperialiste pushtoi Vlorën. Në vitin 1915, vendi i ynë u kthye në shesh armësh për shtetet ndërluftuese. Më 26 prill u nënshkrua traktati i fshehtë i Londrës, që u denoncua më vonë nga V.I. Lenini; më 13 maj Haxhi Qamili u bë komandant i përgjithshëm i forcave kryengritëse fshatare, të cilat u shtypën më 12 qershor nga ushtritë shoviniste serbe, që kishin shkelur Shqipërinë e Mesme dhjetë ditë më parë; më 11 qershor ushtria shoviniste malazeze e pushtoi Shkodrën. Në vazhdim të luftës botërore, Shqipëria pësoi ngaditë e më shumë pasojat e saja grabitqare. Më 16 janar 1916 ushtritë imperialiste austro-hungareze pushtuan Shqipërinë e Veriut, kurse në mars edhe të Mesmen; në shtator-tetor ushtritë imperialiste italiane shkelën Gjirokastrën, Sarandën dhe Përmetin, kurse në tetor ushtritë imperialiste franceze Korçën. Revolucioni socialist i tetorit, që ngadhënjeu më 7 nëntor 1917, ushtroi ndikimin edhe në lëvizjen kombëtare shqiptare të çlirimit. Populli u qëndroi burrërisht pushtimeve të

huaja dhe shtrëngoi radhët për çështjen e pavarësisë e të tërësisë tokësore të vendit. Më 7 nëntor 1918 u formua Komiteti «Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës». Përballë synimeve grabitqare të fuqive të mëdha dhe të shovinistëve fqinj për ta copëtuar Shqipërinë, forcat përparimtare dhe demokratike shqiptare, në luftë kundër forcave reaksionare kapitulluese të vendit, bënë përpjekje të pareshtura brenda dhe jashtë atdheut, pranë «Konferencës së Paqes» në Paris dhe gjetiu.

Në këto rrethana të ndërlikuara politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, Fan S. Noli nuk qëndron i veçuar, por merr pjesë në përpjekje për të siguruar pavarësinë dhe tërësinë tokësore. Fill pasi u ngrit flamuri kombëtar në Vlorë, ai erdhi sërisht në Evropë, për të vazhduar luftën e nisur kundër pretendimeve grabitqare të shovinistëve fqinj, sidomos atyre grekë. Në Evropë qëndroi tre vjet. Vizitoi kryeqytetet e shteteve të mëdha — Anglisë, Francës, Austrisë. Erdhi, për të parën herë, në atdheun e dëshiruar. Ishte takimi i tij i parë me Shqipërinë. Erdhi djalë tridhjetenjëvjeçar, i njohur si agitator dhe veprimtar me prirje demokratike i lëvizjes kombëtare në rrethet e mërgimit shqiptar, publicist dhe gojëtar, dramaturg dhe poet, shqipëruës dhe klerik. Kur do t'i ketë parë për të parën herë brigjet shkëmbore të Shqipërisë, të rrahura nga Adriatiku kaltërosh, kushedi ç'mendime dhe ç'ndjenja do ta kenë pushtuar, kushedi ç'mall do ta ketë rrëmbyer, kushedi ç'frymëzim do ta ketë joshur! «Dielli» i 28 shtatorit 1913 botoi këtë lajm të Nolit nga Vlora: «Sa për Shqipëri, u shkruanij se punërat venë mirë. Po të ndodheshit në Vlorë, do të çudite-

*shit me pritjet e mëdha që më bënë muslimanët dhe të krishterët».*


Pas përkrahjes që i bëri Qeverisë së përkohshme kombëtare të kryesuar nga Ismail Qemali, Noli, ashtu si disa të tjerë, që patën iluzione për të realizuar bashkimin kombëtar në një shtet të vetëm, përkrahu edhe qeverinë e Vilhelm Vidit. Por shpejt këto iluzione u kthyen në zhgënjime, kur princi i huaj u mbështet në forcat feudale reaksionare të vendit. Më 10 mars 1914 e shohim Nolin në Durrës. Pikërisht në këtë kohë ai shkruan dy vjersha politike: «Bismilah tridhjet' seneja» dhe «Thomsoni dhe Kuçedra». Te e para, poeti demaskon dhe tall feudalin Dervish bej Biçakun si turkoman fanatik, si njeri që, mbi çështjen e Shqipërisë, vë interesat e Turqisë dhe ato të vetat klasore feudale. Vjersha është shkruar në vargje tetërrokëshe, në strofa katërshe, në rima të puthura, në një gegërishte të ngarkuar me orientalizma, për t'ju përshtatur së folurës së beut reaksionar të satirizuar, p.sh.

*«Jena turq, elam — durulá,  
Mbret kaur s'duem, stakfurullá  
Jena turq s'e prishim dinin  
Desim për kuran mylbinin»<sup>1</sup>.*

Te e dyta, poeti vërsulet me sulm epik kundër reaksionit esadist, të cilin e përfytyron në mënyrën hiperbolike popullore në krijimtarinë si një «*Kuçedër me katërqind krahë lubi e Davletit*». Kundër këtij përbindshi ngrihet një forcë e madhe për të shpëtuar atdheun:



Fan S. Noli



*«Dhe kokën ia shtypi me top nga kalaja,  
Kur hodhi Esadin nga froni, nga maja,  
Nga froni në pluhur, nga bregu në det,  
Me grusht prej rrufeje, që grin e që tret.»*

Vjersha është shkruar me duf hakmarrës, në ritmin e një marshi luftarak, në aliteracione shumë të goditura imituese të veprimit, në një simetri shumë të përpikët strofash origjinale, ku zotërojnë gjashtërokëshat e dyzuar, krahas distikut hyrës në formë kushtrimi «*Te Ura, te Ura — vraponi, o burra!*»

Lufta botërore e gjeti, pra, në Durrës. Që andej hidhet në Itali, merr pjesë në «Kongresin e Trieshtes», si përfaqësues i shqiptarëve të mërguar në SHBA dhe, pastaj, jo pa rreziqe, largohet nga Evropa për t'u kthyer në Amerikë. Arrin atje më 24 maj 1915. «Dielli» i kësaj kohe boton këto radhë të Nolit: «*Shqiptarët e Amerikës i kanë bërë Shqipërisë shumë shërbime dhe s'kam dyshim që dëshërojnë të organizohen e të drejtohen me një mënyrë të tillë që të jenë të zotërit t'i ndihin më tepër se më parë atdheut dhe t'a shpëtojnë nga mjerimet e sotme. Vihem në shërbim të tyre me mish e me shpirt. Do t'u flas më gjërë atdhetarëve të dashur me gojë dhe me shkrim. Mirë se ju gjeta!*». Më 18 gusht të këtij viti, në «introduktën» e shqipërimin që i bëri, tragjedi e së U. Shekspirin «Otello», ai shkruan ndër të tjera: «*Po u ap Shqiptarëve një kryeveprë shakespeareane në gjuhë të tyre. Jam munduar pesë muaj që t'a shqipëronj dhe dy muaj të tjerë që t'a limonj e t'i*

an formën e funtme. Këndonjësit do të gjykojnë në e ktheva mirë. Unë mburrem vetëm që munda t'a kthenj».

F.S. Noli u kthye kësaj radhë në SHBA në një kohë kur në atë vend ishte shtuar mërgimi shqiptar, si rrjedhim i barbarizmave greke në Jug të Shqipërisë. në një kohë kur masa e të mërguarve u radhit rreth «Vatrës» dhe «Dielli», nga organ i përjavshëm, bëhet i përditshëm. Kuvendi i «Vatrës» e zgjodhi tani Nolin kryetar.

Më 21 dhjetor 1915, pas një ndërprerje të shkurtër, ai merr sërish në dorë drejtimin e fletores «Dielli», që e mban deri më 6 korrik 1916. Ndërkohë «Vatra», nën kryesinë e tij, arriti të ketë afro njëqind degë, që nga Men deri në Kaliforni. I kësaj kohe është shqipërimi i tij mjeshtëror i poemës epike «Kthimi i Skënderbeut në Krujë» nga «Tregime të një hani buzë rruge» të Hanri Uotsuorth Longfellout. Poema mbyllet me marrjen e kështjellës së Krujës nga ana e Gjergj Kastriotit:

*«Nga kështjella shpejt ka rënë  
Flamuri me gjysmëhënë  
Edhe populli shikon  
Që në vent të tij valon  
Flamuri Skënderit n'erë.*

*Dhe një thirrje lart u ngrit,  
Se çdo zemër e çdo shpirt  
U mërzit nga Turku i lik,  
Q'ë kish bërë atë Krujë  
Zi, murtajë dhe rrëmujë.*



*Ay zë, me gas, me bujë,  
Q'oshëtin nga brek në brek,  
Është: «Rrofsh, o Skënderbeg!»*

*Ja kështu Skënderi trim  
Mori Krujën me rrëmbim:  
Edhe lajma u përhap  
Si një flagë, si një zjarr  
Q'i fryn era në behar  
Dhe qytetet afër lark  
Thotë Ben Isa Ben Miri  
Në Qitap të tij fakiri:  
«Binin m'atë lehtësi  
Që ze burri veshn'e tij».*

Të duket se s'ke të bësh me një poemë të huaj të kthyer shqip, por me një poemë shqiptare, në frymë dhe metrikë popullore. Dhe, kështu, me vjershërinë origjinale e me shqipërimet artistike, vjen duke u skalitur ai stil, që do të shpërthejë tani e tutje me sulme e ritme të reja buçitëse, me mendime e ndjenja demokratike, në motive dhe tema aktuale politike dhe shoqërore. Më 1917, me rastin e një fushate ndihmash, që hapi «Vatra», «Për shpëtimin e Shqipërisë», te shqiptarët e mërguar, poeti shkroi vjershën «Jepni për Nënë!» Me gjithë karakterin agjitativ, gjejmë të shprehur me patos të fuqishëm dashurinë e flaktë për Shqipërinë, besimin e patundur në të ardhmen e saj. Vjersha është hartuar në trajtën e një fjale prekëse dhe luftarake që autori ua drejton bashkatdhetarëve, për të mos u kursyer ndaj «Nënës së mjerë». Ajo nis me një parafytyrë të Shqi-

përisë së cfilitur nga shkelësit e huaj dhe reaksioni i brendshëm:

*«Faqe — çjerrur, lesh — lëshuar,  
Shpirt e zëmër përvëlur...»*

Pamja plotësohet me vargjet e mëposhtëme, ku poeti vijon të tregojë për fatkeqësitë që i kanë rënë mbi krye atdheut. Noli aludon për vitet 1914-1915, kur elementët antikombëtarë e çuan shtetin e porsakrijuar shqiptar në buzë të greminës, duke bërë pluhur e hi theroritë dhe mundimet shumëvjeçare të atdhetarëve për sigurimin e lirisë dhe të pavarësisë. Ky tregim prekës ndërpritet nga thirrjet e zjarrrta, drejtuar shqiptarëve për t'i dalur zot mëmëdheut. Mbaron vjersha me thirrjen e poetit për të ndimuar pa u kursyer, njëkohësisht me shpresën se shqiptarët e mërguar atdhetarë do t'i përgjigjen detyrës me gjithë shpirt:

*«Armë dhe fishekë mblithni,  
Qesen edhe shpirtin hithni:  
Për lirin'e vendit t'onë,  
Sot — se nesër është vonë.  
Jepni, Nënë të shpëtoni,  
Komb e vatra të nderoni!»*

Duke vazhduar të denoncojë, si në vjershën «Thomsoni dhe Kuçedra», reaksionin feudal, poeti grish për luftë të papajtueshme kundër këtij reaksioni në atdhe:

*«Cilët bij të tradhëtuan  
Dhe të doqnë dhe të shuan  
Dhe të lan' o Shkab'e ngratë*

*Pa fole, pa zoq, pa shpatë?  
Këta qena, o shok'i mbytni,  
Mbushni gjyle që t'i shtypni!»*

Ndjenja e ngrohtë për atdheun dhe forca me të cilën stigmatizohen tradhëtarët e bënë vjershën politike qytetare «Jepni për Nënë!» mjaft popullore në atë kohë të shqiptarët e mërguar.

Më 1918, ndërsa drejtonte organin «The Adriatic Review» («Revista Adriatike»), që botonte inglisht fletorja «Dieli» e «Vatrës» si shtojcë të përmuajshme, shqipëronte vjershat mistiko-simboliste të E.A. Poe-s «Korbi» dhe «Annabel Lee», te të cilat, me sa shihet, e tërhoqi forma më shumë se përmbajtja, ashtu si do të ndodhë edhe te disa shqipërime të tjera të pakta më vonë, në vitet '30-të. Por duhet shtuar se «*Qysh në këto përkthime, që përbëjnë vetëm fillimin e punës së tij kolosale në këtë fushë, duket mjeshtëria e përkthenjësit artist, potenciali gjuhësor, përpjekja e studjonjësit dhe e lëvtronjësit të apasionuar të gjuhës për të kapërcyer një mori problemesh që i dilnin përpara gjuhës sonë, sidomos letrare, me gjithë kontributin e çmuar që kishin sjellë në zhvillimin e saj shkrimtarët e Rilindjes*»<sup>2)</sup>.

Më 9 shkurt 1918, Fan S. Noli i dërgon nga Bostoni një letër mësuesit të thjeshtë në Rehovë të Kolonjës, Kiçon K. Priftit. Me të ai e falenderon për dhuratën prej pesë dollarësh që ky i kishte dërguar: «*Ju falem nderit shumë për dhuratën prej 5 dollarësh që më dërguat. . .*»<sup>3)</sup>

Me sa duket, gjendja ekonomike e Nolit në këtë kohë nuk ishte e mirë.

Periudha e viteve 1912-1920 mbyllet me ngri-

tjen e tij nga funksioni i priftit në atë të peshkopit të kishës ortodokse. Ai vazhdoi luftën kundër reaksionit grek ndaj lëvizjes për sigurimin e pavarësisë dhe të tërësisë tokësore të atdheut, që të hidhet, në vitet e ardhshme, në luftën e ashpër për një regjim demokratik, kundër reaksionit feudal në Shqipëri. Vjen përsëri në Evropë, kësaj radhe si përfaqësues i federatës panshqiptare «Vatra», për të mbrojtur, pranë «Konferencës së Paqes» në Paris, interesat e Shqipërisë.

---

1 Noli F. S., *Bismilah tridhjet' seneja*, vjershë e shkruar më 1914 nga poeti dhe e ruajtur nga Milto Sotir Gurra. Citojmë sipas dorëshkrimit të Milto Sotir Gurrës.

2 Musaraj Sh., *Fan S. Noli*, «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 7.

3 Noli F. S. «Letër» Kiçon K. Priftit origjinali në dorën e marrësit, në Rehovë.

## **KAPITULLI I PESTË**

### **NË SHQIPËRI, NË KRYE TË REVOLUCIONIT DEMOKRATIK BORGJEZ**

**«Yrsh, t'i vemë shqelmin feudalizmit!»**

Në periudhën historike të viteve 1920-1924, F. S. Noli lidhet nga afër me ngjarjet kryesore, që shënuan rritjen e lëvizjes demokratike antifeudale dhe antiimperialiste.

Më 21 janar 1920 hapet Kongresi i Lushnjës dhe më 11 shkurt qeveria, e dalë nga ky Kongres, vendoset në Tiranë; në prill formohet në Vlorë Komiteti Mbrojtja Kombëtare, më 5 qershor nis Lufta heroike e Vlorës për dëbimin e shkelësve italianë, më 13 qershor demokrati revolucionar, Avni Rustemi, vret në Paris kryefeudalin tradhëtar, Esat Pashë Toptanin.

Më 21 korrik 1920, Fan S. Noli erdhi për të dytën herë në atdhe me shpenzimet e «Vatrës».

Më 18 gusht mbahet në Lushnje Kongresi i arë-

simtarëve, më 3 shtator ushtritë shoviniste jugosllave ndërhyjnë me armë në Shqipërinë e Mesme.

Në betejat politike, që zhvillohen tani, Noli merr pjesë vepruese. Më 5 prill 1921 bëhen zgjedhjet për Këshillin Kombëtar. Që në fillim të këtij viti nisën të dallohen qartë dy rryma politike: ajo, që mbronte platformën e Kongresit të Lushnjës, dhe ajo që ishte kundër saj. «Vatra» caktoi Nolin për t'u zgjedhur si përfaqësues i saj në parlamentin shqiptar. Dhe Noli u zgjodh. Një vit shërbeu si deputet i «Vatrës» dhe një vit si deputet i Korçës. Në Këshillin Kombëtar u përcaktuan dy grupime politike, ndër të cilët më i rëndësishmi ishte grupimi i quajtur popullor, ku bënë pjesë, menjanë, bejlerë dhe elementë borgjezë konservatorë. dhe, më anë tjetër, demokratët, kryetar i të cilëve u bë F.S. Noli. Në qershor të këtij viti, ai kryeson delegacionin e qeverisë shqiptare në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, ku i bën mbrojtje të fuqishme çështjes shqiptare.

Ngjarjet ndjekin me shpejtësi njëra-tjetrën. Më 7 dhjetor formohet qeveria e Hasan Prishtinës, me përbërje elementësh demokratë, në të cilën Noli kryeson dikasterin e punëve të jashtme. Por, pas katër ditësh, kjo qeveri detyrohet të japë dorëheqjen, për shkak të presionit të reaksioni zogist. F. S. Noli caktohet ministër i punëve të jashtme edhe në një qeveri tjetër, por jep dorëheqjen në shenjë mospranimi të politikës reaksionare që ndoqi kjo qeveri. Në këto rrethana, më 1921, doli në Boston vepra e tij madhore në prozë «Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit).» E botoi shtypshkronja e «Die-

BOTIME TE PREDIKATES  
PAN-SHQIPTARE "VATRA"

# HISTORIA E SKENDERBEUT

*(Gjergj Kastriotit)*

MBREHTIT TE SHQIPERISE  
1412-1468


*Prej Peshkopit Theofan*

*(Fen S. Noli)*

E botuar prej Shoqërisë Korçare  
"Arëgimi"

BOSTON  
Shtypshkronja "Dielli"  
1921

Historia e Skënderbeut





llit» në kuadrin e botimeve të federatës panshqiptare «Vatra» me ndihmën e shoqërisë korçare «Arësimi». Autori ja kushtoi nënës së vet, Maries, «për kujtim dhe mirënjohje». Autori ishte dyzetvjeçar. Parathënjen e kishte shkruar në Boston që më 20 maj 1920, dy muaj para se të vinte së dyti herë në Shqipëri.

Fytyra e kryetrimimit të shekullit XV e pat tërhequr shkrimtarin që në rini të parë dhe paskëtaj. Veprën e shkroi për t'i dhënë masës së lexuesve shqiptarë një libër mbi jetën dhe bëmat legjendare të udhëheqësit të pathyeshëm në luftat kundër shkelësve osmanë. «Qëllimi im, kur e shkrova këtë vepër — rrëfen autori në parathënje — ishte t'i jap popullit tonë një histori të Skënderbeut dhe kjo librë duhet gjykuar nga kjo pikëpamje». E shkroi me një gjuhë të kuptueshme, me një stil të gjallë. Për hartimin e veprës, autori u nis nga Marin Barleti, Tivarasi dhe historianë të tjerë, që kishin shkruar rreth Skënderbeut, librat e të cilëve i shoshiti me vëmëndje e durim, duke mbajtur qëndrim kritik në mjaft pika, ku ata s'përputheshin. Shqyrtimin e saktë dhe objektiv të burimeve ai e paraqiti në hyrje. Në qendër të veprës, që ndahet në katër kapituj, ngrihet fytyra e heroit, Gjergj Kastriotit, e përshkruar me dashuri të madhe. Për autorin, heroi ishte një prijës dhe strateg i shquar, që e kuptoi se vërshimit të ordhive osmane mund t'i ndalej hovi vetëm me një bashkim të qëndrueshëm armësh dhe forcash të popullit. Kjo meritë vihet në dukje përmes paraqitjes së Shqipërisë në vitet 1356-1443 dhe të mosmarrëveshjeve që i kishin ndarë princët shqiptarë, duke dobësuar kështu qëndresën përballë turqve. Me


këtë bashkim dhe me krijimin e një ushtërie të përhershme dhe të stërvitur mirë, radhët e së cilës shumëfishoheshin në rast lufte, Skënderbeu fitoi kundër ordhive mizëri të armikut, që kishte vënë nën thundrën e vet sa e sa popuj dhe që i kishte kallur tmerrin Evropës. Autori e paraqet heroin të veshur me disa tipare fantastike, legjendare. Me një frymë përrallore përshkruhet lindja e Skënderbeut. Një përshkrim i tillë tërhiqte lexuesit, por nuk jepte me vërtetësi rrethanat jetësore. Ashtu si Barleti, edhe Noli krijoi portretin e jashtëm të një heroi të përkryer, ku virtyteve të larta morale u përgjigjej një pamje e hijshme dhe burrërore: «*I gjatë, i hijshëm, me një trup të derdhur prej statuje, me sy të squar, që nxirrin shkëndija. . . Kur lëftonte, si na thonë ata që e kishin parë me sy, përvishte mëngët për të përdorur më lirisht shpatën e jataganin. Krahe më të bukur prej burri, thotë Barleti, s'ishin parë gjer atëherë. Turqit provuan më vonë se çfarë force të tmerruar kishin krahet e tij*».

Noli thekson talentin e Skënderbeut si burrë shteti dhe diplomat, vë në dukje gjakftohtësinë në gjendjet e rënda të punëve dhe aftësitë për t'u dhënë zgjidhje të shpejtë çështjeve më të vështira, që i dilnin përpara. Krahas punës për forcimin e ushtrisë dhe sigurimin e mjeteve të nevojshme për t'i bërë ballë armikut, ai përpigjej të fitonte aleatë të rinj dhe ndërmirrte hapa, që synonin në dobësimin dhe shpartallimin e forcave të gjalla të kundërshtarit. Marrëdhënjet me princët e ndryshëm shqiptarë, që lëkundeshin me tiparet e tyre prej feudalësh, me prirjet e tyre centrifugale, lidhjet që mbante me fuqitë e huaja, të cilat silleshin me të pabesë ndaj

çështjes shqiptare, të gjitha këto e paraqitin Skënderbeun si politikan me një mendje të hollë. Nga penda e shkrimtarit del një Skënderbe i dashur për popullin. Për këtë udhëheqësi përkujdeset si një shok i afërt, që i këshillon të mos ekspozohen dhe i ruan nga sulmet e pamatura, që mund të bëjnë, të shtyrë nga entuziazmi dhe guximi i madh. Dashuri dhe nderim ka ai për komandantët si Vrana Konti, Ajdin Muzaka etj. Pas betejave shfaqej më hapur madhështia e tij morale. Në çdo mënyrë përpiquej të theksonte se fitorja ishte meritë e të gjithëve dhe të gjithë i falenderonte për trimëritë e rrëfyera, duke u bërë blatime të shumta. Ndeshjet dhe ngjarjet e ndryshme Noli i jep përmes një tregimi të gjallë, që e tërheq lexuesin. Ka në këtë prozë faqe të një poezie të vërtetë. Duke përdorur një stil të ngritur oratorik në përshtatje me frymën e epopesë shqiptare zulmëmadhe dhe parafytyrimin popullor romantik, shkrimtari na sjell një pamje herë thellësisht lirike, herë dramatike dhe epike. Veçanërisht të goditura janë tablotë e luftës me turqit, ku pikëzohen heroizmat e shqiptarëve dhe egërsia e turqve. Proza e Nolit, në këtë vepër, paraqitet mjaft e përpikët në ndërtim, me priudha të rrjedhshme e të harmonishme, me një fjalor të pasur në fjalë e shprehje, ndonëse jo krejt i pastër nga fjalët e huaja. Noli ndoqi Barletin, por edhe krijoi veçoritë e stilit të vet, kaq të ngjashëm me atë të dramës, të gojëtarisë dhe të vjershërimit. Pas poemës së Naim Frashërit dhe të Jeronim De Radës, Gavril Darës së Ri dhe të ndonjë tjetri, ku del figura e Skënderbeut, vepra e Nolit është një realizim letrar dhe historik, që luajti një rol të dukshëm edukues atdhetar në masën e lexuesve shqip-

tarë të kohës. Këtë vepër autori nuk e quajti plotësisht të përfunduar. Si do ta shohim më vonë, vazhdoi ta përpunojë. Sipas shënimit që do të bëjë në parathënjën e botimit të dytë shqip, më 1949, do të përpiqet t'i mbushë gollet e botimit të parë me hulumtimin e studimeve të dijetarëve të ndryshëm, që janë marrë me këtë subjekt, si dhe të kronikanëve turq UruXH, Ashik-Pasha-Zade, Saad-ed-din, të cilët nuk i shfrytëzoi më parë. Megjithatë, si botimi i parë, si ai i dyti, mbetën të mangët nga ana e analizës së faktorëve ekonomikë dhe shoqërorë mbi bazën e botëkuptimit të thellë materialist të historisë. Për më tepër, në botimin e vitit 1921, Skënderbeu doli me disa tipare përralore, nga të cilat autori do të përpiqet ta zhveshë më vonë deri në ekstremin tjetër të identifikimit me fshatarësinë. Botimi i veprës «Historia e Skënderbeut» e bëri Nolin ende më shumë të njohur, brenda dhe jashtë atdheut, si artist të fjalës dhe historian.

Ardhja e tij në Shqipëri shtoi radhët e miqve. Përveç bashkëluftëtarëve, Luigj Gurakuqit dhe Stavro Vinjaut, Bajram Currit dhe Avni Rustemit, ai mbante lidhje të ngushta miqësore edhe me shokët e vjetër të mërgimit, shtrëngonte miqësi edhe me të njohurit e rinj. Si dihet, me lëvizjen demokratike u bashkuan kolonitë shqiptare të mërgimit në pjesën më të madhe, sidomos federata panshqiptare «Vatra», të cilat Noli ushtronte një ndikim të madh. I këtij viti është edhe botimi i parë i shqipërimit të romanit «Kasollja» të Vicente Blasko Ibanjezit, përshatur mjeshhtërisht sipas frymës dhe mjedisit fshatar shqiptar, në një kohë ku fshatarësia jonë shfrytëzohej ashpër nga klasa feudale.



Fan S: Noli



Në mars të vitit 1922 zgjerohet lëvizja për thirrjen e Kuvendit Themeltar (Asamblesë Kushtetuese); në tetor, pasi federata «Atdheu» qe shpërndarë nga reaksioni, u themelua organizata «Bashkimi» nën udhëheqjen e Avni Rustemit; më 8 dhjetor pranohet statuti i zgjeruar i Kongresit të Lushnjes. Opozita demokratike, në krye të së cilës u vu Fan S. Noli, doli hapur kundër qeverisë reaksionare që në shtator të këtij viti, kur u mblodh Këshilli Kombëtar. Noli, bashkë me demokratë të tjerë, luajti një rol të dukshëm në pranimin e statutit të zgjeruar, që përmbante disa norma demokratike.

Tri letra që Fan S. Noli ja dërgon këtë vit nga Tirana Ikonom Josifit në Korçë, hedhin dritë mbi një veprim politik me rëndësi. Deri atëhere, në krye të kishës ortodokse qëndronte një dhespot grek, i emëruar nga Patriarkana e Stambollit. Nëpërmjet kishës ortodokse, shovinistët grekë të Patriarkanës kërkonin të realizonin ëndrrën e tyre «Greqinë e madhe» duke aneksuar në kufitë e shtetit grek Korçën dhe Gjirokastrën. Dhespoti grek e përdorte fenë si mjet për të mbajtur nën ndikimin e vet tërë besimtarët ortodoksë shqiptarë. «Dhimogjerondia» («Këshilli i pleqve») ishte nën ndikimin e dhespotit në fjalë, i cili, njëkohësisht, ishte kryetar i saj. Përpjekjet për ta shkëputur kishën ortodokse shqiptare nga ndikimi ose vartësia e kishës greke dhe për të themeluar kishën ortodokse të pavarur arritën një rezultat: «Kongresin» e Beratit. Besimtarët ortodoksë patriotë, që organizuan mbledhjen e këtij kongresi, niseshin nga qëllimi që ortodoksët shqiptarë duhej ta mbanin veten vetëm shqiptarë dhe të ndjeheshin vëllezër të një gjaku e të një gjuhe, të një kombi e të

një vendi me elementët shqiptarë të besimeve të tjera. Në letrën e parë, më 2 të vjeshtës së dytë 1922, Noli shkruan: «Nemni lejen t'ju përgëzonj për vepërën e çkëlqyer dhe istorike q'u mbarua në Berat nënë kryesinë Tuaj dhe nënë drejtimin Tuaj të urtë e të matur. Ndonse lark, kam pasur me zemër e për s'afërmi fazat e ndryshme të luftës suaj së shenjtë, e cila u kurorëzua me një sukses aqë të plotë sa edhe të papritur». Në letrën e dytë, më 1 nëntor 1922, ai shënon: «Hendeku i parë u-kapërxye me trimëri, zotësi e hollësi të rrallë, dhe suksezi nistor duhet t'ju japë shpresë dhe shiquri për kapërximin faqebardhë të hendekeve të tjerë».

Në letrën e tretë, më 24 nëntor 1922, duke para-lajmëruar për intrigat greke, ai porosit: «Mora letrën Tuaj më datë 2/15 nëntor dhe ju falem nderit për fjalët e mira që më shkruani si dhe për lajmet që më j-pni mi ftimin dhe ardhjen e Imzot Ierotheut. Ca nga hollësiat e kësaj pune i mësova tani për herën e parë. Kështu, pas erësirës, me të cilën u — pësh-tuall çapi i parë i Kishës Autoqefale, u — bë më në fund ditë. Uronj me gjithë zemër që kjo ditë të jetë e gjatë, e kthjellët e faqebardhë, po është gjithënjë frikë se mos i ngrysni jo aqë mirë sa kini shpresë. Në titullin «*παρquiaεξικὸς Εγαρχος* («I dërguari i Patriarkanës»), në tekstin edhe në drejtimin e telegramit, ka prapamentime të çkoqura si drita e diellit, e dhëntë Zoti të jem i gabuar, po këtyre jam i shiqur që do t'u bëni ballë pa humbur as kohën as kokën, sipas përgjegjësisë që kini marrë në Kongrës të Beratit përpara popullit orthodox e përpara shtetit shqiptar. Me qenë që jam personalisht i interesuar, s'e merr kalimi të hynj në çkoqitje. Nga ana tjetër,



*e quanj të tepër të zgjatem, se jini të mençur vetë sa për të dalë me vrap nga ky hendék i vogël». Pozita e F. S. Nolit është e qartë dhe e drejtë. Letrat në fjalë dëshmojnë për këtë pozitë të tij konsekuente që në fillimet e shekullit, tonë deri në ngrysjen e jetës së patriotit të shquar.*

Viti 1923 shënoi një ngritje të re të lëvizjes përparimtare në Shqipëri. Më 17 mars, duke folur në Këshillin Kombëtar në emër të Opozitës, Noli e karakterizoi kështu politikën reaksionare të qeverisë në fuqi: «*Shtypje e kundrështarëve heterodoksë dhe heretikë, eliminatë sistematike e elementëve të mirë me dinjitet, që s'duan të bëhen besnikë të dishiplinuar të fesë politike të guvernës, favoritizëm dhe akroballëk, që kalb çdo degë të administratës, gjumë dhe çkujdesje e ëmbël për çdo gjë konstruktive, forcë pa skrupull për vazhdimin në fuqi.*»<sup>2)</sup>

Në këtë kohë ai kërkoi në Këshillin Kombëtar t'u jipej toka fshatarëve, që e punonin, foli për gjendjen e mjerueshme të gruas shqiptare dhe për nevojën jetike që përbën për kombin «*Çështja e edukimit dhe e ngritjes së saj*», kurse, pas dy muajsh, hodhi në votë propozimin që edhe gratë të merrnin pjesë në zgjedhjet parlamentare, por shumica reaksionare e parlamentit nuk e pranoi.

Më 4 maj i shkruan mikut nga Rehova, mësuesit Kriçon K. Prifti: «*Jam hidhëruar tepër që vuani atje nga shtrenjtësia dhe nga hallet e tjera. Po këto i kemi kudo që të gjithë e kështu mund të ngushëllojmë njëri tjetrin*»<sup>3)</sup>. Sipas një shënimi që bën «*Shqiptar'i Amerikës*» më 18 gusht. Noli, deputet i «*Vatrës*», e shkoi vakancën në Vjenë «*duke mbledhur dokumenta mbi Skënderbeun nëpër bibliotekat e atij qyteti*».

Deputeti Fan S. Noli afirmohet si agjikator i flakët, si brenda ashtu edhe jashtë parlamentit, sulmon me duf dhe sarkazëm si feudalët kulltukofagë të vendit, ashtu edhe imperialistët e huaj dhe shovinistë fqinj të pabesë. Parulla e tij kryesore në këtë kohë ishte «Yrysh, t'i vemë shqelmin feudalizmit!»

Më 18 gusht, nga ballkoni i bujtinës «Metropol» të Korçës, ai i flet masës së popullit. E fillon ligjëratën me këto fjalë: «Kam ardhur për herën e dytë në qytetin t'uaj të bukur me gëzim të madh që të këmbëjmë mendimet mbi çështjen e Kuvendit Themeltar. Kam ardhur të shoh miqt'ë vjetër e të përpiqem të fitonj miq të rinj...» Dhe, duke folur për gjendjen aktuale, shtoi: «Na mbetet tani puna e rëndë të themelojmë një shtet modern... Po duhet të dimë që liria është në rrezik nga shkelësit e jashtëmë, nga shkelësit e brëndëshmë... Liria e një kombi mbahet vetëm me një vigjilencë të paresh-tur... për të siguruar lirit'ë qytetarit dhe për të hedhur themelet e tij po mblidhet Kuvendi Themeltar. Po, që të mbarojë qëllimin e tij, ky duhet me të vërtetë të përfaqësojë popullin, i cili duhet lënë i lirë të çfaqë mendimet dhe dëshirat e tij»<sup>4</sup>). Të nesërmen, më 19 gusht, mbajti një tjetër ligjëratë, në lulishten «Themistokli Gërmenji», në të cilën stigmatizoi ashpër reaksionin e brendshëm feudal, që kishte vendosur një pushtet të hurit e të litarit: «Kabineti ynë i sotmë është në kuptimin e plotë të fjalës kabineti i pykave. Se, ca janë pyka nga dituria e ca janë pyka nga vlera civile. Dhe është në natyrë të pykave të jenë të rrethuar me pyka e me dallkaukë. Ideali i tyre nuk është t'organizojnë shtetin, se as ata vetë s'dinë t'a organizojnë, as organizatorët nuk do t'i

lenë të lirë. Ideali i tyre është të mbajnë kulltukët me çfarëdo çmim. Mjetet e tyre për t'arrirë këtë ideal janë druri dhe rushfeti». Dhe i shfaqti masës kërkesën: «Duam një qeveri të popullit, prej popullit, për popullin, të përbërë prej njerëzve më të ditur, më patriotë, më të zotërit e më të nderçmit». 5)

Më 26 gusht e shohim në Gjirokastrë, tek mban një fjalim në sheshin «Çerçiz Topulli», ku paraqiti edhe një herë programin e vet dhe të cilin populli e priti shumë mirë. Asnjë tjetër si ai, në atë kohë, nuk e denoncoi reaksionin e brendshëm me kaq forcë dhe elokuencë: «Këtu idealet e errëta, të shtrembëra e të munifikuara të Fanarit e të Buharasë përfyten e përleshën në një luftë për vdekje me idealet më të gjalla... Na mungojnë vetëm idealet e antropofagëve. Po, për të zënë vendin e këtyre, kemi kulltukofagët, krimba të verdhë me kokë të zezë, që rriten me plagët e infektuara të Shqipërisë në lëngim, këpusha, që mund t'i copëtosh, po jo t'i çqitësh nga trupi që kafshojnë e thëthijnë... Që t'i çqitësh këta nga kulltuku duhet t'u preç jo vetëm duart e kokën, po edhe këmbët e trupin». 6). Në krye të këtij reaksioni qëndronte kryefeudali i Matit, Ahmet Zogu, i mbështetur nga bejlerë e bejlurçinë, nga laro e sejmenë anadollakë të vendit, dhe nga fuqi të huaja reaksionare. Në një replikë të mprehtë, Noli, kryetar i krahut demokratik, e demaskoi Zogun me këto vargje satirike popullore:

«Rroftë Ahmed Zogu, rroftë,  
Shakaxhiu i përparimit,  
Brez pas brezi, u-kujtoftë  
Si stërnip i Nastradinit!».

Por, në këto ligjërata, ka edhe kontradikta e pështjellim mendimesh, deri në mohimin e qenjes së klasave shoqërore në Shqipëri: «*Këtu s'ka as klasë bejlerësh, as klasë bujqësh, as klasë burxhoazie. Bujku është më bej se beu dhe beu më bujk se bujku*». 7) Ka, në këto ligjërata, iluzione për parlamentarizmin dhe «demokracinë» anglo-saksone, për presidentin e SHBA-së, U. Vilson, të cilit i ngriti një homazh të rrallë.

Viti 1924 shënoi një kthesë të fortë në lëvizjen demokratike, Revolucionin demokratik borgjez të qershorit. Ngjarjet ndoqën njëra-tjetrën në mënyrë të vrullshme. Më 2 shkurt hapet Asambleja Kushtetuese; më 4 shkurt mbahen në asamble pesë minuta zi për kujtimin e V.I. Leninit; më 20 prill reaksioni organizon atentatin kundër Avni Rustemit, udhëheqësit të organizatës «Bashkimi». «*Dielli*» i 24 prillit shkroi: «*Die mbrëma, një vendës i Tiranës shtiri mbi Avni Rustemin dhe e plagosi rëndë. Avniiu vdiq brenda pak orësh. Kush e bëri këtë krimë? Të gjitha shënjat tregojnë që Ahmet Zoqu ish arkitekti i saj*». Noli me shokët e vet vajti në Vlorë për ta përcjellur në varr bashkëlufëtëtarin e shquar dhe për të drejtuar kryengritjen e armatosur. Varrimi madhështor u bë më 1 maj në Vlorë. Në një telegram dërguar nga Vlora, po këtë ditë, shokëve të «Vatrës» në Amerikë, Noli shkroi: «*Vrasja e Avni Rustemit ndezi një zemërim an'e mb'anë Shqipërisë. Njëzet' e gjashtë deputetë të opozitës lajmëruan sot se nuk do të kthehen në Tiranë veç nëqoftëse gjendja normale vendoset përsëri, edhe proponuan që gjer ahëre Kuvendi Themeltar t'i mbanjë mbledhjet në një tjetër qytet*». Mbi varrin e Avniut ai mbaj-

ti një ligjëratë shumë të frymëzuar dhe të zjarrtë: «Vlora, me klithmat e saj, e zgjoi tërë Shqipërinë nga letargjia... Nuk duhet të flemë të qetë gjer sa të gjenden edhe të dënohen fajtorët e kësaj vrasjeje. — Duhet t'i ndjekim vrasësit nga shpella në shpellë, nga përroi në përrua, nga bregu në breg, gjer sa t'i kapim»<sup>16</sup>). Me masat e fundit, që u morën në Vlorë për organizimin e kryengritjes së armatosur, Fan S. Noli u zgjodh kryetar i komisionit administrativ për drejtimin politik të saj. E zgjodhi Kuvendi i opozitës demokratike. Më 20 maj, forcat e komanduara nga Bajram Curri fillojnë veprimet kryengritëse; më 31 maj, garnizonet e Shkodrës dhe të Përmetit fillojnë gjithashtu nga këto veprime kryengritëse. «Dielli» i 3 qershorit boton këtë kablogram nga Vlora: «*Ushtëria kombëtare merr masa për çarmatosjen e bashibozukëve të Tiranës. — Noli*». Më 10 qershor, kryengritësit çlirojnë Tiranën dhe më 16 qershor formohet qeveria e dalë nga Revolucioni demokratik me në krye F. S. Nolin.

Fitorja e Revolucionit demokratik borgjez të qershorit shënoi një etapë të rëndësishme në zhvillimin historik të popullit shqiptar. Por e ardhmja e këtij revolucioni varej nga zgjidhja e detyrave themelore, siç ishin: organizimi i pushtetit të ri demokratik, çrrënjosja e feudalizmit, zgjidhja e çështjes agrare në dobi të fshatarësisë, etj

«*Rrethet demokratike radikale, të cilat e parashikonin se asgjësimi i plotë i feudalizmit dhe demokratizimi i vendit do të haste në qëndresën jo vetëm të çifligarëve, por edhe të bashk-udhëtarëve antizogistë të moderuar e konservatorë të revolucionit, u shprehën për vendosjen e diktaturës Noli — Curri, dy*

*udhëheqës të shquar demokratë të kryengritjes. Por ideja e diktaturës nuk gjeti aprovim të njëzëshëm».*<sup>9)</sup> Përbërja e qeverisë së kryesuar nga Noli pasqyronte koalicionin e forcave politike, që morën pjesë në revolucion. Noli shpalli më 19 qershor programin qeveritar prej 20 pikash, me anë të të cilit i premtoi popullit sigurimin e pavarësisë dhe të sovranitetit, vendosjen e një republike demokratike borgjeze, që të çrrënjoste feudalizmin, të bënte reforma ekonomike, shoqërore dhe kulturore, në mënyrë që forcat demokratike të kishin mundësi të përparonin për mbrojtjen dhe mbrothësinë e atdheut, emancipimin e popullit, veçanërisht të fshatarësisë. Kësaj, sipas programit duhej t'i jepej toka që e punonte; grujaja duhej të gëzonte të drejta të barabarta me burrin, kurse kombi të kishte barazi me kombet e tjera, të vogla e të mëdha, në fqinjësi dhe marrëdhënje të mira, sikurse me shtetet e tjera, edhe me shtetin e parë socialist, Republikën e Sovjetëve. Programi u prit mirë nga masat e popullit dhe nga rrethet përparimtare jashtë vendit. Shoqëria «Bashkimi» e përkrahu me të gjitha forcat. Fshatarësia e gjerë, së cilës Noli i premtoi reformën agrare që më parë, dhe rrethet demokratike të qytetit ushtruan presion të vazhdueshëm pranë qeverisë për ta realizuar programin qeveritar. Në gusht u organizua në Berat një miting i madh antifeudal. Por realizimi i atij programi hasi në vështirësi dhe pengesa për shkaqe subjektive dhe objektive, të brendshme dhe të jashtme. Revolucioni nuk u çua deri në fund. Në aparatën shtetëror qëndruan përsëri elementë reaksionarë, bashkëpunëtorë të A. Zogut, sidomos në ushtri. Qeveria çarmatosi edhe krahinat, që ishin mbështetje e revolucio-



Fan S. Noli dhe Bajram Curri në Tiranë, qershor 1924

THE UNIVERSITY OF CHICAGO PRESS



nit. Elementët demokratë radikalë të qeverisë, ndërta edhe Fan S. Noli, nuk luftuan me energji për të përballuar presionin gjithnjë më të madh të reaksionit të brendshëm dhe të jashtëm. Për më tepër, pikërisht atëhere, kur duheshin zgjidhur çështjet e brendshme dhe të drejtohej lufta kundër reaksionit dhe të realizoheshin reformat, udhëheqësit demokratë të recolucionit, F. S. Noli, L. Gurakuqi dhe B. Curri, u nisën më 22 gusht në Gjenevë, për të marrë pjesë në sesionin e pestë të Asamblesë së Lidhjes së Kombeve, që do të mbahej në shtator të atij viti. Nga ana tjetër, po fillonte stabilizimi i pjesshëm dhe i përkohshëm i kapitalizmit në Evropë. Lëvizja revolucionare ishte në rënjë. Po fuqizohej reaksioni në Ballkan. Në këto rrethana, si e vetmja qeveri demokratike në Ballkan, ajo u bë objekt i sulmeve, i shpifjeve dhe, më në fund, i ndërhyrjes së armatosur të reaksionit të jashtëm. E vetmja fuqi, që e mbështeti nga ana politike dhe morale, qe Republika e Sovjetëve.

Çështja e kufive të Shqipërisë nuk ishte zgjidhur ende përfundimisht, sepse qeveritë shoviniste të Jugosllavisë dhe të Greqisë kundërshtonin vazhdimisht. Noli, kryeministër dhe kryetar i delegacionit shqiptar, e mori fjalën disa herë në Këshillin e Lidhjes së Kombeve. «Ai mbrojti me këmbëngulje të drejtat e Shqipërisë dhe hodhi poshtë pretendimet shoviniste të fqinjvet, duke kritikuar njëkohësisht ngadalësinë me të cilën po shqyrtohej kjo çështje nga fuqitë e mëdha. . . Duke u mbështetur në mendimin e shprehur nga Gjyqi i Hagës, sipas të cilit vendimi i 6 dhjetorit 1922 i Konferencës së Ambasadorëve në lidhje me Shën Naumin duhej konsi-

deruar përfundimtar, Këshilli i Lidhjes së Kombeve, me vendimin e 6 tetorit 1924, ja njohu Shën Naumin Shqipërisë. . . Fan Noli e shfrytëzoi rastin e pjesëmarrjes së tij në sesionin e Asamblesë së Lidhjes së Kombeve edhe për të mbrojtur interesat e pakicës shqiptare në tokën e Greqisë, të cilën qeveria greke vazhdonte ta shpërngulte me forcë në Turqi». <sup>12)</sup> Në këtë sesion të Lidhjes së Kombeve, qeveria shqiptare, nëpërmjet Fan S. Nolit, kritikoi fuqitë e mëdha imperialiste dhe vetë Lidhjen e Kombeve për politikën mashtruese që bënin ndaj popujve, të cilët kërkonin drejtësi në marrëdhënjet ndërkombëtare. «Ç'po bëjmë tani në këtë Asamble? Ajo që është bërë në të pesë vjetët çlodhet në paqe — në paqe të përjetëshme — e kyçur në dosjet e vdekura të Sekretariatit dhe ruhet me kujdes prej atij të mirit gentelman, sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve». Dhe, më tutje: «Parlamenti është një sallë ku mblidhen politikanët pa shpirt, që bëjnë prova operate në trupin e gjallë të racës së vet, një sallë plot gaz të helmuar, gazi mbytës, gazi që sjell lot dhe gjithë gazrat e tjerë me të cilët u luftua luftë fundit, që t'u jipte fund tërë luftave dhe të vendoste paqë, paqën për të cilën bëjmë fjalë». <sup>1)</sup> Fan S. Noli u kthye nga Gjeneva në Shqipëri më 14 tetor. Në periudhën prej gjashtë muajsh që qëndroi në krye të qeverisë demokratike, dy muaj pra i kaloi i ashtë atdheut. larg zhvillimit të ngjarjeve të brendshme. Përballë rritjes së reaksionit, demokratët radikalë, ndër të cilët edhe vetë Noli, treguan ngathtësi dhe butësi. Klika ushtarake u vu kundër Nolit dhe elementëve të tjerë demokratë. Bloku qeveritar u përça. Qëndrimi i ngathtë, i pavendosur dhe i lëkund-

shëm i udhëheqësve të revolucionit, pra edhe i vetë Nolit, bëri që masat e gjera të popullit të shkëputeshin prej tyre.

Në një vjersha, që do të shkruaj për këto rrethana historike, ai do të kritikojë veten për mospërdorimin e dhunës revolucionare ndaj dhunës kundër-revolucionare. Dobësia e Nolit dhe e shokëve të tij ndaj reaksionit çifligar ishte shprehje e dobësisë së borgjezisë, e cila kishte frikë nga revolucioni popullor. Por, ndërsa në politikën e brendshme qeveria demokratike po largohej gjithnjë e më shumë nga realizimi i programit të premtuar, në politikën e jashtme mbajti një qëndrim të ngulët antiimperialist.

Ndërkohë, reaksioni i jashtëm, në bashkëveprim me reaksionin e brendshëm, filloi ndërhyrjen e armatosur, Beogradi dhe Roma u morën vesh. Kundër-revolucionari A. Zogu nga Jugosllavia me ushtarë të rregullt, rezervistë, mercenarë, bashibozukë dhe bjellogardistë rusë, me mjete financiare të dhëna nga bankat anglo-amerikane, sidhe forcat e tjera zogiste nga Greqia, sulmuan Shqipërinë. Populli organizoi protesta energjike. Qeveria e Fan S. Nolit kërkoi nga qeveritë angleze, franceze dhe italiane, sidhe nga Lidhja e Kombeve, që të ndërhynin pranë qeverisë jugosllave t'i jipte fund agresionit të filluar më 10 dhjetor me reparte të veçanta. Por fuqitë imperialiste, që e kishin organizuar vetë agresionin, nuk u përgjigjën. Klika ushtarake brenda vendit i hapi rrugën kundër-revolucionit dhe sabotoi qëndresën e popullit. Revolucioni demokratik u thye. Fan S. Noli, bashkë me Luigj Gurakuqin dhe bashkëluftëtarë të tjerë, mori rrugën e mërgimit. Trim i tribun Bajram Curri doli maleve, për të vazhduar qëndresën në atdhe.

Fan S. Noli qëndroi në Shqipëri katër vjet e gjysmë. Dhe s'u kthye më. U lind në mërgim dhe në rrugët e vështira të mërgimit do ta ngrysë jetën ai, që ishte zotuar të bëhej «*Kalorës i Skënderbeut në gjirin e popullit shqiptar*». U mund, por nuk u përthye për një kohë të gjatë. Vazhdoi luftën kundër reaksionit dhe për lulëzimin e kulturës demokratike. Pak ditë para largimit të përhershëm nga Shqipëria, në kulmin e ndeshjes me forcat kundërrevolucionare, i dërgoi nga Tirana një kartëvizitë mikut të vjetër, mësuesit Këçon K. Prifti në Rehovë, në të cilën i shkruante me përpikërinë, që e karakterizonte, duke i uruar Vitin e ri: «*Me urime për Motin e Ri. Fan S. Noli mori letrën tuaj dhe do të kujdeset për punën që i shkruani*<sup>11)</sup>.

Pikërisht në kohën, kur drejtonte me aq telashe qeverinë, përfundonte shqipërimin e rubaive të Omar Khajamit, sipas përkthimit inglisht të Fitzgeraldit, dhe me aq aftësi e shije të hollë, sa albanologu austriak i mirënjohur, Norbert Jokli, i çmoi lart, duke shkruar: «*Pas përkthimit të Fitzgeraldit, unë nuk di në ja kalojnë përkthimit të Fan Nolit ato të gjermanishtes dhe të spanjishtes, që janë të dorës së parë*<sup>12)</sup>.

- 
- 1 Tri letrat origjinale gjinden në duar të trashigimtarëve të Ikonom Josifit, në Korçë.
  - 2 USHT, IHGJ: *Historia e Shqipërisë*, v. II, 1965, f. 514.
  - 3 Noli F. S.: «Letër» Këçon K. Priftit, origjinali në dorën e marrësit, në Rehovë.
  - 4 *Ligjëron Fan Noli*, f. 48-50
  - 5 *Ligjëron Fan Noli*, po aty.

- 6 Ligjëron Fan Noli, f. 65.
- 7 Ligjëron Fan Noli, f. 80.
- 8 USHT, IHGJ: *Historia e Shqipërisë*, po aty, f. 543.
- 9 USHT, IHGJ: «*Historia e Shqipërisë*», po aty, f. 550-551.
- 10 Ligjëron Fan Noli, f. 84
- 11 Noli F. S.: «Letër» Këçon K. Priftit, origjinali në dorën e marrësit, në Rehovë.
- 12 Bala V.: Letërsia shqipe e periudhës 1912-1939, f. 53.

## KAPITULLI I GJASHTË

### PËRSËRI NË MËRGIM

**Nëpër Evropë. Poeti dhe shqipëruesi.**

«Sheh gazn' e pritme për djalërinë  
Dhe shkretëtirën për pleqërinë,  
Atje sa bukur, këtu sa zi...»

Periudha, që pasoi thyerjen e Revolucionit demokratiko-borgjez të qershorit dhe vendosjen sërish në fuqi të regjimit çifligaro-borgjez, karakterizohet nga fuqizimi i mëtejshëm i reaksionit, nga shtypja dhe shfrytëzimi i egër i masave popullore, nga shitja e interesave të popullit dhe atdheut fuqive të huaja imperialiste, veçanërisht fashizmit italian, por edhe nga qëndresa e masave popullore ndaj regjimit në fjalë. «Me gjithë masat që mori për të përqëndruar pushtetin në duart e veta, qeveria e Zogut nuk arriti ta zotëronte gjendjen. Masat popullore, siç i raportojnë vetë prefektët ministrisë së brëndshme dhe pre-

sidentit të republikës, e shikonin me armiqësi regjimin e ri, vazhdonin gjithnjë të kishin simpati për Revolucionin e qershorit, për personin e F. Nolit dhe për organizatën «Bashkimi»<sup>1)</sup>. Qëndresa arriti deri aty sa, më 16 nëntor 1925, të shpërthejë në Përmet një demonstratë, në të cilën pjesëmarrësit brohoritnin për regjimin demokratik, për organizatën «Bashkimi» dhe për F. S. Nolin.

Si u largua nga Shqipëria, F.S. Noli u hodh në Itali dhe, që andej, në Austri, ku u vendos grupi kryesor i mërgimit politik shqiptar pas kundërrevolucionit. Ai u ngul, përkohësisht, në Mauern, afër Vjenës. Regjimi zogist e dënoi me vdekje në mungesë. Demokratët revolucionarë, me të cilët u bashkua F.S. Noli, i dërguan një letër qeverisë sovjetike, me të cilën i kërkuan përkrahjen politike dhe morale në luftën kundër regjimit reaksionar, obskurantist. Ata u lidhën me Federatën Komuniste Ballkanike. Të ndihmuar nga kjo federatë, ata organizuan në Vjenë, më 25 mars 1925, një konferencë, nga e cila u themelua Komiteti Nacional Revolucionar ose, siç u quajt shkurtimisht, «Konare». Noli u zgjodh kryetar. Programi i «Konare-s», i shpallur më 5 maj 1925, shtjellohej në katër pika: shpëtimi i Shqipërisë nga regjimi çifligaro-borgjez dhe shtetet e huaja imperia-liste, vendosja e një regjimi republikan, zbatimi i reformës agrare, rivendikimi i kufive etnikë të Shqipërisë. Ky program nuk ndryshonte, në thelb, nga ai i qeverisë së dalë nga Revolucioni i qershorit 1924. Organ i «Konare»-s u bë «Liria Kombëtare», e cila nisi të botohej në Gjenevë, që nga 29 korriku 1925. Noli bashkëpunoi ngushtë në të me vjersha dhe artikuj politikë.

Regjimi zogist, duke ndjekur egërsisht kundër-shtarët politikë, sidomos udhëheqësit dhe aktivistët më të shquar të Revolucionit të qershorit, vrau në Bari, më 2 mars 1925, Luigj Gurakuqin dhe, po atë vit, në një shpellë të Dragobisë, Bajram Currin. Elementë të Zogut dhe renegatë të Revolucionit filluan një fushatë shpifëse kundër demokratëve revolucionarë. Te «Liria Kombëtare», e 9 shtatorit 1925, duke marrë në mbrojtje fytyrën e bashkëluftëtarit të afërt, Luigj Gurakuqit, Noli shkruan: «E gjejmë në radhën e parë gjithnjë, me ca intervale të shkurtëra të shkakëtuara nga forca majore, që më 1909 gjer më 1925. Eshtë një rekord i fituar nëpër ferra, nëpër pusira, nëpër sëmundje, në kënetë kalbësie morale dhe materiale...». Faik Konica e paditi Nolin se kishte qenë një «vegël» e Gurakuqit. Noli i përgjigjet: «Të tjerë mund të lëvdohen që e kapërcëjnë këtë kryetrim vigan nga madhështia e sakrificave. Po unë s'guxonj të matem me atë as sot as nesër, se më duhen dhe dymbëdhjetë vjetë të tjera pune, lufte dhe vojtjesh në Shqipëri që të kem pretencien t'i rri pranë. Z. Faik Konica është i mendjes që kam qenë vegla e Gurakuqit. Nuk e besonj. Po edhe sikur të jetë e vërtetë, e kam e do t'a kem për nder. Ishte mjaft i madh sa të kishte vegla si mua e si të tjerë novicë të luftës në Shqipëri, kupa e hidhur e së cilës ua ngjeth mishrat atyre, që kanë shijuar jetën në pjesat e mira të botës së qytetëruar». Duke u marrë prapë me këtë çështje, në artikullin Gurakuqi, Vinjau dhe unë, botuar te «Shqipëri' e Re» e Konstancës, më 8 nëntor 1925, ai vë në dukje edhe disa mospërputhje me Gurakuqin, por rithekson, më në fund, anën pozitive të fytyrës së tij: Gu-



rakuqin — para së të nisnim bashkëpunimin që në vjeshtë të vitit 1922 — mund t'a kem kritikuar në ca pika, më vonë mund të kemi qenë në kundrështim për disa hollësira, por e kam konsideruar gjithnjë si një nacionalist të grupit konstruktiv. Sa më mirë e kam njohur, aq më tepër kam qenë i shtrënguar ta respektonj. Veteran i çështjes, po thua tridhjetë vjet në shesh të nderit pa prerë, ka vënë në shërbim të atdheut tërë forcën dhe tërë jetën e tij».

Viti 1926 karakterizohet nga vazhdimi i veprimtarisë së tij të dendur politike kundër regjimit çifligaro-borgjez dhe në mbrojtje të lëvizjes demokratike revolucionare. Fill pas nënshkrimit të traktatit skllavërues të Tiranës, midis Italisë fashiste dhe qeverisë zogiste, Noli i drejtoi një protestë Lidhjes së Kombeve kundër këtij traktati, duke i kërkuar që të merrte masa ndaj ndërhyrjes italiane në Shqipëri. Gjatë këtij viti e shohim të lëvizë nga Vjena në Berlin. Është koha kur ai boton shqipërimet e veprave të njohura të dramaturgjisë botërore: tragjeditë: *Hamlet*, *Makbeth* dhe *Jul Qezari* të Uiljam Shekspirit, dramat *Armiku i popullit* dhe *Zonja Ingra e Ostrotit* të Henrik Ibsenit, të prira nga «introdukta» (hyrje), të cilat dëshmuuan për një punë këmbëngulëse, jo vetëm në fushën e shqipërimit, por edhe në atë të mendimit kritik letrar. Gjithë i këtij viti është edhe edicioni i dytë i përkthimit të romanit *Kasollja* të V.B. Ibanjezit. Autori realist spanjoll e kishte filluar këtë vepër më 1895 si tregim me titull *Hakmarrja mauritane*, por, më vonë, e përpunoi në shtrirjen e romanit. Noli e ribotoi shqip një vit pasi Ibanjezi i bëri vep-

rës shënimin e njohur në Montona (alpet bregdetare). U shfaq, kështu, edhe një herë mjeshtria e Nolit si shqipëruet i dorës së parë dhe si lavruet i mendimit kritik letrar me prirje përparimtare.

Ai përpigjet të zbulojë botën e brendshme të ndërlikuar të Hamletit në «Introduktën» e shkurtit 1926, shkruar në Berlin. Po në Berlin, në gusht të këtij moti, shënon për Makbethin: «*Asnjë vepër tjetër teatrale nuk përmbledh në një vënt aq të ngushtë një gjëmë aq të madhe prej ngjarjesh tronditëse dhe ngjethëse sa «Makbethi», tragjedia më e tmerruar, që ka dalë nga penda demoniake e Shakespeare-it*». Mendimi i tij shfaqet më i përparuar në hyrjen që i bëri shqipërimin të *Armikut të popullit*. Shihet, këtu, ndikimi që ka Noli nga idetë socialiste, ndonëse këto fjalë hyrëse janë vënë në ballë të një drame socialiste utopike, në të cilën nuk shtrohet drejt çështja. Ja me ç'forcë denoncon Noli rendin kapitalist: «*Theatri i përbotshëm, i vjetër a modern, s'ka një dramë tjetër, e cila të tallet aq bukur e aq thellë sa kjo (drama «Armiku i popullit») me idealet borgjeze, faqe me nder demokratike. Liria e fjalës? Po kjo nuk ekziston, posa u ngjitet interesi kapitalistëve... Parlamentet? Po këto s'janë veç komedira, ku bisedohen vetëm gjërat, që u japin dorë kapitalistëve dhe për të tjerët s'bëhet fjalë fare, se nuk jep leje shumica e dishiplinuar. Feja dhe shkollat? Po dhe këto përdoren si vegla për të shtrëmbëruar dhe për të robëruar mendjen e popullit në favor të kapitalistëve. Opinioni publik? Po këtë e kthejnë kapitalistët si mulli të erës nga të duan me anën e gazetareve të blerë». Fan S. Noli arrin të bëjë thirrje për përmbysjen e rendit kapitalist dhe ngritjen e një sho-*

qërie të re pa shrytëzim: «Kjo shoqëri duhet përmbysur me gjithësej, se është e pamundur të ndreqet me ato baza që ka. Qysh? Nga njëra anë me luftë në tërë vijën, jo vetëm kundër një pike të sistemit kapitalist borgjez, por kundër tërë sistemit, kundër të gjitha institucioneve, që e përbëjnë, qofshin shtetërore, fetare, ekonomike, e sociale, nga njëra anë me edukatë, duke rritur një brez të ri proletarësh bujarë dhe të lirë, të cilët të formojnë bazën e shoqërisë së re, që do të lindë mbi gërmadhat e së vjetrës».

Në vazhdim të punës për shqipërimin e veprave të njohura të letërsisë botërore, Noli, sipas dëshmisë së albanologut Norbert Jokl, u muar në Mauern me përgatitjen e shqipërimit të «Faustit» të V. Gëtes dhe, për këtë çështje, studjoi disa nga komentaret e veprës.

Ndërkohë, shkroi dhe botoi tri nga vjershat më të goditura politike, që e afirmuan si poet të dorës së parë në krijimin e vjershërisë qytetare demokratike: *Syrgjyn — Vdekur* (Elegji për Luigj Gurakuqin), *Shpell' e Dragobisë* (Elegji për Bajram Currin), shkruar më 28 tetor, dhe *Hymni i Flamurit*, shkruar më 14 nëntor, që të tria botuar te «Liria Kombëtare» e Gjenevës, në numrin e 28 nëntorit 1926. Në elegjinë kushtuar Gurakuqit, poeti shpreh dhimbjen për humbjen e burrit demokrat dhe thekson virtytet e tij. Vjersha nis me nota, që shprehin pikëllimin, duke ju drejtuar nënës Shqipëri. Përmes antitezash fort të qëlluara, poeti flet për meritën e madhe të burrit ndaj atdheut:

«Se të deshte dhe s'të deshnin,  
 Se të qante kur të qeshnin,  
 Se të veshte kur të çveshnin,  
 Nëno moj të ra dëshmor.»

Portreti i gjallë, i dhënë në fillim me nota lirike përvajtimi, nga fundi merr thekse epike. Burri s'është vetëm biri, që e do nënën Shqipëri me një dashuri të thellë, por edhe «vigani liberator», që, bashkë me «shpirtin e bardhë» dhe «gojën e ëmbël», ka edhe një «zemër hekur». Portreti moral, në njëzet vargje, forcon dëshminë që na jep historia për demokartin e qëndrueshëm në idealin patriotik. Ndjehet, në këtë elegji, fryma e vargjeve popullore të vajtimit dhe të sulmit njëherësh, në tetërrokësha të derdhur me kaq rrjedhshmëri, si të vjersha *Jepni për Nënë!* Tjetër karakterizim, në përshtatje me vetinë kryesore të heroit, ka marrë fytyra e Bajram Currit, i cili, në elegjinë përkatëse, është përvijuar me përpjesëtimet e një trimi legjendar, gjithnjë në përfytyrime popullore: «Bajrak i gjallë», «Rrufe-shkabë», «dif», «dragua», «tribun i vegjëlisë». Autori e quajti vjershën elegji, por kjo ka të gjitha të dhënat e një kushtrimi për luftë dhe është e mbushur me duf revolte. Fatosi i paepur, që doli maleve, për të vazhduar luftën demokratike revolucionare kundër regjimit çifligaro-bogjez, paraqitet nga poeti si një Anté i pavdekshëm:

«Thon' u shtri e thon' u vra, --  
 Por ti s'vdiqe, or Baba,  
 As te Shkëmb'i Dragobisë,  
 As te zemr'e djalërisë.



Fan S. Noli

*As je vrar'e as po vritesh  
Legjendar Ante po rritesh, —  
Dithiramb i Dragobisë,  
Tmërr, panik i mizorisë.»*

Epitetet që i jep heroit e afrojnë këtë me fatosat legjendarë të krijimtarisë popullore dhe, ndonjëherë, me ata të lashtësisë. Megjithatë, fatosi Bajram Curri nuk duket i shkëputur nga rrethanat historike në të cilat veprimi. Në vjershë theksohet se luftëtari shprehu aspiratat e shtresave të gjera të vegjëlisë për çlirimin politik dhe shoqëror («trim tribun i vegjëlisë»). Autori bëri këtë shënim të ngjeshur për lexuesit: «*Dragobia është një katund i Krasniqes në malësi të Gjakovës. Në një shpellë të këtij katundi u rrethua Bajram Curri prej larove të Ahmet Zogut dhe u vra duke u përpjekur të çajë udhë me armë në dorë».*

Me një intonim të tillë epik është paraqitur Flamuri ynë, i cili ka një histori, që simbolizon qëndresën heroike të popullit, lashtësinë dhe virtytet burrërore ndër shekuj kundër armiqtve të egër. Në pajtim me madhësinë e idesë, janë thurur edhe mjetet stilistike të shprehjes — solemne, kumbuese, në ritëm marshi luftarak. Pasi rrëfen, në një sintezë të sajuar me mjeshtëri, episodet e ndritshme të historisë kombëtare, poeti e mbyll vjershën hymn me një thirrje drejtuar Flamurit — simbol, në të cilën gjeti pasqyrim besimi në të ardhmen e lumtur të Shqipërisë:

*«Përjetë prie Shqipërinë  
Përlintj'a shpirtin dhe fuqinë*

*Diell për vllan', yrnek për fqinë  
Për botën ëndr'e qjell i ri.»*

Me përjashtim të idealizimit të pavend që i bën fytyrës së perandorit romak Kostandin I, sepse ky ishte me prejardhje ilire, vjershën e çmojmë për vlerat përgjithësuese, sidomos për idenë që Flamuri është «*Flamur i math për Vegjëli*», «*Yll i pavdekur për liri*», që shtrin për dhë «*çdo mizor*» të ngritur kundër Shqipërisë. Si shihet, qoftë me parafytyrën e vegjëlisë, që shfaqet qartë në *Shpell' e Dragobisë* dhe në *Hymni i Flamurit*, qoftë me kritikën ndaj rendit kapitalist, siç del te «introdukta» e *Armikut të popullit*, Noli, në këto vite, ka ecur më tej në mendimin demokratik, i ndikuar nga idetë socialiste.

Në prill 1927, «*Konare-ja*» u kthye në komitet të *Çlirimit Nacional*, me kryetar Fan S. Nolin. Programi demokratik revolucionar i këtij komiteti u zhvillua më tej. Me organin e tij të shtypit u demaskua imperializmi botëror dhe, veçanërisht, politika e Anglisë, e Italisë dhe e qeverive reaksionare të vendeve fqinjë në Ballkan. Më 24 prill 1927, komiteti në fjalë dhe ai i *Çlirimit të Kosovës* shpallën një deklaratë, me të cilën dolën para opinionit publik si organizata revolucionare internacionaliste, duke i dhënë një orientim shumë të përparuar politik dhe ideologjik lëvizjes çlirimtare shqiptare, në vështrimin që lufta për çlirimin e Shqipërisë duhej të koordinohej me luftën e popujve të tjerë të Ballkanit dhe të mbështetej në lëvizjen e klasës punëtore. Në deklaratë, ndër të tjera, thuhej: «*Duhet, pra, t'a koordinojmë lëvizjen t'onë me lëvizjet liberatore të të gjithë popujve ballkanikë të shtypur dhe duhet të mbështete-*

mi mbi të gjithë faktorët ndërkombëtarë të përparuar në të tërë botën. Nuk jemi të vetëm në luftën tonë; është e vërtetë se kemi armiq të mëdhenj, por, për fat të mirë, kemi edhe miq. Organizatat kombëtare liberatore ballkanike, punëtorët e Anglisë, të Italisë dhe të Evropës përgjithësisht, popujt që janë çliruar e që po çlirohen nga imperializmi si edhe partizanët e ideve të përparuara në të tërë botën janë miqtë t'anë, miq të popullit shqiptar dhe të Shqipërisë së lirë. Këta janë aleatët t'anë të natyrshëm dhe të sigurtë në fushatën t'onë liberatore. 2). Kuptohet që këtë pozitë politike dhe ideologjike arriti edhe Noli.

Në nëntor të këtij viti, ai mori pjesë, si anetar i delegacionit, që përfaqësonte popujt e shtypur të Ballkanit, në Kongresin e miqve të Bashkimit Sovjetik, që u mbajt në Moskë, me rastin e dhjetëvjetorit të Revolucionit socialist të Tetorit. «Pravda» e 4 nëntorit 1927 shkroi: «I ardhur në Moskë për të marrë pjesë në festat e Tetorit dhe në Kongresin e miqve të Bashkimit Sovjetik, ish kryeministri i Shqipërisë, Fan Noli, në bisedën e tij me bashkëpunëtorin t'onë, deklaroi: «Jam i mahnitur që pashë me sytë e mi të parin shtet të punëtorëve e fshatarëve, të cilin e pret një e ardhme e madhe dhe i cili është një shembull i të tillave republika të punëtorëve e të fshatarëve të së ardhmes...» 3). Organi i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik sërish më 11 nëntor pohon: «Fan Noli, anëtar i delegacionit të popujve të shtypur të Ballkanit dhe ish-kryeministër i Shqipërisë:»... Delegatët e Kongresit panë me sytë e tyre përparimin që ka bërë shteti i punëtorëve. Manifestimi i paharruar i 7 Nëntorit, me pjesë-



marrjen entuziaste të masave punëtore dhe të ush-  
tërisë së kuqe, na bindën se Bashkimi Sovjetik ësh-  
të në gjendje të mbrohet nga armiqtë e tij. Për këto,  
delegatët do të flasin edhe pasi të kthehen nëpër ven-  
det e tyre»<sup>4</sup>). Po këtë vit, ai botoi një artikull në or-  
ganin e PK franceze, «Humanité», kundër politikës së  
rrezikshme të imperializmit francez dhe të fashizmit  
italian në Ballkan. Ndërkohë, në Shqipëri u nën-  
shkrua «pakti i dytë italo-shqiptar i Tiranës», po  
përhapëj zija e bukës, u shpall monarkia. Shqipëria  
po hynte në periudhën e krizës ekonomike botërore  
të viteve 1929-1933. Në këto rrethana zu të shfaqej  
më me forcë qëndresa popullore kundër regjimit zo-  
gist, nisi të rritet lëvizja punëtore dhe të duken fi-  
llimet e lëvizjes komuniste. Pikërisht në nëntor të  
vitit 1927, Noli shkruan në Vjenë vjershën e fuqi-  
shme për denoncimin e kreut të regjimit çifligaro-  
borgjez, A. Zogut, «*Marshi i Barabajt*», kurse, një  
vit më vonë, më 15 tetor 1928, po në Vjenë, vjershën  
satirike *Kënga e monarkisë* (titulluar më pas *Kënga  
e Salep-Sulltanit*). Në të parën, shfren në mallëki-  
me të tilla, që nuk i njohim gjetiu kundër tiranit.  
Krahas tij, poeti denoncon edhe ata feudalë e bor-  
gjezë reaksionarë, që e zgjodhën për të parë të klikës  
antipopullore kryefeudalin uzurpator. Efekti demas-  
kues arrihet nëpërmjet ngjeshjes së epiteteve për-  
çudnuese dhe shpotitëse, realizuar me aliteracione  
shurdhuese, në vargje trembëdhjetërokohe me rit-  
me jambike, të parat në vjershërinë shqipe. Po me  
këtë zemëratë, por gërshetuar me një frymë të zjarr-  
të satire, ironie dhe sarkazme, stigmatizohet figura  
e diktatorit, që u shpall monark më 1 shtator 1928,  
dhe gjithë ajo klikë, e cila e mbështeti atë. Para nesh

kalojnë, si në një paradë karnavalesh, në tetërrokësha qesënd'sës, përkrahësit e monarkut, me tiparet kryesore, që i dallojnë për lajkat, dredhitë, dhe veprimet e tyre antipopullore. Kreun e tyre, A Zogun, poeti e quan salep-sulltan, kusar e katran.

E kësaj kohe besohet të jetë edhe vjersha e njohur tani vonë *Tallja përpara kryqit*<sup>5)</sup>, me të cilën poeti demaskon ashpër demagogjinë e fesë. Përpara kryqit, në mënyrë figurative, ai sjell persona historikë. Leninin, Kalvinin, etj. dhe persona simbolikë, Militaristin, Fet'shistin, Heretikun, etj. Në gojën e Leninin të fjalët, që denoncojnë fenë si mbështetje të klasave sunduese, si vegël të forcave reaksionare, për të shtypur e shfrytëzuar popujt:

*«Tavarish, tavarish, kryqëzohesh më kot,  
Dhe po shtyp vegjëlinë me gjak e me lot,  
Kryqi yt do të bëhet simbol tiranie,  
Instrument verbërimi, sfrutimi dhe zie.»*

Kështu, me radhë, secili nga personat historikë a simbolikë stigmatizon njërën a tjetrën anë të fesë, të kishës e të klerit, gjatë rrjedhës së shekujve.

Vjersha nuk është në lartësinë e realizimeve më të mira poetike të Nolit, po ka rëndësi të madhe për të parë evolucionin e botëkuptimit të tij filozofik nga fundi i viteve 20. Ky evolucoi përfshin jo vetëm sferën politike dhe shoqërore, po edhe atë morale dhe estetike. Poeti shpreh dyshimet në drejtësinë e fesë së krishterë dhe hedh poshtë pretendimet e saj për t'u hequr si faktor i rëndësishëm në zhvillimin progresiv të njerëzimit. Fetishisti i thotë Krishtit:

«Feja jote me vjet do të bëhet çervish,  
Kryqi yt, Jesu Krisht, do të bëhesh fetish.  
Dhe në koleksion të Muzes Afrikane  
Do të shtohet dhe një hajmali kristiane.»

Më 28 nëntor 1928, Noli shkroi në Hamburg të Gjermanisë vjershën *Anës lumenjve të Babillonës*. Mbi këtë motiv krijoi edhe vepërzën muzikore me titull «Në brigjet e Babillonisë» për kor të përzierë (a capella). Fletorja «Dielli» e 1 gushtit 1943 do të botojë me këtë shënim: «Robo Rogozhina — «Anës lumenjve të Babillonës»... vjershë e shkruar në Gjermani prej një refugjati politik përpara luftës, është frymëzuar nga Psalmi 137, një nga vajtimet më të dhëmpshura të syrgjynit». Psalmi në fjalë, siç e sjell shqip K. Kristoforidhi në *Psaltari të vitit 1872*, f. 117, thotë: «Mbi lumenjtë e Babillonës, aty ndejtëm dhe kjamë, kur kujtuam Sionën. Mbi shelgjet ndë mjedis t'asaj varëm qitharat tona. Se ata, që na skllavëruan, atje kërkuan prej nesh fjalë këngësh: edhe ata, që na hoqën udhën, kërkuan prej nesh këngë gëzimi, duke thënë: «Na këndonin prej këngësh të Siomës. Kush të këndonte këngën e Zotit në dhë të huaj?». Në qoftë se, në fillim, ky psalm mund t'i ketë dhënë poetit pikënisjen për një vjershë me motiv të përgjithshëm për figurën e të mërguarit larg atdheut, më pas poeti e tejkaloi kuadrin e brendisë së psalmit dhe dha një tablo shumë më të gjerë të të mërguarit politik në rrethana të caktuara historike. «Më vonë, kjo vjershë u përfshi në «Album» me titullin e thjeshtësuar «Anës lumenjve». Aty, midis vargjeve të njohur:

10  
fetishiisti.

Kryzji yt me pak vjet do te behet fetish  
Teje jete me vjet do te behet zerrish.  
Kryzji yt, Jesi Krisht, do te behet fetish.  
Dhe ne koleksion te muzgo' afrikane  
do te behet dhe jete kupalet kristiane.

Lan

Tavarish, tavarish, kryzrolsh, me kiel  
dhe po shtep shtepine me tavarish e me  
Kryzji yt do te behet simbol tavarish  
tavarish ~~te tavarishit~~ ~~te tavarishit~~ ~~te tavarishit~~  
Instrument vobrem, ~~te tavarishit~~ ~~te tavarishit~~ ~~te tavarishit~~

Antisemitizmi

Kryzji yt do te behet krenar i antisemitizmit  
do te varam e pa tavarishin ~~te tavarishit~~  
do te shuar nje krenar ~~te tavarishit~~  
do te behet krenar, te varam, e shuar



...theorinë e ...  
...jeu ispat në këtë ...  
...the sevoj ... s'ke ...  
...M. C. Eubit ...  
...le në këtë u-munduar ...  
...israeli ...  
...Joni ... me një ...  
...Dromio ...  
...lë ...  
...lë ...  
...Kavoni ...  
...Shtetit ...  
...Se' me ...  
...Kë ...

«Tallja para kryqit», dorëshkrim i poetit, ruajtur në Arkivin e Shtetit në Tiranë



«Ngrehuni dhe bjeruni  
Korrini dhe shtypini  
Katundar' e punëtorë  
Që nga Shkodra gjer në Vlorë!»

dora e Nolit ka hequr një vizë dhe e ka ndrequr vargun e fundit me këtë shënim: «Origjinalisht që nga Moska gjer në Vlorë!»<sup>6)</sup> Kuptohet që, në botimin e kësaj kryevepre, të *Album*, me shënimin «Hamburg, maj 1930», kemi të bëjmë me variantin e fundit në janar të vitit 1930, ai përfundon vjershën autobiografike *Moisiu në mal*, që e boton të «Liria Kombëtare» e 27 janarit. Ai kishte mbushur moshën 48-vjeçare dhe, me sa duket, vjershën e shkroi me këtë rast, për të rrëfyer se si jeta po i kalonte në mërgim të hidhtë, në arrati, i përplasur dhe i përpëlisur, i ushqyer me shpresë dyzet vjet me radhë:

«Sheh gasn' e pritmë për djalërinë  
Dhe shkretëtirën për pleqërinë,  
Atje sa bukur, këtu sa zi. . .»

Kuptohet, sipas autorit, se rinia do ta gëzojë një ditë pranverën, atdheun e lirë, kurse pleqëria, d.m.th. vetë poeti, do të ngelet jashtë, në dimër, në dhé të huaj. Dëshpërim për veten, optimizëm për brezin e ri të së ardhmes — kjo antitezë përbën thelbin e kësaj vjershe alegorike, e cila, për nga karakteri politik konkret, nuk ka të bëjë me *Moisiun* e Alfred të Vinji-së, poemës filozofike romantike, me të cilën deshi ndokush ta përqaste. Që nga kjo vjershë zë fill ai varg vjershash të Nolit, që, nga më se një anë, përbëjnë një farë autoportreti artistik



dhe një farë autobiografie në planin historik, lidhur me rolin e tij në Revolucionin demokratik të qershorit 1924 (*Marshi i Krishtit, Krishti me kamçikun, Marshi i kryqësimit*). Një muaj më vonë, më 21 shkurt, poeti boton vjershën *Shën Pjetri në mangall*, satirë e mprehtë politike, me të cilën tall dhe padit ashpër të gjithë ata, që ishin betuar dhe zotuar për Revolucionin demokratik, por që, me ardhjen në fuqi të kundërrevolucionit, mohuan vetëveten, u tërhoqën dhe tradhëtuan. Dikur u shitën «*shkab' e shkëmb me poz'e fjalë*», pastaj dolën se s'ishin veçse «*shkrumb e galë*». Të gjithë këta, poeti i trupëzon në figurën e përrallës biblike, që «*kuspull mi mangallin mblidhet*», mohon revolucionin dhe bashkëluf-tëtarët, bindjet dhe idealet e mëparshme. Për ta, kryesore, sipas poetit, është shpëtimi i lëkurës:

*«S'ka e s'ka si heroizma  
Edhe si idealizma,  
Por kur dimër del behari  
S'ka si zjarri.»*

Të njëjtën temë trajton poeti edhe në vjershën *Kirenari*, figura e të cilit përfaqëson atë kategori njerëzish që, në luftën midis revolucionit dhe kundër-revolucionit, nuk mbajnë as njërin as tjetrin anë. Kur e sheh, se e drejta është me revolucionin, kalon në anën e revolucionit, por nuk ja del të përballojë rrugën e terrorisë. Me ndeshjen midis revolucionit dhe kundërrevolucionit merren edhe vjershat «*marshes*». Te *Marshi i Krishtit* poeti ngre një autoportret, duke e përshkruar veten si shpëtimtar që ma-

sat e hymnizojnë, sepse u jep «*pasuri, liri, fuqi*», sepse i «*ruan, i mpron dhe për ta bëhet fli*», etj. Vjersha merr karakterin e një odeje panegjyrike, që adhuresit i thurin «*çlironjësit*», me shprehje që arrijnë deri në ekstaz. Duke vënë në këtë mënyrë ballpërballë masat dhe heroin, Noli shpreh një mbivlerësim të heroit (të rolit të vetëvetes në rrjedhën e ngjarjeve) dhe një nënvlerësim të masave, që paraqiten si turma adhuresë, të shastisura në hare, përshkruar në vargje kumbuese, që krijojnë efekte të rënda akustike. Këtë frymë ka edhe vjersha *Kryqësimi*. Por ndryshe trajtohet figura e vetëvetes në vjershën *Krishti me kamçikun*, e cila i tejkalon kufitë e një autoportreti dhe shtron probleme më të mëdha politiko-shoqërore të kohës. Ajo hapet me një kuadër, që paraqit, në mënyrë realiste, kaosin, arbitraritetin, ligjëshkeljen, mashtrimin, shpërdorimin, etj., që vëreheshin në jetën shtetërore, para Revolucionit të qershorit, kur sundonin «*sarafët pa shpirt e pa besë*», «*parasitët gjakpirës*», ndërsa vëgjëlia për ta «*batërdisen dhe vriten*». Në pjesën e dytë të vjershës, poeti tregon se si atdhetarët demokratë nuk e duruan më këtë tragjedi kombëtare dhe morën pjesë vepruese në revolucion, në krye të të cilit qëndroi ai vetë. Demokratët radikalë, që mendonin se edhe pas ngadhënjimit të revolucionit duhej të ndiqej me vendosmëri rruga e nisur dhe të përdorej dhuna revolucionare ndaj dhunës kundërrevolucionare, i thanë:

Ja tani e ke nisur tamam, or usta!

Por Noli, thotë poeti për veten si udhëheqës, nuk e pranoi këtë mendim dhe e hodhi kamxhikun, duke besuar se vetëm me anë të edukatës dhe kultu-

rës do të rrënjosej liria dhe do të mbahej pushteti, që doli nga revolucioni. Demokratët radikalë e këshilluan që ta merrte prapë kamxhikun në dorë, ta çrrënjoste me të vërtetë feudalizmin, por Noli nuk dëgjoi. Atëherë e «*kapnë kamçikun sarafët*» dhe e përmbysën revolucionin. Poeti nxjerr këtë përfundim të rëndësishëm politik dhe ideologjik: në qoftë se nuk përdoret dhuna revolucionare, do të fitojë dhuna kundërrevolucionare, prandaj duhet vazhduar revolucionin deri në fund. Poeti dënon këtu edhe vetëveten, se nuk përdori kaxhikun kundër larove gjakpirës. Vjersha tingëllon si një autokritikë për butësinë e treguar ndaj kundërshtarëve, të cilët e shfrytëzuan këtë butësi të tij, që ishte, në një planë më të gjerë, shprehje e dobësisë së borgjezisë. Kjo, duke pasë frikë nga revolucioni popullor, nuk u mbështet te masat e popullit, që kërkuan zbatimin e programit demokratik të qeverisë së qershorit. Lidhur me këtë kontradiktë, vlen të sillet këtu rrëfimi që bëri Noli për gjendjen e krijuar në gjirin e udhëheqjes së pushtetit: «*Unë ngjalla zemrimin e aristokracisë së tokës; duke mos mundur t'i nxjerr jashtë ata, unë humba mbështetjen e masave fshatare. Kolegët e qeverisë, si dhe pjesa më e madhe e oficerëve t'ushtrisë, ose ishin armiq ose, në rastin më të mirë, ishin indiferentë ndaj këtyre reformave, megjithëse ishin deklaruar në favor të tyre më parë. Zoti Sotir Peci, regjenti, i kundërshtoi ato me forcë dhe haptazi. Zoti Eyres munda t'i bindi të gjithë rotull meje se reformat agrare ishin një novacion i rrezikshëm bolshevik*»<sup>7</sup>. Në vjershën *Marshi i kryqësimit*, poeti ndërton përsëri autoportretin pas thyerjes së revolucionit. Ai e paraqit ve-

ten si njeri, që «e do vegjëlin'e tiran'e urren». Por edhe këtu vazhdon kontradikta në qëndrimin e tij, se, nganjëherë, «s'do ... as gjakun t'a marrë» dhe se «kujton që pa armë» ka për të zgjuar masat. Vetë alegoria biblike në këto vjersha e ka kufizuar poetin të shprehë më qartë dhe drejtpërdrejt pikëpamjet politiko-shoqërore.

Në një shkallë më të lartë se të gjitha këto vjersha qëndrojnë *Rent, or Marathonomak!* dhe *Anës lumenjve*, që të dyja përfunduar më 1930, e para më 30 prill dhe e dyta, siç e thamë më sipër, në maj, në Hamburg të Gjermanisë. Në këto dy vjersha, mendimi demokratik i Nolit ka arritur më lart se kudo gjatë. Te e para, te Marathonomaku, ai mishëron figurën e luftëtarit për çlirimin e popullit nga shtypja dhe shfrytëzimi çifligaro-borgjez, figurën e lajmëtarit të fitores së popullit. Kaluan më se pesë vjet nga thyerja e revolucionit demokratik. Poeti beson se populli përsëri do të ngrihet në këmbë për të përmbysur tiraninë zogiste dhe të marrë lajmin e gëzueshëm të fitores nga marathonomaku i ri. Ai, bile, e nxit këtë sa më parë me vargjet:

«*Rent, or Marathonomak!*

.....  
*Kuqo, Marathonomak!*»

sepse populli e pret me padurim. Kjo fitore do të jetë ajo e vegjëlisë mbi «*viganët*», që e shtypin, e të shtypurve mbi tiranët, fitore e arritur nga masat e bashkuara së toku:

*«Rent kudo, duke bërtitur,  
Nëpër shekuj faqe-ndritur  
Se i vogli shtrin viganin  
Dhe i shtypuri tiranin  
Veç e tok,  
Tok, or Marathonomak!»*

Duket sheshit se Noli e kishte varur shpresën në këtë kohë të revolucionit të masave të shtypura punëtorë e fshatare, të marathonomakët e kuq. Ky mendim del edhe më qartë në *Anës lumenjve*. Vizatar me mjeshtri poetike, marathonomaku shqiptar del si njeriu që të gjitha energjitë, mendjen dhe zemrën ja ka kushtuar fitores së revolucionit. As etja, që e zhurit, as lodhja kapitëse nuk e ndalin që të rëndë e të lajmërojë sihariqin e fitores. Ai vazhdon vrapimin, duke kaluar të gjitha pengesat dhe ëndjet vetjake, që e joshin, brohorit «*E fituam!*» dhe, pastaj, bie i vdekur për dhë.

*Anës lumenjve*, e cila mbyll me sukses, në fillim të viteve 30-të, ciklin e vjershave politike të autorit, shënon njëherë edhe kulmin e krijimtarisë së tij poetike. Në këtë vjershë trajtohen disa tema. E para është ajo e gjendjes së mjeruar të vendit nën thundrën e klikës zogiste. Poeti, zemërplasur, flet për të këqiat, që e kanë goditur popullin, për varfërinë dhe padijen e madhe, në të cilat ishte kredhur vendi, kujton me hidhërim zgjedhën e egër të «*derberëve*», «*mercenarëve*», bejlerëve dhe fajdexhinjve, që e bënë atdheun çiflig të tyre. Atmosfera e rëndë, në të cilën jetonte vegjëlja, jepet këtu përmes antitezash të një force të veçantë stigmatizuese. Kjo pamje

është vërtetë tronditëse, është diçka që të kall në shpirt urrejtje dhe revoltë:

*«Ku e lam'e ku na mbeti  
Vaj — vatani e mjer' — mileti  
Anës detit i pa larë,  
Anës dritës i paparë,  
Pranë sofrës i paqrrënë,  
Pranë dijes i paqrrënë,  
Lakuriq dhe i dregosur,  
Trup e shpirt i sakatosur.»*

Gjendja tragjike e popullit nën pushtetin e klasave reaksionare e zhyt poetin në dëshpërim. Larg atdheut, në mërgim të gjatë e të hidhur, herë anës Spresë në Berlin, herë anës Elbës në Hamburg, herë anës Rinit në Këln, herë anës Tunës në Vjenë, duke bërë një jetë plot mungesa dhe me kokë në torbë për t'u shpëtuar përndjekjeve të regjimit zogist, që e kishte dënuar me vdekje në mungesë, ai ndiek me ankth ngjarjet, pret me padurim shenjën e parë të kryengritjes çlirimtare, që do t'i jipte fund sundimit të urryer çifligaro-borgjez. Kështu merr jetë tema e dytë — ajo e shqetësimit për fatin e popullit:

*«Çirem, digjem i vrerosur,  
Sakatosur, çarmatosur,  
As i gjall' as i varrosur,  
Pres një shenj'e pres një dritë,  
Pres me vjet' e pres me ditë,  
Seç'u tera, seç'u mpaka,  
Seç'u çora, seç'u mplaka,  
Lark prej vatrës dhe prej punës,*

Anës Rinit, anës Tunës.  
Çakërdisur, batërdisur,  
Përpëlitur dhe zalisur,  
Ëndërronj pa fund, pa shpresë,  
Anës Elbës, anës Spree-së.»

Por shpresa i ngjallet përsëri. Që larg, nga atdheu, i vjen buçima se populli po gatitet për betejën çlirimtare. Kjo është tema e tretë, në të cilën gjen shprehje thirrja për kryengritje të fshatarëve dhe punëtorëve. Lajmi se po pëlçet dhe kërcet furtuna ja përtërit shpirtin poetit, ja heq dëshpërimin dhe e mbush me besim e forca të reja. Me bindjen për fitore, sepse lëvizja demokratike antizogiste dhe antiimperialiste po forcohej në Shqipëri, poeti u bën thirrje katundarëve dhe punëtorëve që të hidhen në sulm kundër armiqve:

«Dhe një zë vëngon nga lumi,  
Më buçet, më zgjon nga gjumi,  
Se mileti po gatitet,  
Se tirani lebetitet,  
Se pëlçet, kërcet furtuna,  
Fryhet Vjosa, derdhet Buna,  
Skuqet Semani dhe Drini,  
Dridhet beu dhe zengjini,  
Se pas vdekjes ndriti jeta  
Dhe kudo gjëmon trumbeta:  
Ngruhuni dhe bjeruni,  
Korrini dhe shtypini,  
Katundar'e punëtorë  
Që nga Shkodra gjer në Vlorë!»

I frymëzuar nga lëvizja demokratike antizogiste dhe antiimperialiste e vendit dhe nga idetë socialiste, duke milituar në gjirin e Komiteti të Çlirimit Nacional, F. S. Noli arriti në këto vite të përcaktonte më qartë vegjëlinë në kuptimin e katundarëve dhe punëtorëve, ta mbështeste shpresën e çlirimit politik, ekonomik dhe shoqëror në kryengritjen e tyre të armatosur, por, në kushtet konkrete historike, nuk arriti të tregojë se cila forcë shoqërore do ta udhëhiqte dhe ç'pushtet do të sillte ajo kryengritje me karakter të gjerë popullor. Kjo, natyrisht edhe për rrethana objektive, edhe për rrethana subjektive, kur mungonte partia politike pararojë e klasës punëtore.

*Anës lumenjve* është thurur në trajtën e një monologu me karakter agjitativ të hapur politik. Ideja e lumenjve, që rrjedhin, fryhen dhe skuqen, shpreh idenë e kryengritjes, që përftohet për të zhdukur dimrin e robërisë dhe për të sjellur pranverën e lirisë, «*vatrën dhe punën*». Në konceptimin kompozicional vjersha i pëngjan një simfonie me kohët përkatëse, duke pasë në mbyllje një akord triumfues. Në vargjet e kësaj vjershe, ku spikasin antitezat, simbolet, aliteracionet dhe simetria, ngrihet figura e heroit lirik, që përputhet me figurën e vetë poetit, më atë të atdhetarit demokrat të mërguar, që mallëkon dhe denoncon me forcë të madhe armiqtë, brohorit me «*bes'e shpresë*» për fitoren e popullit. Nështypjes shpirtërore ja zë vendin hovi i brendshëm, vërshimi i ndjenjave për ngazëllimin e së ardhmes. Atmosferën e mbushur me shqetësimin për fatin e vendit, parandjenjën dhe paralajmërimin për kryengritjen popullore, i përcjell në mënyrë shprehëse tetë-



rrokëshi trokaik, që i jep vjershës vrull dhe kumbim rrëmbyes.

I njohur tanimë edhe jashtë atdheut si shkrimtar përparimtar, Fan S. Noli mori pjesë në Kongresin Ndërkombëtar Antifashist, që u mbajt në Berlin, më 1929. Në presidiumin e Kongresit, ai qëndroi përkrah shkrimtarit revolucionar francez Hanri Barbys.

- 
- 1 USHT, IHGJ: *Historia e Shqipërisë*, vëllim i dytë, Tiranë, 1965, f. 569.
  - 2 USHT, IHGJ: *Historia e Shqipërisë*, vëllim i dytë, Tiranë, 1965 f. 577
  - 3 «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 38
  - 4 «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 39
  - 5 Bihiku Koço: *Një poezi e panjohur e Fan Nolit*, «Mësuesi», 30 qershor 1971, f. 3. Për tekstin e plotë shih: «Studime filologjike, Nr. 1, 1971.
  - 6 Kuteli M.: *I falem kujtimit të Fan Nolit*, «Drita», 21 mars 1965 faqe 3.
  - 7 USHT, IHGJ: *Historia e Shqipërisë*, vëllim i dytë, Tiranë, 1965, f. 554; *Lëvizja demokratike revolucionare e qershorit 1924, në Shqipëri*, «Buletini i shken-cave shoqërore», Nr. 4, 1954.



«Fan S. Noli (i dyti nga e majta) përkrah Hanri Barbysit  
(i treti nga e majta) në presidumin e Kongresit  
Ndërkombëtar, që u mbajt në Berlin më 1929».



## *Kapitulli i shtatë*

### **PËRSËRI NË BOSTON**

#### **Kompozitori. Muzikologu. Historiani**

Nga gjysma e dytë e vitit 1930, Fan S. Noli largohet nga Berlina dhe kthehet në SHBA, ku qëndron gjatë muaj. Fillon botimin e një fletoreje të përjavshme me titull «Republika,» kundër regjimit reaksionar të vendosur në Shqipëri. «Dielli» i 6 qershorit të këtij viti shkruan se përkrahësit e Nolit «... kanë nisur të thërresin nëpër kafene se shpëtimi i botës do të vijë nga Rusia». Kurse më 26 dhjetor: «Kryerevolucionari Fan Noli që kur ardhi në Amerikë, me shkrim e me fjalë, ka atakuar pa mëshirë bejlerët e Shqipërisë. Subjekti i çdo predikimi është ky: dëmet që i sjellin Shqipërisë bejlerët. Sipas Nolit, bejlerët janë të dëmshëm për Shqipërinë». Është koha kur Noli boton në rubrikën «Andej-Këtej» të fletores «Republika» një radhë artikujsh të mprehtë politikë nga pozita të avancuara antizogiste dhe antiimperialiste. Më 17 nëntor ai shkruan:

«Jemi për popullin punëtor e kundër parasitëve feudalë. Jemi për shqiptarët kundër bejlerëve të turqësuar dhe kundër arkondëve të grekësuar. Arësytet për të cilat jemi kundër bejlerëve, agallarëve dhe arkondëve i kemi thënë, po s'prish punë sikur t'i nëmërojmë prapë. . . E para arësye është se jemi harbutë vetë, domethënë nga vegjësia punëtore, e jo nga oxhakët e grerave e nukë duam të punojmë ne dhe bejlerët të rrojnë mbi kurrizin t'onë. E dyta, arësye është se ua kemi parë hairin oxhakëve die. E treta, se po ua shohim hairin sot. E katërta, se shpëtimi mund të vinjë vetëm nga vegjësia, nga opinga, nga harbutët». Dy muaj më vonë, po në atë rubrikë, ai vazhdon: «. . . Mbreti i vërtetë i Shqipërisë sot është ai që mbretëron edhe në Itali, është Musolini ose, më mirë, fashizma italiane. Kur të çporret Mussolini me fashizmin a, kur të çporren që të dy me gjithë kuçedrat që i kanë lindur, ahëre do të ndryshohet me rrënjë. Se vetëm ahëre do të ketë rasien populli shqiptar t'a marrë fuqinë vetë në dorë e t'a caktonjë fatin e tij ashtu si ia do e mira». Qëndrimi i tij anti-feudal vërehet edhe pas vitit 1931, atëhere kur botoi shqipërimin e veprës *Don Kishoti i Mançes* të Miguel de Servantesit, kushtuar për kujtim Thanas Tashkos dhe Jani Vruhos, që e kishin ndihmuar në rini. Në «introduktën» e kësaj vepre, Noli shkruan: «Në Shqipëri kjo vepër do të kuptohet më mirë se kudo gjatë. Se atje tipet e bejlurçinës dhe të laros i gjejmë në çdo çap. . . Këto dy elemente përpiqen tani të përjetësojnë në Shqipëri një gjendje feudale, medievale, prapanike dhe reaksionare, si atë të Turqisë së vjetër, të vdekur për gjithënjë, se ashtu ua do interesi i kllasit, se ashtu gjejnë punë dhe bukë.

*Bejlerçinat e larot e Shqipërisë na bëjnë të qeshim e të qajmë me prapavajtjen e tyre, tamam si Don Kishoti me Sançon».*

Më 1932, F. S. Noli vendoset përfundimisht në SHBA, duke u larguar nga bashkëluftëtarët e Komitetit të Çlirimit Nacional të Vjenës, nga beteja politike. Ishte koha e krizës së madhe ekonomike, që paralizoi ekonominë kapitaliste të SHBA-së dhe të shumë vendeve të tjera. Miliona njerëz ishin flakur rrugëve pa punë, pa bukë, pa strehë. Zia e bukës pllakosi edhe mbi Shqipëri. Reaksioni çifligaro-borgjez po përpiquej me thonj e me dhëmbë të forconte më tej pozitat e veta të tronditura nga themelet. Në këto kushte të krizës së madhe ekonomike, pësuan një rrënim të theksuar jetese edhe shumë të mërguar shqiptarë. Noli u kthye në SHBA i lodhur, i dobësuar, pa mbështetje. Nga të njohurit e tij të vjetër, F. Konica i ishte bërë krah monarkut Zog qysh më 1926. «Dielli» dhe «Vatra» ishin kthyer në organe kundër Nolit. Në Shqipëri u acarua terrori ndaj kundërshtarëve brenda dhe jashtë. Më 1933, Noli u sëmur rëndë nga një plevit. I lëkundur dhe i pavendosur, duke shkarë nga vija konsekuente dhe duke rënë në oportunizëm, ai s'e përmbajti dot veten dhe pranoi një «pension» nga ana e monarkut Zog, i cili shtatë vite më parë e kishte dënuar me vdekje në mungesë dhe tani gjeti rastin ta përthyente kundërshtarin e vet. Por, që nga kjo kohë, Noli nisi një jetë të mjerueshme. Për më se 30 vjet banoi në një apartament të vjetër, të pajisur varfërisht, duke e nxjerrë jetesën me «punët e mërziçme të priftërisë» (pagëzime, martesë, varrime, organizim koresh kishëtare etj.) si peshkop i kishës ortodokse shqiptare në SHBA.

Në këto rrethana, ai hidhet në një fushë të re krijimtarie: në atë të përpunimit të muzikës për shërbime të kultit, të kompozimit dhe të studimit muzikor. Më 1934, pesëdhjetëdyvjeçar, hyn në Konservatorin e Niu-Inglandit. Më 1936, boton një përmbledhje të literaturës muzikore për shërbime të kultit, «Hymnore për kor të përzier» nga autorë të ndryshëm bizantinë, rusë, ukrainas etj., copa muzikore nga Çajkovski, Davidovi, Arkangelsi, Rimski-Korsakovi, Ipolit-Ivanovi, Bortianski, Grigorievi etj. Si punë diplomë paraqiti në Konservator poemën sinfonike «Skënderbeg» me 6 tema mbi bazën e motivit të vjershës «Kithimi i Skënderbeut në Krujë» të H. U. Longfellowit, «Rapsodinë shqiptare» mbi bazën e disa temave popullore dhe poemën «Gaspari i varfër» (sipas vjershës «Jetimi» të Pol Verlenit). Duke filluar nga ky vit, «Vatra» u përça: një degë e saj ngeli në Boston, tjetra në Detroit. Noli qëndroi në Boston. Lidhjet me disa miq të vjetër nuk i preu. «Mora me kohë letrën tuaj të bukur dhe u gëzova që s'më kishin harruar. Edhe unë ju kujtonj nga një herë» i shkruan, në vjeshtën e vitit 1937, mësuesit Kiçon K. Prifti në Rehovë dhe i shpreh shpresën se do të piqet prap me të, duke nënshkruar «F. S. Noli nga Qyteza e Kolonjës». Më 3 nëntor 1937, po nga Bostoni, po këtë mik të vjetër i rrëfen për gjendjen e keqe ekonomike në të cilën gjindej: «I dashur vlla, po ju dërgonj anën e vllajt tuaj një dhuratë të vogël prej pesë dollarësh, jo se më tepërojnë, po se dua t'ju provonj që kam dëshirë t'ju mbaronj lutjen të pakën pjesërisht. Këtej, që prej tre vjetësh, vuajmë të zit e ullirit nga të gjitha pikëpamjet. . .» Ishte kjo një ndihmë që Noli i dërgonte mësuesit të fshatit Rehovë, pasi ky

dikur e kishte ndihmuar atë me një shumë të tillë modeste të hollash. Në vazhdim të studimeve muzikore, më 1938 mori nga New England Conservatory of Music diplomën «*Bachelor, of Music*».

Etapa e rënjes shpirtërore nuk zgjati shumë kohë. Pushtimi fashist italian i Shqipërisë, tradhëtia e monarkisë dhe sidomos Lufta nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, nën udhëheqjen e PKSH, ndezën më thellë te ai ndjenjën e zjarrtë patriotike. Në këtë kthesë të madhe të popullit shqiptar, Fan Noli nuk qëndroi indiferent: dënoi pushtimin fashist italian dhe gjerman, përkrahu Luftën nacionalçlirimtare dhe revolucionin demokratik popullor. Më 25 nëntor 1944, botoi në fletoren «*Dielli*» artikullin «*Dy fjalë mbi ditën e Flamurit*» ku, ndër të tjera, thekson: «*Që kur u shkel Shqipëria prej fashizmit më 1939, kjo është hera e parë që do të kremtojë ditën e Flamurit me buzë të qeshur. Gjer motin e shkuar shituata e Shqipërisë ishte shumë e errët, se nuk kishte një guvernë, e cila t'i dilte zot dhe t'ja mbronte të drejtat. Tani shituata u ndryshua krejt. Tani Shqipëria ka një guvernë kombëtare... (e cila) ka luftuar kundër armiqëve të përbashkëmë që në krye të punës; me një trimëri dhe me një zotësi të çudiçme kjo guvernë ka sot në dorë 3/4 e tokës kombëtare dhe nuk është çudi që, kur të lëçiten këto radhë, të jetë zonja e vendit an'ë mbanë Shqipërisë». Dhe, më tutje, duke përkrahur qeverinë e parë demokratike popullore, shkruan: «... nga errësira e qorsokakëve po hyjmë në dritën edhe në fushën e hapur të veprimit, me udhëheqës që e kanë provuar zotësinë e tyre në vijën e zjarrit. Këta udhëheqës duhen përkrahur pa kondita, pa rezerva dhe pa kursim, se e meritojnë*



besimin e popullit plotësisht. Me këta udhëheqës fati i Shqipërisë është i shiguruar. Rroftë Shqipëria!» në vazhdim të përkrahjes së qeverisë demokratike popullore me në krye udhëheqësin e partisë dhe të popullit, shokun Enver Hoxha, F. S. Noli thekson në fletoren «Dielli» të 2 tetorit 1945: «Garantia më e mirë për mbrojtjen e Shqipërisë janë bazonetat e Enver Hoxhës». Duke kundërshtuar presionin që ushtronin mbi të ballistët e arratisur si armiq të popullit në SHBA, F.S. Noli shkruan më 26 mars 1946 në fletoren «Dielli kryeartikullin «Dy fjalë mbi ballistët», ku, ndër të tjera, hedh poshtë pretendimet e shpifjet e tyre dhe ngre lart rolin historik të qeverisë demokratike: «Guverna e Enver Hoxhës jo vetëm e shpëtoi Shqipërinë nga vdekja, po tani i vë themele të patundura shtetit me reformat dhe veprat konstruktive. Këto vepra mund t'i bëjnë vetëm një guvernë homogjene, e qëndruarshme, me një program të caktuar përparimtar». Më 28 nëntor 1946, po në fletoren «Dielli» lexojmë prej tij: «Dielli i flaktë është guverna demokratike e Enver Hoxhës, e cila pa dyshim është e fortë edhe brenda edhe jashtë: brenda, se përveç veprave të tjera konstruktive ka mundur ta zbatonjë reformën agrare me rrënjë dhe ta transformonjë Shqipërinë nga një çiflik të bejlerëve në tokë të fshatarëve e të punëtorëve. Jashtë, se për herë të parë në histori të saj, Shqipëria e vogël qëndron ballpërpjetë dhe di t'ua japë xhuvapin kapadainjve, që i bien më qafë qofshin të humbur si Greqia, qofshin të mëdhenj si Inglia». Ndërkohë; midis kryetarit të Qeverisë Demokratike shokut Enver Hoxha, dhe F. S. Nolit u shkëmbyen mesazhe. «I nderuari zoti Noli,

— i shkruan më 25 shtator 1945 shoku Enver Hoxha,  
— mesazhi i përzemërt që më dërguat më preku shumë dhe ju falem nderit. Për mua, për shokët e mi të luftës dhe për gjithë popullin shqiptar, fjalët Tuaja shprehin ndjenjat e larta patriotike dhe pasqyrojnë shpirtin demokratik të vëllezërve tanë të dashur të Amerikës dhe Tuajat, që keni qenë shpirti dhe mburrja e tyre. Në vuajtjet e popullit tonë, në zjarrin e rreptë për çlirim, ku u hodhën pa rezerva gjithë forcat tona për kauzën e shenjtë të atdheut dhe të njerëzimit, ne mbanim të pashuar në zemër kujtimin dhe dashurinë për ju, o vëllezërit tanë të Amerikës, që në çdo moment keni luftuar për atdheun tonë të shenjtë dhe të përbashkët. Shqipëria, për lirinë dhe pavarësinë e së cilës ranë me mijëra djem të popullit, Shqipëria, për të cilën, i nderuar zoti Noli, keni shkruar energjitet Tuaja, sot është e lirë: sot në qiellin e saj valon flamuri i pavarësisë dhe i demokracisë. Populli ynë heroik, që dha prova të shkëlqyera në këtë luftë, me besim të madh në forcat e veta i është përveshur punës për të ndërtuar një të ardhme të lulëzuar. Dhe në përpjekjet tona për t'ja arritur këtij qëllimi do të jemi të gëzuar që Ju, si një luftëtar i palodhur për pavarësinë dhe demokracinë shqiptare, të jeni në gjirin e ngrohtë të popullit tuaj, për t'i dhënë ndihmën tuaj të çmueshme dhe për të kurorëzuar përpjekjet e vlefshme në atdheun ku triumfuan idealet e popullit. Mua ma do zemra që, në zgjedhjet e afërme për Asamblenë Kushtetuese, emri Juaj të figurojë tok me tanët dhe populli shqiptar, lirisht dhe demokratikisht, të sanksionojë përpjekjet dhe veprat tona të përbashkëta. Ashtu si kemi qenë kurdoherë të bashkuar me zemër në

luftën tonë, ashtu të jemi edhe tani e përgjithmonë për të mirën e popullit tonë të dashur dhe për mbrojtjen e paqes së njerëzimit». <sup>3</sup>. Më 13 tetor 1945, Noli përgjigjet me këtë letër: «Me kënaqësi të madhe mora mesazhin t'uj të nxehtë dhe bujar... Kam dëshirë të madhe të jem aty me juve, po sot për sot nukë munt, pse udhëtimet janë të kufizuara, përveç që ka edhe pengesa të tjera. Mundet të ju bën një vizitë pas Pashkëve, kështu do të takoj përsëri me miqtë e mi të vjetër. Kam shumë arsye që më pengojnë të vë kandidaturën në Shqipëri. Ju siguronj se ju kini përkrahjen t'ime të plotë dhe munt të përdorni emrin t'im në fushatën elektorale që populli të votojë për Frontin. Bashkë me këtë ju lutemi të drejtoheni tek unë për çdo gjë që unë munt të bën për këtë çështje. Si juve ashtu edhe kolegëve tuaj. Ju uronj sukses, sindë kur e meritoni, në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetontjëse». <sup>4</sup>. Po atë ditë që organi i Frontit Demokratik të Shqipërisë, «Bashkimi», botoi këtë letër, bëhej njoftimi se, për kontributin e madh që kishte dhënë në fushën e kulturës dhe të letrave shqipe, Konferenca e Shkrimtarëve të Shqipërisë, e mbledhur në Tiranë më 7-11 tetor 1945, e kishte zgjedhur Fan S. Nolin kryetar nderi të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Po këtë vit ai fitoi doktoratin e filozofisë për histori nga Boston University, në moshën 63-vjeçare. Kur një delegacion i Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë arriti në Nju-Jork për çështje të OKB-së, më 1946, Noli u nis nga Bostoni dhe vajti të takohet me delegacionin, një anëtar i të cilit, Alqi Kristo, dëshmon ndër të tjera: «Një burrë i shkurtër, fytyrë-gjërë, me flokë të rënë... Sytë i shkëlqenin nga gëzimi, midis

asaj fytyre meditative dhe të përvuajtur. Ai nuk i kishte arritur atëhere të gjashtëdhjetepesat, dhe, ndonëse mua më dukej shumë plak, mbahej mirë dhe ecte më këmbë... Ai na pyeti për Shqipërinë, për luftën, për programin e pushtetit tonë dhe nuk i kurseu fjalët e mira dhe lëvdatat... Noli kishte një humor plot kripë. Ai mbajti fjalime shumë tërheqëse. Të gjithë e vështronin gojëhapur. Fjalimet i fillonte zakonisht me paravoli ose me anekdota humoristike dhe nuk të linte të mërzhiteshe, se shpeshherë hapte parentesa ose tregonte episode e ngjarje të ndryshme, që i lidhte aqë bukur me temën e bisedës dhe mbante gjallë vemendjen e të pranishmëve»<sup>5</sup>. Pasi u kthye në atdhe, ky dëshmitar mori nga Noli, më 23 dhjetor 1946, këtë letër: «I dashur vëlla, u gëzova shumë për zellin me të cilin i jini përveshur veprës së rindërtimit. Shumë bukur. Po për planet letrare që hartuam në New York nukë më pipëtini as gjysmë fjale. Apo mos i hohtë në det kur kapërcenit Atlantikun? Si vete me përkthimin e Shakespeare-it? Shkruamëni prapë kurdoherë që t'ju lejonjë rutina e mërzhitur e zyrës...»<sup>6</sup>. Përballë kërcënimeve të monarko-fashistëve grekë ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë. Noli mbajti qëndrim të prerë. Disa herë me radhë vajti për t'u takuar me përfaqësitë e shteteve të ndryshme dhe me anëtarë të Këshillit të Sigurimit, në mënyrë që të mbronte çështjen e drejtë të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të denonconte ndërhyrjet brutale të monarko-fashistëve grekë. Kjo ishte vazhda e luftës që kishte bërë me kohë kundër «megaliidhesë» dhe «fanarit», prandaj grekët fanatikë e reaksionarë e urryen gjatë tërë jetës së tij

prej patrioti konsekuent shqiptar.

Në këtë kohë u dha pas studimeve në fushën e muzikës dhe të historisë. Mësimet e para të muzikës i kishte marrë në fëmëni nga i jati, në fshatin e lindjes. Pas botimit të përmbledhjes së literaturës muzikore për shërbime kulturi, pas ngritjes së koreve me repertor të tillë dhe mësimëve që ndoqi në Konservatorin e Nju-Inglandit, ju vu krijimtarisë origjinale, duke lënë në dorëshkrim poemën për orkestër *Skënderbeu*, një uverturë bizantine për orkestër, një kompozim mbi një vjershë të Pol Verlenit për solo, tenor dhe orkestër etj. Pikërisht te *Gaspari i varfër* është domethënës fakti se si buçet tema e Internationales.

Më 1947, Noli paraqet inglisht si tezë në Konservatorin e Nju-Inglandit studimin *Bethoveni dhe Revolucioni francez*<sup>7</sup>. Kërkimet dhe gjurmimet për hartimin e kësaj ese-je i kishte filluar që kur ishte në Vjenë. Me një dokumentim të pasur dhe gjykime origjinale, përpigjet të tregojë ndikimin që ka ushtruar revolucioni në fjalë mbi kompozitorin, duke i vënë vetes këto probleme për të zgjidhur: «Gjer në ç'pikë ndikuan tek ai idetë e reja që përhapin Revolucioni francez dhe gjer ku e pasqyroi ai frymën e asaj kohe në muzikën e tij». Në vëllimin prej 120 faqesh, ndarë në katër pjesë, Noli e nxjerr kompozitorin republikan, duke shqyrtuar së toku qëndrimin e tij si njeri dhe si artist. Idetë e Bethovenit i argumenton me veprat e tij dhe me një literaturë shumë të pasur. Por te kompozitori gjen edhe disa pikëpamje reaksionare e qëndrime oportuniste. Ka rëndësi të vërehet fakti, se në libër autori përpigjet

të lidhë jetën e kompozitorit me veprën dhe këto t'i interpretojë në rrethanat konkrete historike. Të bën përshtypje erudicioni i autorit në këtë lëmë, njohja e thellë e jetës dhe e veprës së Bethovenit, si dhe e lëndës letrare rreth tij. «Nga të gjithë jetëshkronjësit e Betovenit në shekullin XIX — shkruan Noli — Shindleri është i vetmi që ka ngulur këmbë se Bethoveni ka patur një ideologji republikane, se ai besonte në parimet e revolucionit Francez, dhe se ai u frymëzua nga ato për kompozimet e kryeveprave të tij. . . Në shekullin XX, dy francezë u morën me këtë problem dhe e rrahën pak a shumë gjerësisht: Vensan d'Endi dhe Romen Roland, i pari nga ana mohore dhe i dyti nga ana pohore. Vensan d'Endi thotë se Bethoveni nuk pati asnjë ndikim nga Revolucioni Francez, teksa Romen Rolandi i jep Bethovenit titullin e lavdishëm «Bir i Revolucionit. . .» Noli pajtohet me Shindlerin dhe me Romen Rolandin, sidomos me të dytin, por duke shtuar edhe disa dobësi, të meta dhe qëndrime kontradiktore të kompozitorit të madh, të cilat studimtari dhe shkrimtari francez nuk i vërejtë. «Gjermania dhe Austria — përmbylli Noli — patën një ndikim të thellë nga Revolucionit Francez. Këtë e pati edhe Bethoveni... Ai ishte republikan... Si përfundim, Bethoveni ka qenë një «Bir i Revolucionit Francez», sikurse e ka përshkruar atë Romen Rolandi, me pak vrejte për disa pikëpamje të tij reaksionare dhe veprime oportuniste...» Ai vuri në dukje kontradikta të tilla të Bethoveni: më një anë «afetarizmin e tij revolucionar» dhe më anë tjetër krijimin e një muzike reaksionare për fenë; më një anë idetë e tij republikane dhe më anë tjetër lakminë për t'u çmuar si aristo-

krat; më një anë simpatinë për revolucionin, më anë tjetër adhurimin për herojtë, etj. «Për të studjuar jetën — shton Fan S. Noli — pikësëpari duhen spastruar pa mëshirë të gjitha legjendat dhe të mbahen vetëm faktet. Ahere Bethoveni na del njeri i vërtetë. Dhe njeriu i vërtetë është më interesant se të gjithë heronjtë legjendarë të marrë së bashku, për arësyen e thjeshtë se këta të fundit janë pjellë e imagjinatës së adhuronjësve të heronjve». Në bazë të këtij kriteri, ai vu në dukje edhe dobësitë e karakterit të kompozitorit, siç ishin: sjellja e kompozitorit prej «despoti oriental» me mjedisin rrethues, të dhënit e tij pas pijes së tepër alkoolike, dashuricikat joserioze, etj. Pra Bethoveni nuk ishte një «hero» as «evlija», siç e përfytyruan adhuruesit e tij të papërmbajtur, por një njeri me të mira dhe të meta si njerëz të tjerë në botë. Një vlerësim të lartë i bëri autori i studimit *Simfonisë së nëntë* të Bethovenit, duke zberthyer, në radhë të parë, idetë që shtjellon ajo: «Në «*Simfoninë e nëntë*» gjejmë një hymn të vëllazërimit botëror. Në fillim, kënga e gëzimit ka qenë kënga e lirisë dhe Bethoveni kishte merak që t'ua bënte të qarta masave idetë e tij: ai donte t'ua shprehte atyre idetë e reja të Revolucionit francez në një gjuhë të kapëshme e të këndëshme. Revolucionar në pikëpamjet e tij politike, Bethoveni është revolucionar edhe në artin e tij. Në pjesën e fundit të *Simfonisë së nëntë* ai ka futur muzikë korale dhe solo vokale. Kur u dha në *Vjenë Simfonia e nëntë*, më 7 maj 1824, sa doli Bethoveni, pritja ishte e mahnitëshme, urimet dhe përsëhëndetjen muarën karakter demonstrativ... Me *Simfoninë e nëntë*, këtë Simfoni jakobine të Lirisë, Ba-

razisë dhe Vëllazërimet, Bethoveni u kuptua jo vetëm nga masat e Vjenës, po nga masat e të gjithë botës e të të gjitha kohëve. Dhe këtë mesazh ai e dha në kushtet e rënda të censurës reaksionare të Meternikut». Pasi e botoi, Noli u dërgoi disa ekzemplarë të veprës shkrimtarëve, kompozitorëve dhe historianëve të njohur të vendeve të ndryshme, shumë prej të cilëve ju përgjigjën me shkrim. Nga këto përgjigje autori çmonte më shumë letrën që i drejtoi Zhorzh Bernard Shou, më 11 nëntor 1947. Shqipërimin e kësaj letre e bëri vetë Noli: «U gabuat në zanatin kur u dorëzuat klerik. *Libra juaj (Bethoven and The French Revolution)* nukë është predikimi a haggjografia e një kallogjeri, ajo është vepra e një kritikë dhe biografi të dorës së parë. E këndova që në krye gjer në fund me kënaqësinë më të madhe, dyke qenë vetë usta si muzikant, kritik, edhe artist-filozof profesional. E dini ndofta se njeriu kurrë nukë këndon librat, që i dhurohen me thasë, ashtu siç m'i dërgojnë mua.

E vetmja kritikë që kam të bënj është që thekësimi juaj mi Bethovenin pjanik, hamës, gojëvrrarë, ndyrëfolës, gjaknxehtë, dhe batakçi, ndonëse është një ballancë e nevojshme kundër Bethovenit të shenj-të, prapë nukë është Bethoveni i tërë, dhe parandaj njeriu lëndohet pakëzë nga titulli i juaj mi Bethovenin pjanik i kaptinës «Bethoveni si Njeri». Natyra e tij njerëzore e zakonitë ishte herë-herë shumë vullgare; po natyra e tij e pazakonitë, çuditërisht finoke, bujare, dhe e bukur, ishte jo më pak natyra e tij njerëzore e vërtetë: dhe ajo, pa fjalë, ishte pjesa e pavdekur. Kështu që jetëshkronjësi i tij Schindler duhet të ndjehet që zbatoi këshillën të cilën i jep



Hamleti nënës, dhe u përpoq ta hedhë tutje pjesën e vdekur. Mirëpo kjo është vetëm një çështje mbi titullin e një kaptine, e cila nofta duhet të ishte «Ana e çthurrur».

Sikur të isha në vëndin tuaj, do të kisha ndryshuar dhe ndrequr dy fjalë. Nuk do ta quanja Bethovenin pjanik, po sarhosh, i cili rronte me alkool, dhe nukë punonte dot pa shishen, po kurrë nuk dehej as çalohej nga e pira, po përkundër.

Nga ana tjetër, do të ndronja këtu-atje fjalën «I pafeshmë» dhe do ta bënja. «I pasektë», se nënëse Mesha Solemne ka më tepër shamatë dhe fuggë se sa fe (përveç Dona Nobis) prapë Bethoveni si Tom-Piane, Shelley, dhe Mozarti në Fyellin magjik, ishte një katolik i madh në kuptimin e përgjithmë.

Mos e quani për detyrë të përgjigjeni, nëqoftëse jini i zënë me punë. Kjo nukë ka nonjë rëndësi. Jam thellësisht mirënjohës»<sup>8</sup>.

Më 1948, me rastin e 40-vjetorit të veprimtarisë së F. S. Nolit në gjirin e shqiptarëve të mërguar në Amerikë, Federata panshqiptare «Vatra» botoi përmbledhjen e parë të poezive origjinale dhe të disa shqipërimeve të tij të zgjedhura poetike. Këtë përmbledhje të titulluar «Album» Noli ua kushtoi «Kryetrimave, që e çliruan Shqipërinë nga fashistët, nga nazistët, nga bejlerët». Në këtë botim hynë poezitë politike të njohura (përveç Fryn, moj erë... dhe Bismilah...) dhe dy poezi të buta lirike, të endura me një humor të lehtë: «Plak, topall dhe ashik dhe Sofokliu, të cilat i nënshkroi me pseudonimin Bajram Domosdova (1880-1930). I ngjasin këto, sidomos e dyta, ndonjë rubaire të Omar Khajamit, siç është strofa:



Fan S. Noli

1845

«Kur të vdes, dhe kur të më mbuloni,  
Çupa, gra, në varr mos më vajtoni  
Do t'ju dua prapë, siç më doni.  
Dolla! Mos më zgjoni.»

Në këtë botim hynë, gjithashtu, shqipërimet e poezive *Korbi* dhe *Annabel Lee* të Edgar A. Poe-s *Asaj që shkoj* e Sh. P. Bodlerit, *Dashuria e funtme* e F.I. Tjutçevit, *Jetimi* i P. Verlenit, fragmenti i tragjedisë *Prometheu i mbërthyer* të Eskilit. Thuhet se kishte ndër mend të përkthente edhe *Jetën e Pirros* të Plutarkut dhe *Ëndrrat* e Lucianit. Me sa duket, në punë të përkthimit ndonjëherë, Noli u tërhoq më shumë nga ana e figuracionit poetik se sa nga ana e brendisë ideore, gjë për të cilën janë dëshmi dy variantet e vjershës mistiko-simboliste *Korbi* të E.A. Poe-s.

Në këto vite ai nuk reshti së interesuari për të rejat që i njoftonin nga Shqipëria. Më 21 tetor 1948, nga Bostoni, i shkruan S. Luarasit, që i kish dërguar veprën e Migjenit: «*Ju falem nderit për vjershat e Migjenit të cilat i këndova me interes të thellë*». Ndërkohë, i ishte vënë përpunimit të veprës së tij madhore në prozë *Historia e Skënderbeut*, duke mos e çmuar të përkryer variantin e parë të vitit 1921, sidomos nga ana shkencore. Prandaj, në rrjedhim të kërkimeve të mëtejshme, nxori në dritë, më 1949, variantin e dytë shqip, që është një përpunim mjaft i thelluar, si në strukturën, ashtu edhe në brendinë. «*Jam i lumtur që, pas njëzet e tetë vjetësh, po u jap Shqiptarëve sot revizionin e një historie të Skënderbeut, që kam shkruar më 1921*» shënon në Pa-


rathënje, më 20 prill 1949. Dhe vazhdon: «Në vep-  
rën e re, me sa munda, jam përpjekur të plotësoj  
mungesat e veprës së vjetër. Pa fjalë, kam përfitur  
nga studimet e dijetarëve të ndryshëm, që janë ma-  
rrë me këtë subjekt më parë. Emrat e tyre janë të  
radhitura shkurtas në kaptinën e funtme të kësaj  
libre, edhe ca më gjërë në bibliografinë e edicies  
inglishte... Më vjen keq të thom që disa libra dhe di-  
sa dokumenta nuk i gjeta dot nëpër libraritë ameri-  
kane. Për këto, duhet një udhëtim në Europë. Kam  
shpresë ta bëj me rastin e parë, dhe ahëre mund të  
botonj nonjë broshurë, në të cilën të ndriçonj disa  
pika që i kam lënë të errëta në këtë histori». Një  
dëshirë të tillë nuk e plotësoi dot. Megjithëse nuk  
arriti në një analizë plotësisht shkencore materia-  
liste të faktorëve ekonomikë dhe shoqërorë, që përcak-  
tuan epokën në fjalë, prapëseprapë vepra u ngrit  
në cilësi, sidomos përsa i përket paraqitjes së heroit  
si udhëheqës të lidhur me masat fshatare, vlerësimi  
më të madh të rolit të masave në luftë për mbrojtjen  
e vendlindjes në dy fronte: qoftë kundër «bejlerëve  
feudalë turqë të lindjes», qoftë kundër «borgjezëve  
kapitalistë venecianë të perëndimit», të cilët donin  
«t'i skllavëronin edhe t'i sfrutonin» katundarët  
shqiptarë. Në lidhje me taktikat që përdori Skënder-  
beu, shprehu mendimin se edhe në këtë çështje ai u  
mbështet në artin luftarak të popullit. Për armën tra-  
dicionale e përsosi për atë kohë. Kështu, përveç tak-  
tikës së mbrojtjes dhe asaj të raskapitjes së kundër-  
shtarit, kryetrimi shtiu në punë edhe atë të shfaro-  
sjes me forca të vogla sulmuese. Ky variant i për-  
punuar hyri në letërsinë e shkencës botërore të his-  
torisë për epokën e luftërave për liri të popujve të

FAN S. NOLI

*Album*

TIRANE, 1958

Album



Evropës jug-lindore në shekullin XV. Dhe ashtu si-  
kurse shkrimtarët e historianët shqiptarë, duke për-  
fshirë edhe Nolin, që erdhën pas Barletit, nuk mun-  
dën të mos ndikoheshin nga vepra e këtij histori-  
shkruesi të vjetër, po ashtu edhe shkrimtarët e his-  
torianët, që erdhën pas Nolit, nuk mundën të mos  
e marrin parasysh veprën e tij historike, së cilës, kra-  
has vlerësimit, i bëjmë edhe kritikën për kufizimet  
që ka kjo në analizën e shoqërisë shqiptare dhe për  
prirjen që ka të mbulojë karakterin klasor të sun-  
dimit të Skënderbeut, duke e identifikuar këtë me  
fshatarët shqiptarë të kohës. /

Përveç një edicioni inglisht të veprës *Historia e  
Skënderbeut* Noli botoi inglisht edhe një *Autobio-  
grafi* <sup>10</sup> në trajtën e rrëfimit të kujtimeve, kurse për-  
punimet e krijimet origjinale muzikore për shër-  
bime kulti, i botoi, në përmbledhje më vete, më  
1951 dhe 1959.


I thyer tanimë nga mosha e kaluar, i lodhur nga  
puna e pareshtur dhe e dendur krijuese, i rrahur  
nga dallgët e jetës dhe i goditur nga një radhë së-  
mundjesh anemia, reumatizmi, diabeti dhe, së fun-  
di, kanceri, duke u ushqyer për një kohë të gjatë  
vetëm me barishte, F.S. Noli nuk e lëshonte veten,  
por gjithnjë, me këmbëngulje dhe pasion shembu-  
llor, punonte ditë e natë, pasuronte kulturën me le-  
xime veprash historike, letrare, filozofike, muziko-  
re, përkthente ose krijonte gjëra të reja. Ju vu he-  
braishtes dhe e përvehtësoi në atë shkallë, sa të për-  
kthente inglisht psalmet (*Psalms*, 1964). Duke nën-  
shkruar me pseudonimin Namik Namazi, nxori në  
dritë dy poezitë e fundit origjinale që njohim prej  
tij: e para, *Sulltani dhe Kabineti*, e shkruar më 17



janar dhe e botuar më 5 korrik 1961, kurse e dyta, *Saga e Sermajesë*, e shkruar më 11 shkurt dhe e botuar më 27 mars 1963. E konceptuar si një monolog i sundimtarit, tiran, i monarkut satrap, vjersha e gjatë politike *Sulltani dhe Kabineti*, nga ambjenti anadollak që përshkruan, nga fryma denoncuese që përmban nuk është vetëm një aktakuzë kundër mbretit dhe mbretërisë në përgjithësi, por një stigmatizim i rreptë kundër ish-mbretit Zog dhe klikës së tij uzurpatore në veçanti. Pasi e demaskoi ashpër për të gjallë, me gojtari, publistikë dhe një tok vjershash satirike, Noli e dënoi me verdiktin kapital edhe pas vdekjes tiranin Zog, që ishte armiku kryesor i tij në betejën politike midis Revolucionit demokratiko-borgjez dhe kundërrevolucionit çifligaro-borgjez. Kjo, në këtë kuptim, është anathema e fundit e poetit shtatëdhjetenëntëvjeçar kundër kryekundërshhtarit të vet, është pasqyrë e vdekjes civile të këtij «Sulltani» Shqiptar në planin historik.

*«Jam Ali Qopeku i Parë,  
Qen si unë s'kini parë;  
Pra, kur leh, dorëtrokitni,  
Zbrazni topa e brohoritni.*

*Jam imami e jam dovleti,  
Padishahu e Muhameti,  
Jam Xhenemi e jam Xheneti,  
Kijameti e selameti.*



Fan S. Noli

1111 11 11

*Jam xhamia e jam namazi,  
Jam zinxhiri e jam kafazi,  
Jam budrumi e jam zullumi,  
Kush ngre kokën e merr lumi.*

*Kush do ligj' e republikë  
Me statut e me llogjikë  
E ka pisk, dhe ngordh si hor  
Në konop si tradhëtor. 11,*

Tirani nuk demaskohet vetëm si uzurpator, lakmiqar për sundim e lavdi, por edhe si njeri i ulët, me veset më të liga në jetë, si bishë me fytyrë njeriu. Tërë mëria, vreri dhe zemrata e zjarrtë prej demokraci janë derdbur në këto vargje, si kundër monarkut absolut, ashtu dhe kundër dinastisë së tij, të përbërë nga gjaksorë, xhahilë, dallkaukë dhe hajdutë. Në këtë kuptim vjersha *Sulltani dhe Kabineti* është një zhvillim më i thelluar, një përgjithësim deri në simbol, i vjershës *Kënga e Monarkisë* (titulluar pastaj *Kënga e Salep-Sulltanit*), shkruar 33 vjet më parë. Në vjershërinë shqipe politiko-shoqërore, kësaj vjershe mund t'i përqaset vetëm satira e mprehtë *Sulltani* e A.Z. Çajupit, jo aq në konceptimin si monolog tirani dhe në mjetet figurative popullore të shprehjes, sa në brendinë ideore të denonciimit të monarkisë anadollake, anakronike. Por duhet thënë se kjo nuk ka koncizitetin e njohur, nuk ka masën dhe përpjesëtimin, që jemi mësuar t'i shohim te vjershat e tjera politike të poetit.

Tjetër temë trajton *Saga e Sermajesë*. Është,

pothuaj, tema që shtjelloi poeti te vjershat e buta lirike *Plak, topall dhe ashik dhe Sofokliu*, por tani në një plan më të gjerë filosofik. Ngjarja ndodh, gjoja, dikur dhe diku, në vendet orientale. Orhani beqar don të marrë për grua Shah-Name Sermajenë e të pasurit Qor-Hasan, por ai është i varfër dhe s'ka para ta blejë, prandaj duhet të bëjë diçka me hile. Merr me vete Çelebiun, trim Turhanin dhe, që të dy, hipur i pari mbi kalë dhe i dyti mbi gomar, si dhëndër me kurorë i pari dhe si kumtër me këmborë i dyti, tamam si Don Kishoti dhe Sanço Pança në kërkim të së bukurës Dylqinjë, nisen për të rrëmbyer Shah-Name Sermajenë e Qor-Hasanit. Në një hipërbolë të goditur, poeti tregon se, kur nisen me bujë dy miqtë për këtë bëmë, tundet dheu dhe nxihet qielli, sa çuditen Irani, Kurdistan, Afganistani, Turkestani dhe Hindustani. Poeti gjen rastin të hapë një parantezë, për të denoncuar aventurën politike të Hitlerit (ai e quan Hitokatili) dhe të Musolinit kundër vendit të sovjetëve. Shan-Name Sermajeja prashitte tokën në arën e Qor-Hasanit, prapa drizave dhe misrave, dhe nuk e çante kokën. Qor-Hasani, hajdut dhe kapedan, i mbante sytë mbyllur, por sakaq merrte nishan dhe të vriste, prandaj trim Turhani e fton Orhanin që të heqë dorë nga vasha. Kuptohet që kontrasti shoqëror është pengesa e pakapërcyer, ndaj poeti e mbyll vjershën me këto vargje:

*«Ler-i çupat, mos i nga,  
Mos i merr as badjava,  
Se të kap sevdaja,  
Dhe të mbyl belaja».* 12)

Megjithatë, alegoria nuk del e qartë dhe nuk përjashtohet mundësia që në këtë vjershë të ketë aluzion edhe për anë të panjohura intime të poetit, gjë që vërehet edhe në vjershat *Plak, topall dhe ashik* dhe *Sofokliu*.

Sërisht me pseudonimin kuptimplotë Namik Namazi, Noli boton shqipërimin e disa poezive lirike të njohura në antologjitë botërore. Nga Viktor Hygo jep shqip dhe i boton radhazi: *Lule mi varr*, më 11 janar 1961, *Vajtim për të bijën* (A Villequier), më 31 maj 1961, dhe *Waterlo* më 7 gusht 1963; nga R. Kipling *Në munç*, më 1 nëntor; nga A. F. Arvers *Dashuria e fshehtë* më 20 dhjetor 1961; nga J. W. Von Gëte *Qetësia, Vija, Kënga e natës* dhe *I perëndishmi* më 12 qershor 1963; nga H. Hajne *Grenadierët e Napoleonit*, më 19 qershor 1963; nga Sh.P. Bodler *Kapaku i tenxheres* më 26 qershor 1963; nga Leib Neidus *E dua pyllin* më 3 korrik 1963; nga U. Nou *Kotësia njerëzore* më 14 gusht 1963; dhe nga Çidiok Tiçbërn *Në vëngjillen e vdekjes* më 4 shtator 1963.

Janë interesante shënimet që shqipëruesi poet u bën disa poezive që përkthen, si. p.sh., lirikës *Grenadierët e Napoleonit* të Hajnes, pavdekësuar si këngë me muzikë nga kompozitori gjerman Robert Shuman, lirikës *Kotësia njerëzore. Në vëngjillen e vdekjes* etj, etj. «Kjo kryevepër tronditëse — shkruan ai për *Waterlo* të Hygoit — s'ka shoqe as në leteraturën frënge as në leteraturën e përbotëme. *Vini re përshkrimin dramatik të betejës fatale... Poeti e përshkruan këtë katastrofë me një mjeshtri demoniake...»*

Janë vitet e fundit të jetës së tij. Më 25 maj 1964, të nesërmen e 20-vjetorit të Kongresit të Përmetit, që u kremtua me gëzim të madh nga ma-


sat punonjëse në Shqipëri, F.S. Noli i shkruan shkrimtarit Milto Sotir Gurra, mikut të vjetër, që po festonte 80-vjetorin e ditëlindjes: «Ju jeni i lumtur, se e kremtoni këtë përvjetor në vendlindje. E mbaj mend kur u talnuam për të parën herë në Manchester New-Shemper, rreth 57 vjet më parë (rreth vitit 1907, V.B.) ... Ne, që të dy, kemi patur fatin se kemi rrojtur mjaft gjatë sa për ta parë këtë (suksesin e luftës së popullit shqiptar për çlirim, V.B.). Sa shumë të tjerë nuk e gëzuan këtë privilegj. Kështu, sidoqoftë, ne i përkasim grupit të të fatlumëve Vetëm kjo ndjenjë është e mjaftueshme për të kundërbalancuar të gjitha vështirësitë që kemi patur në të kaluarën dhe mund të kemi përsëri në të ardhmen». <sup>13</sup> Këtë letër nuk e shkroi vetë, sepse i dridhej dora nga pleqëria dhe shkrimi nuk do t'i kuptohej, por ja diktoi inglisht shkronjësit, që nuk e dinte shqipen. Në tetor 1964, M.S. Gurra i dërgoi poetit një kopje të vjershës *Bismilah...*, që Noli e kishte shkruar më 1914, 50 vjet më parë. Poeti i përgjigjet: «Të lumtë dora! Më ardhi e pa pritur. E kërkonja, po s'e kisha kopjen», <sup>14</sup>.

Në fillim të nëntorit 1964, Fan S. Noli u shtrua në një spital të Bostonit, për t'u operuar në stomak, por ishte vonë, sepse tanimë kanceri e kishte brerë përbrenda. Doli nga spitali i pashëruar, me dhimbje të forta. Më 20 nëntor vajti në Florida. Atje, në banesën e tij, në Fort Laudedeil, mbylli sytë përjetë, më 13 mars 1965, larg atdheut të shtrenjtë, që e dëshoi me zjarr të pashuar prej patrioti dhe demokraci revolucionar. E varrosën në Forest Hills Cemetery,



Fan S. Noli





të Bostonit. Në telegramin e ngushëllimit që Kryetari i këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, shoku Mehmet Shehu, u dërgoi vëllezërve shqiptarë patriotë të mërguar në Amerikë, thuhet ndër të tjera: «Populli shqiptar dhe qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, në personin e Fan S. Nolit nderojnë patriotin e madh dhe luftëtarin e zjarrtë e të paepur për pavarësinë kombëtare dhe lulëzimin e Shqipërisë, ish kryetarin e qeverisë demokratike të qershorit 1924, studjozin dhe poetin e madh, që me veprën e tij pasuroi letërsinë dhe thesarin kultural të Shqipërisë. Shpreh dëshirën e popullit shqiptar dhe të qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë që trupi i këtij patrioti demokrat revolucionar, bir i shquar i popullit shqiptar, të sillet dhe të prehet për jetë në Atdheun e tij të shtrenjtë, që ai e desh me aqë zjarr dhe të cilit i kushtoi gjithë veprimtarinë dhe jetën e tij. . . Emëri dhe vepra e Fan S. Nolit do të kujtohen kurdoherë me nderim dhe mirënjohje nga populli shqiptar dhe nga të gjithë patriotët shqiptarë jashtë Atdheut».

Kërkesa e ligjshme e popullit shqiptar dhe e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, që trupi i Fan S. Nolit të prehet në gjirin e atdheut, nuk u realizua, për shkak të qëndrimit armiqësor të qeverisë reaksionare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por figura dhe vepra e Fan S. Nolit janë pronë shpirtërore e popullit shqiptar dhe vlerësimi i tyre bëhet sot më i lartë se kurrë, sepse është pjesë e asaj trashëgimie shumë të vyer, që u shërben masave punonjëse, ndërtuese të socializmit, nën udhëheqjen e urtë të Partisë së Punës të Shqipërisë.

- 
- 1 Noli F. S.: *Letër Këçon K. Priftit*, origjinali në dorën e marrësit në Rehovë.
  - 2 Noli F. S.: *Letër Këçon K. Priftit*, origjinali në dorën e marrësit në Rehovë.
  - 3 Hoxha E.: *Vepra*, vëllim 3, Tiranë, 1969, ff. 92-93.
  - 4 Noli F.S.: në «Bashkimi» 28 tetor 1945.
  - 5 Kristo A.: *Disa ditë me Nolin*, në «Drita», 21 mars 1965, f. 3.
  - 6 Noli F. S.: *Letër Alqi Kristos*, origjinali në dorën e marrësit, në Tiranë.
  - 7 Noli F.S.: *Bethoveni dhe Revolucioni Francez*, përkthyer shqip nga Alqi Kristo, në «Nëndori», Nr. 3, 1962 dhe Nr. 12, 1970. Citimet shqip bëhen nga ky përkthim.
  - 8 Noli F. S.: *Album II*, Boston, Mass. 1966, ff. 48-49.
  - 9 Luarasi S.: *Hyrje. Jeta. Koha. Vepra e Migjenit*, në *Migjeni — Veprat*, mbledhur dhe redaktuar nga Skënder Luarasi, Tiranë, NSHB, 1957, f. 51. Origjinali i letrës në dorën e marrësit, në Tiranë.
  - 10 *Pesëdhjetëvjetori i Kishës Ortodokse shqiptare në Amerikë (1908-1958)*, botuar anglisht në Boston më 1960.
  - 11 Në «Dielli», 5 korrik 1961; në *Album II*, ff. 20-27.
  - 12 Në «Dielli», 27 mars 1963; në *Album II*, ff. 29-32.
  - 13 Noli F.S.: *Letër Milto Sotir Gurrës*, në «Nëndori», Nr. 4, 1965. Origjinali i letrës në dorën e marrësit, në Tiranë.
  - 14 Noli F.S.: *Letër Milto Sotir Gurrës*, origjinali në dorën e marrësit, në Tiranë.

## KAPITULLI I TETË

### PORTRETI

Të përvijosh portretin e F. S. Nolit, sado në vija të përgjithshme, është një punë shumë e vështirë, sepse personaliteti i tij u rrit në mjedise dhe rrethana nga më të ndryshmet, në një epokë historike të gjatë prej më se tre çerek shekulli, me kthesa të mëdha për vendin tonë dhe shoqërinë njerëzore, sepse ai qe një figurë e shumanshme, që luftoi, punoi dhe krijoi në fusha nga më të larmet, sa rrallë kush tjetër në historinë e përpjekjeve atdhetare, të diturisë, të kulturës dhe të arteve tona në të kaluarën.

Fan S. Noli doli nga një mjedis, i cili ndryshon shumë prej atyre nga të cilët kanë dalë veprimtarët, dijetarët dhe artistët e tjerë shqiptarë. Ibrik-Tepe a Qyteza, fshati shqiptar që ruajti gjuhën, veshjet, doket dhe zakonet e të parëve, ushqeun te ai dashurinë ndaj trashigimisë atdhetare dhe kulturore të popullit, ndikoi në edukimin e tij shqiptar. Mjedis i fshatar i Ibrik-Tepes mbeti një përfytyrim i pashlyeshëm në kujtesën e tij, me të gjitha ato veçori të

marrëdhënjeve ekonomike dhe shoqërore feudale. me ato kundërshti që shkaktoi në familje të tij konflikti për pronën, me qëndresën shqiptare ndaj dy asimiluesve rrethues, turqve dhe grekëve. Simpatinë për punëtorët e tokës ai do ta shprehë më së një herë në veprimtarinë politike shoqërore, në krijimtarinë origjinale historike e letrare, në shqipërimet artistike. Në këtë mjedis kaloi fëmëminë dhe rininë e parë, pervehtësoi gjuhën e pasur të folur nga fshatarët e thjeshtë, mori arësimin fillor e të mesëm të përgjithshëm dhe njohuritë e para të muzikës, sendërtoi ëndrrat për të ndjekur studimet e larta, për t'u bërë «kalorës i Skënderbeut në gjirin e popullit shqiptar.»

Ky bir fshatari mërgimtar në rrethin e Adrianopojës së Turqisë u përgatit kështu të lidhet më vonë me përpjekjet e shqiptarëve të Greqisë, të Egjiptit, të Amerikës, të Rumanisë dhe të Bullgarisë për çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha shekullore turke dhe për mbrojtjen nga synimet grabitqare të shovinistëve fqinj e të fuqive të mëdha imperialiste. Në këtë rrugë përpjekjesh, pati rastin e volitshëm ose i krijoi me ngulm këto raste që të ndiqte nga afër punën e atdhetarëve, të tillë si Thanas Tashko, Jani Vruho, etj., të përfitonte nga lëvizja atdhetare dhe kulturore, që po ecte me vrull përpara në fillimet e shekullit tonë. Por, në rrugët e jetës, u ndesh që herët me vështirësi e pengesa jo të vogla, të cilat i përballoi dhe i kapërceu me ngulm, duke punuar si nëpunës tramvaji, kopist, sufler, aktor, mësues lëvizës, pjatalarës etj. Ky ngulm do ta karakterizojë atë edhe në studimet e larta, të cilat i filloi në Athinë, por që i ndërpreu për arësye ekonomike dhe i



Fan S. Noli, bust nga Janaq Paço



kreu më vonë në Universitetin Harvard në moshën tridhjetëvjeçare, — për të vazhduar më tej, në Konservatorin e Nju-Inglandit, në moshën pesëdhjetëvjeçare, duke u pajisur kështu me një kulturë të gjerë letrare dhe muzikore. Këtë ngulm do ta ketë edhe në përvehtësimin e një morie gjuhësh të huaja — turqishtes, greqishtes dhe latinishtes, inglishtes dhe frengjishtes, italishtes dhe spanjishtes, gjermanishtes dhe gjuhëve skandinave, rusishtes, hebrahishtes etj., duke u bërë kështu një poliglot i rrallë te ne. Disa prej tyre, greqishten e inglishten, i përdorte me aftësi në shkrim. Një fletore e huaj shkruante:

*«... flet një inglishte të mbaruar me një aksent pak amerikan, flet edhe frengjishten pothuaj aqë mirë»<sup>1</sup>.*

Kurse Ernest Niuman, biograf i Vagnerit, duke u ndalë te stili anglez i Nolit, thekson:

*«... Valter Pateri vështirë se do të kish mundur ta shprehte atë më mirë».<sup>2</sup>*

Në shumë vende ku vajti, nuk u shkëput kurrë nga mjedisi shqiptar: Në Greqi dhe në Egjipt, në Itali dhe në Amerikë, në Bullgari dhe në Rumani, në Austri dhe përsëri në Amerikë. Lidhjet me rrethet atdhetare shqiptare nuk i preu edhe atëhere kur vi-



zitoi vende të tjera, si Anglinë dhe Francën, Zvicrën, Bashkimin Sovjetik dhe Gjermaninë.

Në të 88 vjetët e jetës, vetëm 4 vjetë e gjysmë qëndroi në atdhe; të tjerat i kaloi nëpër dhera të huaja — u largua tetëmbëdhjetë vjeçar nga Ibrik-Tepe, shtegëtoi 6 vjet nëpër Greqi dhe Egjipt, 6 vjet të tjerë nëpër Evropë dhe qëndroi 49 vjet në ShBA. Mund të quhet, pra, i mërguar i përhershëm si asnjë tjetër në radhën e veprimtarëve, dijetarëve dhe artistëve të tjerë shqiptarë. Në të 88 vjetët e jetës, përjetoi një histori me kthesa të mëdha të popullit të vet dhe pati bashkëluftarë të shquar si Bajram Currin dhe Luigj Gurakuqin, Avni Rustemin dhe Halim Xhelon me shokë.

Në këtë periudhë të gjatë, populli ynë shënoi një përparim të madh: shporri sunduesin shekullor turk, mbrojti vendin nga synimet grabitqare të shovinistëve fqinj dhe fuqive të mëdha imperialiste, luftoi me guxim të rrallë kundër reaksionit të egër çifligaro-borgjez, zhvilloi epopenë e lavdishme të Luftës nacional-çlirimtare, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare, kundër pushtuesvet fashistë italianë e gjermanë dhe reaksionit të brendshëm të lidhur me ta, përmbysi klasat shfrytëzuese feudale dhe borgjeze, ndërtoi bazat e shoqërisë socialiste dhe i hyri me sukses revolucionit të pandërprerë socialist, duke qëndruar i paepur përballë imperializmit botëror dhe revizionizmit modern. Në vazhden e këtyre kthesave të mëdha F.S. Noli mbajti përgjithësisht anën përparimtare si atdhetar e demokrat: në lëvizjen për çlirimin e atdheut nga sunduesi turk dhe në atë për sigurimin e pavarësisë dhe të tërësisë tokësore, në revolucionin de-

mokratiko-borgjez kundër reaksionit të brendshëm çifligaro-borgjez dhe imperializmit të huaj, në përpjekjet për përmbysjen e regjimit zogist antipopullor, në denoncimin e fashizmit italian dhe të fuqive të tjera imperialiste, në përkrahjen morale të Luftës nacionalçlirimtare, të revolucionit demokratik popullor, të udhëheqësve të tij me në krye shokun Enver Hoxha. Në këtë vazhdë, ai kaloi nga periudha e Rilindjes kombëtare në atë të përpjekjeve për pavarësi dhe nga kjo në rrymën e demokracisë revolucionare, nën ndikimin e drejtëpërdrejtë të luftës së pareshtur përparimtare të popullit shqiptar. Kështu, me gjithë lëkundjet, ngurrimet, stepjet dhe gabimet e ndryshme që pati, ai çau përpara me mundimin e vet demokratik: nga pozita e përgjithshme e luftës për çlirimin prej Turqisë, kaloi në atë të luftës kundër rrymave antikombëtare — turkomanizmit dhe grekomanizmit — nga pozita e përgjithshme e luftës për sigurimin e pavarësisë dhe të tërësisë tokësore të atdheut kaloi në atë të luftës antifeudale dhe antiimperialiste, nga pozita e revolucionit demokratiko-borgjez në përgjithësi në atë të thirrjes për një kryengritje me armë «të katundarëve dhe punëtorëve», «të vegjëlisë punëtore» — te e cila mbështeti për një kohë shpresën dhe besimin kundër regjimit çifligar borgjez dhe depërtimit fashist italian në Shqipëri, nga shprehja e simpatisë për fitoret e revolucionit të parë socialist në shprehjen e përkrahjen morale të revolucionit demokratik popullor në Shqipëri. Kjo vijë ngritëse përbën thelbin e patriotizmit dhe të demokratizmit revolucionar të Fan S. Nolit. Por kjo vijë ngritëse nuk u arrit pa zigzage të ndryshme.

Në botëkuptimin e tij filozofik dhe, disa herë, në veprimtarinë e tij jetësore, kulti i mbinjeriut i Fridrih Niçes ushtroi një ndikim, që u shpreh, më 1907, kur Noli nuk e mbështeti besimin për çlirim nga Turqia te populli, por te bajraktarët dhe — «ballarët», ndikim që u shpreh edhe në ndonjë rast tjetër, deri edhe pas vitit 1924, kur ai, në interpretimin që u bëri shkaqeve të thyerjes së Revolucionit të qershorit, mbiçmoi «heroin» dhe nënvleftësoi masat. Ndërsa denoncoi, në përgjithësi, imperializmin ndërkombëtar dhe veglën e tij, Lidhjen e Kombeve, shprehu adhurimin për ish — presidentin e ShBA, V. Vilsonin, dhe «demokracinë parlamentare» anglo-saksone. Ndërsa ju vu rrugës revolucionare për «*çrrënjosjen e feudalizmit*» u tregua i butë ndaj armiqve të revolucionit demokratik borgjez, që gjetën strehë për t'u ngritur në kundërrevolucion, nuk u mbështet sa duhet në demokratët radikalë e revolucionarë dhe në masat e popullit, për të përdorur dhunën revolucionare.

Për një periudhë të caktuar, sidomos në vitet 30-të, pak kohë pas nguljes përfundimtare në ShBA, pati edhe lëkundje të tilla nga vija konsekuente, që e shpunë në rënje politike e morale, në pozita pajtimi me kundërshtarët e dikurshëm politikë, në kërkim për të siguruar një vend si peshkop dhe mitropolit. Në fillim, njëzetegjashtëvjeçar, duke u nisur nga konsiderata politike të kohës, u dorëzua prift, ndonëse nuk kishte bindje të mirëfillta fetare, dhe luajti një rol të dukshëm kundër reaksionit grek, por, më vonë, kur u largua nga betejat politike ruajti ofiqet e larta kishëtare, ndonëse shërbesat e kësaj

natyre i pañ quajtur shpesh, «punë të mërziqme të priftërisë».

Lëkundjet, ngurrimet, stepjet dhe gabimet e ndryshme spjegohen nga ndikimet që ushtroi te ai ideologjia sunduese e klasave shfrytëzuese në fuqi në mjediset kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos në vendet borgjeze ku jetoi, shpjegohen nga të metat në karakterin e tij, në formimin ideologjik dhe kulturor, në qënjen e tij për një kohë shumë të gjatë larg luftës për jetë të masave të popullit.

Me gjithë kalimin në demokracinë revolucionare, Fan S. Noli nuk arriti të botëkuptimi shkencor materialist, nuk e njohu në thelb luftën e klasave, as në shkallë kombëtare as në shkallë ndërkombëtare. Këto të meta dhe kontradikta, gjetën shprehje, si do ta shohim më tutje, edhe në veprat e tija diturake e artistike. Por këto nuk e mbulojnë vlerën e madhe që ka Fan S. Noli si atdhetar, dijetar dhe artist.

Me energji të rralla luftoi dhe krijoi ai, qysh në moshë të re, në aq shumë fusha, sa asnjë tjetër përpara tij. Te ai ne kemi poetin dhe prozatorin, fletorarin dhe gojëtarin, dramaturgun dhe shqipëruetin, historianin dhe mendimtarin letrar, kompozitorin dhe muzikologun. Dhe në të gjitha këto fusha la gjurmë të thella: u gërshetua artisti me dijetarin, njohja e tij enciklopedike me shijen e tij të hollë, mjeshtri i fjalës me atë të tingullit, mendimi i tij i thellë me ndjenjën e tij të ngrohtë, sulmi i vrullshëm me satirën në të gjitha shkallëzimet e saj të humorit, ironisë dhe sarkazmës.

E përhapur në shumë vëllime dhe në aq më shumë fletore dhe të përkohshme, krijimtaria e tij, e njohur nën emrin e plotë ose me pseudonimet Theo-

fan Mavromati, Ali Baba Qyteza, ABC, Rushit Bilbil Gramshi, Bajram Domosdova, Robo Rogozhina, Namik Namazi, etj., nuk mund të rrokot lehtë në një punim si ky, që merret me jetën dhe veprimtarinë e tij. Po ndalemi vetëm në veçoritë e saj kryesore.

Poezia e Fan S. Nolit është një poezi politike dhe shoqërore, që trajton, në mënyrë të veçantë, temën e Revolucionit të qershorit 1924. Si e tillë, ajo çon më tej trashëgiminë më përparimtare të poezisë së Rilindjes kombëtare, sidomos në pasqyrimin realist të shoqërisë, në frymën demokratike dhe në thirrjet për një të ardhme më të mirë të masave punëtore dhe fshatare. Në këtë drejtim, ajo është një poezi novatore për kohën e vet, e frymëzuar nga mendime dhe ideale, që do ta shpinin më përpara shoqërinë shqiptare, për t'u çliruar nga shtypja dhe shfrytëzimi feudalo-borgjez. Përfytyrimi i masës së vegjëlisë punëtore, që kishte nisur të shfaqej në letërsinë shqipe përparimtare të viteve të fundit të Rilindjes, në poezinë e Fan S. Nolit del më e përcaktuar — punëtorë e fshatarë. Disa elemente autobiografikë të kësaj poezie janë shkrirë me rrethanat konkrete historike dhe kanë vlerë njohëse, jo vetëm për autorin, por edhe për ngjarje, që ndodhin rreth tij. Shprehja e tij poetike karakterizohet përgjithësisht nga një mendim i ngjeshur, sintezë, me intonime liriko-epike, nga një duf i brendshëm, që shpërthen me sulm në ritme kumbuese, stentoriane, luftarake, realizuar me aliteracione origjinale, nga një arkitekturë simetrike në përmasa vargjesh. Në poezinë e Fan S. Nolit mbizotërojnë vargje ku mendimi e ndjen veten të lirë dhe fjala e ndjen veten në vendin e vet. Në kohën e mërgimit politik, pas

vitit 1924, ai erdhi në kontakt me ide socialiste, të cilat lanë gjurmë sidomos në poezinë *Rent, or Marathonak!* dhe *Anës lumejve*, ku realizmi arrin të gërshetohet me një romantizëm shumë optimist. Megjithëse ndoqi modele klasike të poezisë së shkruar, ai ka një ndikim të fortë nga poezia gojore e popullit, sidomos në vargjet satirike dhe, pjesërisht, në ato elegjiake. Duke përgjithësuar figura popullore, poeti arriti të krijojë vargje me një forcë të veçantë shprehëse. Me artin e portretizimit, vizatoi profile të gjalla të patriotëve dhe të përfaqësuesve të kampit kundërshtar. Zakonisht, thelbin e njeriut që vizaton, poeti e nxjerr në pah përmes ndonjë veçorie themelore të fizionomisë politike dhe të karakterit. Poezia politike e Fan S. Nolit është një model i përdorimit me mjeshtëri të figurave, të fjalëve dhe të mendimit. Mjetet më të preferuara janë: epiteti, antiteza, alegoria dhe aliteracioni. Me vargjet e veta, ai solli një ndihmëse të njohur në metrikën dhe në prozodinë shqiptare. Në to gjejmë larmi masash, strofash dhe rimash. Në pikëpamje të harmonisë, ai është një shembull i kadencës dhe i përpjesëtimeve, sepse njeh masën dhe përpikmërinë. Diçka e re në vargun shqip është trembëdhjetërokëshi, që ai e solli i pari te ne sipas tipit aleksandrin, kur të tjerët e dhanë me shtatërokësh të dyzuar. Në kadencën ritmike, mbajti ritmin klasik, por, kur ja deshi puna e theu në dobi të shprehjes më të qartë të mendimit. Kështu, trajta figurative është e lidhur në mënyrë organike me përmbajtjen, ashtu si theksi gjuhësor me atë melodik. Duke u nisur nga këto anë pozitive të poezisë noliane, janë shfaqur vlerësime të tilla:

«Pak poetë gjen që të kenë atë forcën sugjestiononjëse të vargjeve noliane, atë harmonizim të mrekullueshëm të mendimit, të ndjenjës e të formës së jashtme të shfaqjes së tyre, atë pajtim të kuptimit e të tingullit të fjalës, atë nënshtrim të bukur të mjeteve teknike të vargëzimit e të stilistikës poetike ndaj qëllimit e kuptimit të vjershës. Ka shkrimtarë që shkruajnë shumë e thonë pak. Noli ishte prej atyre, që shkruajnë pak e thonë shumë dhe këtë veçori të tij do të ishte shumë e dobishme ta përmendim e ta kemi parasysh gjithnjë»<sup>3</sup>.

«Fan S. Noli, për ne poetët e rinj, mbetet një ndër mësonjësit e mëdhenj të vargut. Ai na thotë se fjala në varg duhet të jetë e tillë që askush të mos guxojë ta lëvizë nga vendi»<sup>4</sup>.

«Ai ishte një marathonomak i madh, që vërtitej e vraponte gjithmonë drejt atdheut... Nuk arriti dot vetë. Na la shumë gjëra, por, mbi të gjitha, një radhë poezish, një duzinë perlash të ndritura, që i vari me kujdes e madhështi në gjerdanin e paçmuar të poezisë shqipe»<sup>5</sup>.

Megjithatë, në ndonjë vjershë të tij ka edhe mendime me të cilat nuk mund të pajtohemi, si p.sh. mbizotërimi i «heroit» dhe i rolit të vetëvetes në ngjarjet historike; ka alegori, që arrin në simbole biblike, himnizime me efekte të rënda akustike. Kur mbizotëron alegoria biblike, vjersha merr karakter simbolik, subjektiv dhe, herë-herë, intelektual, që e largon nga fryma popullore. Kjo alegori biblike shpesh e kufizon poetin të shprehet drejtpërdrejt, qartë dhe hapët, ashtu siç shprehet ai, p.sh., në *Anës lumejve*. Poezinë e Nolit e rëndojnë edhe fjalët e huaja, të cilat,

pjesërisht, mund edhe të zëvendësoheshin me fjalë shqipe.

Vlerë të madhe artistike ka edhe proza e tij, e cila paraqitet në lloje të ndryshme: në publicistikë dhe në mbresa udhëtimi, në tregimin historik dhe në letrat. Ndërtimi i frazës është shumë i përpiktë. Shprehja e hijshme e mendimit nuk arrihet me sfor-cime dhe artifice, por, në rrjedhshmëri të harmoni-shme, me një gjallëri dhe forcë të madhe të frazës. Në prozën tregimtare Fan S. Noli është një nga stilistët më të shquar.

*«Fjala shqipe e tij... duke u kalitur në kudh-rën e luftës për liri dhe demokraci, mori tinguj nga tërmetet që lëkundën shoqërinë e nga vringëlli-mat e shpatave. Po dhe nga burimet e kroit, nga fër-fëllimet e erërave. Në të shpalosi fletën flamuri kuq e zi dhe zhgaba apo u hodhën në sulme ushtritë e Skënderbeut...»*<sup>6</sup>

*«Në fushën e kësaj literature ai nuk është një fill bar, që sot bleron dhe nesër veshket. Ai na paraqitet si një lis i moçëm e plot gëdhenj, lis i vetëmuar, po me rrënjë ngulur mirë në thellat e dheut. E këtillë mbetet edhe gjuha e tij. Në këtë nuk ndihet ëmbël-sia e flladit të verës se sa furia e murrërit të dimrit. Ajo nuk ka aromën e luleve, po ka erën e shëndoshë të dheut».*<sup>7</sup>

Por për stilin e tij në prozë nuk mund të flitet po s'u muar parasysh edhe pjesa tjetër e krijimtarisë së tij. Prandaj me të drejtë është thënë:

*«Përpunues me talent i gjuhës poetike, ai u tre-gua po ashtu stilist i fuqishëm në prozë. «Historia e Skënderbeut» e tij mbetet model i rrallë i përpunimit të periudhës shqipe.»*<sup>8</sup>



Dhe është vërejt se bazën e këtij stili e përbëjnë demokratizmi e fryma popullore:

*«Demokratizmi i Nolit, përveç të tjerave, duket është në gjuhën e tij të gjallë, që merr frymë me kraharorin e gjërë popullor. Ajo vjen si një lumë që kalon ku me rrëmbim e ku qetë, po gjithmonë me madhësti»<sup>9</sup>.*

Stili i tij në prozë dëshmon për një gatishmëri të madhe shpirtërore, e cila shprehet në mënyrë të veçantë në gojëtarin.

*«Fjalimet e tij — dëshmonte bashkëpunëtori i tij në një kohë, Sotir Peci — janë nga ato që nuk përmblihen, po zgjerohen»<sup>10</sup>.*

Fjala e tij prej agitatori patriot dhe mendimtari demokrat është shprehje jo vetëm e gatishmërisë shpirtërore, por edhe e diturisë së gjërë, e humorit të hollë dhe e satirës së mprehtë.

Ndërhyrjet e shpeshta me replika të forta, drejtuar kundërshtarëve politikë, për të mbrojtur çështjen e demokracisë, në parlamentin shqiptar të kohës, ligjëratat e fuqishme që mbajti para shqiptarëve të mërguar në Amerikë, në Bullgari dhe në Rumani, para popullit të Korçës, të Gjirokastrës dhe të Vlorës, si edhe ato që mbajti në Lidhjen e Kombeve, e tregojnë gojëtarin të dorës së parë dhe përbëjnë një thesar të çmueshëm në gojëtarinë shqiptare.

*«Fjala e tij kaq spontane dhe kaq e lidhur, rrëmbenjëse sidomos, bëri të shtangin si njerëzit pa opingë ashtu edhe dhelpërat e diplomacisë.»<sup>11</sup>*

Ata, që e kanë dëgjuar të fliste, thonë se ai të bënte menjëherë për vete, tash duke të lënduar, tash duke të dhënë zemër, herë duke të nxitë të qeshësh me gjithë shpirt, herë duke të pikëlluar deri në lo-

të. Duke u tallë me injorancën e atyre, që nuk e dinin se ku bie Shqipëria, Fan S. Noli e filloi fjalimin kështu:

«Në Detroit (qytet i madh i Amerikës së Veriut), një zonjë më bëri këtë pyetje:

— Ku bie Shqipëria?

— Buzë Adriatikut — i thashë.

— Po Adriatiku ku ndodhet? — përsërit pyetësja.

— Midis Ballkanit dhe Italisë, në Detin Mesdhe — vazhdova.

— Po Deti Mesdhe, ku shtrihet? — më pyet përsëri pa gjë të keqe.

— Ky det, zonjë shtrihet midis Evropës dhe Afrikës, dy kontinenteve që i ndan prej Amerikës Oqeani Atlantik, të cilin besoj, se e dini ku bie.

Zonja u kënaq sa dhe unë»<sup>12</sup>.

Ligjërata e tij në Lidhjen e Kombeve bëri një përshtypje të madhe. Një fletore e huaj shkruante:

«...Fan Noli i Shqipërisë i bëri delegatët e Lidhjes së Kombeve të mbeten me gojë hapur, kur u mbajti një nga fjalët, që bënë më tepër bujë dhe, pa dyshim, fjalën më piktoreske në sesion të Kuvendit»<sup>13</sup>.

Dhe, prap, një fletore tjetër e huaj shtonte:

«...një bisedonjës i gatshëm dhe i squar, ai bëri që në krye një nështypje të madhe në Gjenevë... po fliste gjithë aqë mirë për meritat respektive të Gustave Flaberit dhe Anatol Fransit»<sup>14</sup>.

I njëjti stil energjik duket edhe në dramën e tij, në artikujt publicistikë, në mbresat e udhëtimit dhe në letrat. Më i vetëvetishëm në gojëtar, më komunikativ në mbresat e udhëtimit dhe në letrat, më

i skalitur në dramë dhe në artikuj publicistikë, por kudo i gjallë, i zhdërvjellët dhe i hapët, kudo duket dora e një mjeshtri të fjalës.

Kjo dorë artisti duket gjithashtu në shqipërimet më të realizuara, të cilat luajtën një rol të njohur për zhvillimin e letërsisë dhe të kulturës kombëtare në përgjithësi, në kuptimin që universalja përparimtare i shërben kombëtares, ashtu si kombëtarja përparimtare e plotëson universalen. I pajisur me një kulturë të gjerë, njohës i mirë i gjuhës amëtare dhe i shumë gjuhëve klasike e moderne, ai e punoi vargun e përkthimeve artistike, duke u bërë të njohura masave lexuese disa nga veprat me rëndësi të letërsisë botërore. Përgjithësisht diti të zgjedhë vepra të tilla, që kishin vlerë aktuale dhe luanin rol pozitiv në edukimin politik dhe estetik të popullit në atë kohë, si p.sh. romanin «Don Kishoti i Mançes» të Miguel de Servantesit, ku u bëhet një parodi zakoneve të zvetënuara të aristokracisë, romanin «Kasollja» të Vicente Blasko Ibanjezit, ku tregohet shpirti i revoltuar i punëtorëve të tokës kundër shtypjes feudale, «Rubaitë» e Omar Khajamit, ku fshikullohet fanatizmi fetar oriental, etj. Një vend shumë të rëndësishëm në fondin e shqipërimeve të Fan S. Nolit zënë veprat, që trajtojnë problemin e tokës dhe të fshatarësisë. Ai përktheu në shumë gjini: në poezi në prozë dhe në dramaturgji, — lirika dhe poema, novela dhe romane, komedi, drama dhe tragjedi. Dhe, kudo, dha shembullin e një shqipëruesi profesionist. Por, në një masë më të madhe, përktheu vepra për skenën, tragjedi të Shekspir, komedi të Moljerit, drama të Ibsenit, me qëllim

që, me anë të fjalës në skenë, të komunikonte më mirë me masat.

«... megjithëse talenti i madh i Nolit u prir në drejtime të tjera, zemra e tij vazhdoi të rrihte vazhdimisht për artin e teatrit. Në kohën tragjike, kur në Shqipëri triumfonte errësira dhe shpallej mbret një despot i vogël injorant, dëshirën e zjarrtë për të krijuar drama, Noli e zëvendësoi me shqipërimin e kryeveprave shekspiriane. Hamleti, Bruti, Makbethi, duke folur shqip, i grisën maskën një regjimi jo më pak të egër se ai i Klaudeve, Pollonëve, Makbethëve, Jagove, Cezarëve». <sup>15</sup>.

Dhe, me të drejtë, thuhet se Fan S. Noli:

«Shekspirin, Servantesin, Ibsenin, Poen, Langfellowin i bëri të flasin shqip. Dhe jo në një shqipe si do kudo» <sup>16</sup>.

Disa nga shqipërimet i mori në dorë më se një herë dhe i përpunoi me pasion të madh. Shqipërimet e tija janë, në një farë shkalle, rikrijime. Pa ju larguar origjinalit në idenë dhe forcën shprehëse, ai shfrytëzon mjetet e pasura përfytyruese të gjuhës amëtare dhe e rijep atë në frymën shqipe, aq sa të duket se nuk ke të bësh me një vepër të huaj, por me një vepër thjesht të vendit. Në këtë drejtim, bëri një punë prej artisti të vërtetë. Në radhë të parë, për t'u përmend si shqipërime mjeshtërore janë: tragjeditë e Shekspirit, Rubaitë e Khajamit etj. Këto të fundit, ashtu si Norbert Jokli, i çmuan lart edhe eruditë të tjerë të huaj, si, p.sh., A. Rappaporti:

«Si zor, sipas mendimit tim, që rubairat e Omar Khajamit në persisht të jenë më të mira se ato të Fan Nolit në shqip» <sup>17</sup>.

Në përkthime ndoqi edhe rrugën e përshtatjes

dhe të shkurtimit, duke u nisur nga konsiderata të caktuara letrare, për të cilat ishte plotësisht i ndërgjegjshëm, sikurse e shpjegon vetë me një shënim që bën te hyrja në «Don Kishotin e Mançes:»

«Pjesa e parë e Don Kishotit u përmbloodh në pesë vëllime e jo në gjastë, siç e bënja hesap në krye nga shkaku i disa shkurtimeve që kam bërë. Për shebull lashë jashtë pothua gjithë vjershat, se vlera e tyre nuk m'u duk shumë e lartër, dhe përktheva vetëm tri prej këtyre, që kanë një farë lezeti. Gjithash-tu lashë jashtë një kritikë të gjatë që bën prifti mbi artin dramatik të Spanjës, se kjo është interesante për studentët e specializuar të letaturës spanjolle, po fare e mërzitur për këndonjësit profanë. Shkurtimet e tjera janë bërë në novelat e interkaluara dhe në episodet e dorës së dytë. Më vjen keq që nuk bëra kësajsoj shkurtime që në krye, po që nga mezi i këtij».

Në shqipërimet e veta, ashtu si dhe në krijimet origjinale, ai ka shkrirë diçka të vetëvetes, të stilit të vet.

«Në këtë vështrim, edhe shqipërimet, në një kuptim më të thellë, janë krijime të tij»<sup>18</sup>.

Shqipërimet e tij më të realizuara artistike sollën një ndihmë të dukshme në zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës letrare.

«Për kulturën e vendit tonë, për Shqipërinë e prapambetur, e cila, megjithëse trashëgonte një thesar të çmuar, sidomos poetik, kishte një zhvillim të paktë, — përkthimet e veprave të mëdha botërore nga Noli kanë një vlerë të veçantë: ato e çuan përpara gjuhën letrare shqipe, duke e veshur me forcën e mendimit, të ndjenjës së stërholluar, të humorit dhe të satirës së mprehtë»<sup>19</sup>.

Por jo të gjitha shqipërimet e Fan S. Nolit janë të një niveli artistik dhe jo të gjitha sjellin interes për edukimin shoqëror. Krahas përkthimeve fetare, fragmenteve nga vepra. «Ashtu foli Zarathustra» e filozofit reaksionar gjerman të kultit të mbinjeriut Fridrih Niçes, për masat lexuese nuk kanë vlerë edukative as disa vjersha idealiste, mistike dhe simboliste të dashurisë së brengosur, siç janë «Korbi» dhe «Annabel Lee» të E.A. Poes, si dhe ato të Sh. Bodlerit, P. Verlenit dhe të F.J. Tjutçevit, që, përgjithësisht, i përkasin një rryme letrare borgjeze dekadente.

Puna me shqipërimet nuk mund të merret e shkëputur jo vetëm nga puna e tij prej artisti, por edhe nga ajo prej dietari. Si dietar ai dha në tri fusha kryesore; në fushën e studimit dhe të mendimit kritik letrar, në atë të studimit dhe të mendimit historik, në atë të studimit dhe të mendimit muzikor.

Studimin dhe mendimin kritik i lavroi me qëllim që veprat e shqipëruara t'i bënte të njohura në masat e lexuesve, duke nxjerrë vlerat e tyre njohëse, edukuese historike dhe aktuale. Përmes «introdukteve» ai përhapi pikëpamje mjaft të përparuara në lidhje me brendinë dhe shtjellimin artistik të veprave. Gjykime interesante dha rreth tragjeditive të Shekspirit, të cilat janë objekt, interpretimesh të ndryshme. Natyrisht, gjykimet e tij nuk janë gjithnjë origjinale, por përpjekjet e tija janë për t'u çmuar, sidomos po të mendohet se, në këtë fushë, ai çau rrugë ndër të parët të ne. Nganjëherë në këto introdukte Nolin e shohim të ndikuar nga materializmi historik dhe bile nga ide socialiste, por pa arritur në botëkuptim të plotë materialist shkencor. Ai çmon ro-

lin e letërsisë artistike në zhvillimin e shoqërisë, ndikimin që ushtron letërsia që pasqyron realitetin mbi masat, lidh jetën, e autorit me veprën dhe veprën me epokën, bën lokalizimin dhe aktualizimin, por nuk arrin të nxjerrë plotësisht rrënjët klasore të fenomeneve në mekanizmin e ndërlikuar të kontradiktave, që përftohen në luftën e klasave. Një interpretim mjaft të goditur për realitetin shqiptar të kohës i bëri romanit «Don Kishoti i Mançes.» Një portretizim mjaft të goditur u bëri disa personazheve kontradiktore të Shekspirit, karakterizimi i të cilëve bëhet nëpërmjet argumentash të mprehtë. Në përgjithësi, duke marrë anët më pozitive të këtyre «introdukteve», kemi të bëjmë me një kontribut të dukshëm në lëvizjen tonë mendore demokratike, në vitet 20-të dhe 30-të të këtij shekulli, sepse ato përmbajnë ide të mbështetura në rrymën përparimtare të kritikës letrare të kohës përse i përket trashëgimit të së kaluarës nga letërsia botërore. Një vlerë për t'u çmuar ka edhe stili mjeshëtor me të cilin janë thurur këto «introdukta», me deduksione logjike, kontraste dhe sinteza mjaft origjinale. Kjo punë e tij prej dijetari në fushën e studimit dhe të mendimit kritik letrar lidhet me punën e tij në fushën e studimit dhe të mendimit historik e muzikor dhe, mbi të gjitha, me ideologjinë që e udhëhoqi në krijimtarinë letrare, e cila, me gjithë zigzaget që pati, erdhi duke u rritur në vijën e vet demokratike. Prandaj me të drejtë është thënë:

*«Ai përfaqëson për ne mishërimin e idealeve të Rilindjes, por në një plan më të lartë tashmë. F. S. Noli i zhvilloi më tej, në mënyrë revolucionare, elementet demokratikë në mendimin e veprimtarinë e Rilindjes.»*

dasve tanë dhe arriti deri në atë kthesë vendimtare për gjithë historinë tonë: në kuptimin se liria dhe pavarësia kombëtare, përparimi kultural dhe shoqëror nuk do të fitoheshin e mbroheshin, po të mos bëheshin çështje të «katundarit e punëtorit», të «milletit», po të mos lidheshin me çështjen e madhe të çlirimit të popullit punonjës në të gjithë botën dhe me luftën antiimperialiste.<sup>20</sup>

Kjo vijë ngritëse e mendimit të tij si dijetar duket edhe në veprat e tija shkencore, në «Historinë e Skënderbeut» dhe në Bethoveni dhe Revolucioni francez.» Te «Historia e Skënderbeut», në variantin e parë, «kryetrimi është thuarjse një gjysmë-përrëndi, që zbret në gjirin e popullit», në variantin e dytë «është populli ai që i fal fuqitë e tij të pashtershme kryetrimin», kurse tek «Bethoveni dhe Revolucioni francez», në mënyrë të thellë e bindëse, «lidhet gjeniu i muzikës me revolucionin e madh freng»<sup>21</sup>.

Pa dyshim, në vijën ngritëse të mendimit të tij, gjetën shprehje edhe gabimet e tij, si pasojë e ndikimit të ideologjisë sunduese borgjeze. Pikërisht në variantin e dytë shqip të «Historisë së Skënderbeut», duke dashur ta paraqitë kryetrimin sa më të lidhur me masat, por duke mos e vendosë në pozitën e tij klasore, e identifikon me fshatarësinë.

«Nuk ka nevojë që ne të fshehim karakterin klasor të sundimit të heroit tonë, për të vënë në dukje meritat e tij konkrete, siç e quajti të nevojshme ta bënte F. S. Noli»<sup>22</sup>.

Për më tepër, në variantin anglisht të veprës, ai nuk e interpreton drejt nga ana historike qëndrimin e Vatikanit ndaj Skënderbeut. Megjithatë, ne vlerë-



sojmë punën e madhe që Fan S. Noli ka bërë, si dijetar dhe si artist, për popullarizimin e fytyrës së Gjergj Kastriotit në krye të epopesë së popullit shqiptar të shekullit XV. Fytyra dhe epoka e kryetrimtimit Skënderbe zu një vend të posaçëm në krijimtarinë artistike dhe shkencore të Fan S. Nolit, që nga ligjërata e vitit 1908 deri te kompozimi muzikor, që nga shqipërimi i poemës së Longfellowit deri te hartimi i historisë në tri variantet, që nga zotimi për t'u bërë «kalorës i Skënderbeut në gjirin e popullit shqiptar» deri te interesimi i vazhdueshëm që të përjetësohet fytyra e heroit me të gjitha mjetet artistike dhe shkencore në parafytyrën e brezave të sotëm brenda dhe jashtë atdheut.

Portreti i Fan S. Nolit nuk do të dilte i plotë po të mos merrej parasysh edhe krijimtaria e tij si kompozitor dhe muzikolog «*Fan S. Nolit, për t'u shprehur, nuk i mjaftoi fuqia poetike e vargut dhe e fjalës së tij: ai i shtoi asaj edhe forcën tjetër, atë të tingullit muzikor, duke i dhënë kështu mendimit të tij forcë akoma më të madhe, forcë të dyfishtë*»<sup>23</sup>.

Dëshmojnë se ai jo vetëm i binte flautit dhe ishte i ditur në muzikë, por se kishte zotësinë e rrallë edhe të stërviste të tjerët në këtë fushë, dhe t'i stërviste në pak kohë. Interes sjell krijimtaria origjinale muzikore që la në dorëshkrim, gjuha dhe motivet që përdori, harmonia dhe elementet e tjera të shprehjes, sidomos në veprën kushtuar Skënderbeut. Njohja dhe lavrimi i këtij arti e ndihmoi atë edhe në përpunimin e stilit letrar, te i cili, siç u tha më sipër, gjejmë një ritëm dhe rrjedhshmëri, një përputhje të theksit gjuhësor me atë melodik, një harmoni të brendshme që e krijon vetëm një poet i pajisur me

talentin e kompozitorit. Në studimin «*F. S. Noli kompozitor dhe muzikolog*»<sup>24</sup> R. Sokoli shënon me të drejtë se për cilësitë narrative dhe deskriptive, që vrehen në poemën sinfonike «*Skënderbeg*», gjithashtu për disa elemente arkaike (ndoshta të kërkuara qëllimisht), që vrehen në strukturën e joneve, në harmoninë dhe në kontrapunktin linear, së fundi për lirizmin, që përshkon veprat orkestrale të ndërtruara në blloqe pa trajta të përcaktuara, mund të thuhet se muzika noliiane origjinale anon drejt neoromantizmit. Kompozitori nuk e përfillte muzikën si kombinim thjeshtë tingujsh, por si mjet për të shprehur ndjenja të fuqishme dhe mendime të thella. «*Duke u mbështetur në faktorët më substanciozë të muzikës (ritëm, melodi, harmoni dhe kontrapunkt, të shtjelluar në trajta të lira, si të thuash rapsodike të muzikës së Nolit)*, — vazhdon studjuesi, — *Noli u përpoq të shprehej sa më qartë e kuptueshëm, pa ngatërresa teknike të tepërta*». Dhe, së fundi, ai arrin në përfundimin se Noli si kompozitor s'u pajtua me asgjësimin e tonalitetit, po u mbështet te parimet tonalo-modale të liturgjisë dhe të muzikës popullore, pa u shképutur nga harmonia tradicionale e shkollës.

Vepër e madhe e tij prej dijetari në fushën e muzikologjisë mbetet studimi kritik inglisht «*Bethoveni dhe Revolucioni francez*».

«*Me këtë vepër serioze shkencore, të studjuar dhe të argumentuar më së miri, Fan S. Noli tashmë hyri në historinë botërore të muzikës si muzikolog i shquar*»<sup>25</sup>.

Meritë e veçantë e Fan S. Nolit në këtë vepër nuk është vetëm lidhja e krijimtarisë së kompozitorit të njohur me Revolucionin francez, sepse këtë

janë përpjekë ta bëjnë edhe të tjerë përpara tij, veçanërisht Romen Rolandi, por zbulimi i shumë kontradiktave në jetën dhe në krijimtarinë e kompozitorit, dallimi i asaj që është përparimtare nga ajo që është reaksionare në veprat e tija, kuptimi i përbashkët i njeriut dhe i artistit, vendosja e artistit në epokën dhe aktualitetin e tij.

Kjo vepër u çmua lart nga artistë, dijetarë dhe kritikë muzikorë të njohur. Kompozitori Jan Sibelius i shkruante Fan S. Nolit :

*«E lexova librin me një interes shumë të madh. Mendoja se dija gjithçka rreth Bethovenit, por në librin tuaj kish gjëra që qenë të reja për mua»*<sup>26</sup>

Zhorzh Bernard Shou, siç e pamë më sipër, e çuajti autorin kritik dhe biograf të kategorisë së parë, pasi e lexoi veprën me vëmendje dhe kënaqësi jash-tëzakonisht të madhe.<sup>27</sup>

Shkrimtari Thomas Man e çmoi veprën si një kontribut real në literaturën rreth kompozitorit:

*«E lexova librin tuaj me interes dhe i mahnitur. Ai është kontribut real rreth Bethovenit»*<sup>28</sup>


Të tjerë panë te vepra në fjalë vlera nga më të ndryshmet:

*«Ju, pa dyshim, keni bërë një punë të mirë dhe të gjithë studjonjësit e revolucionit freng do t'ju a dinë për nder»*<sup>29</sup>.

*«Kam mbetur i mahnitur nga paraqitja që i bëni një çështjeje kaq të vështirë dhe tepër i kënaqur nga që ju ka lejuar ta nxirrni si të gjallë njeriun, me gjithë forcën dhe vojtjet e tij, nga thatësia e teksteve dhe nga zbukurimet e biografive. Ka qenë diçka e këndëshme për mua të shijoj mendjemprehtësinë tuaj dhe të marr me mend shkëlqimin e syve tuaj*



Fan S. Noli, bust nga Dh. Çami



*gjatë leximit të disa nga pjesët më të këndëshme»<sup>30</sup>.*

*«E kam lexuar fjalë për fjalë librin tuaj, duke e gjetur atë jo vetëm bindës, por edhe gëzimdhënës. Urime për këtë vepër të mrekullueshme!»<sup>31</sup>.*

*«Jam impresionuar tmerrësisht nga vëllimi i madh i kërkimeve që e di se ju është dashur të bëni përpara se ta shkruani këtë vëllim të vogël. Njerëzit, që nuk janë marrë ndonjëherë me këtë, si zor se do të mund ta marrin dot me mend se çfarë është derdhur në këto kërkime. Ju keni shfletuar, me një durim të madh, vëllime të shumta gjermanisht, duke u përpjekur ta shpëtoni Bethovenin nga qëllimet e mira të admiratorëve të tij si edhe nga poshtërsia e armiqve të tij»<sup>32</sup>.*


Së fundi, nuk mund të plotësohet portreti i Fan S. Nolit pa nxjerrë në pah kontributin e tij në gjuhën letrare.

Më sipër u fol për stilin e tij poetik dhe për gjuhën më të cilën ai e ka ndërtuar. Noli qëndroi vetëm katër vjet e gjysmë në Shqipëri, por gjuhën e fitoi dhe e mbajti të gjallë nga burime të ndryshme: nga mjedisi fshatar shqiptar i mërgimit në Ibrik-Tepe, nga mjedisi i njerëzve të thjeshtë punëtorë e fshatarë të mërguar nëpër vende të ndryshme të botës, nga trashëgimia e gjuhës së shkruar shqipe para tij. Mund të thuhet se, në kushtet e reja të shkrimit shqip, ai eci në vazhden e toskërishtes së pasur, të pastër dhe të bukur letrare, të Naimit dhe të Samiut, pasi edhe e folmja e prejardhur nga Qyteza e Kolonjës ruante disa tipare të përbashkëta me dangëllishten. Por e pasuroi më tej gjuhën e shkruar, mbi bazën e gjuhës së folur, duke e përpunuar e duke e bërë më të shkathët, më shprehëse, të aftë për të ri-

dhënë edhe kryevepra të letërsisë botërore.


Para Fan S. Nolit dolën shumë probleme gjuhësore, sidomos në punën me përkthimet. Për t'ju përgjegjë kërkesave të ndryshme të shprehjes gjuhësore, ai e pasuroi fjalorin me fjalë të reja, me anë të mjeteve të brendshme, — duke krijuar të tjera me ato ekzistuese, — dhe me anë të mjeteve të jashtme, — duke marrë hua nga gjuhë të ndryshme kryesisht neolatine. Sajimin e fjalëve e bëri veçanërisht me anën e derivateve. Por, për nevojat e shprehjes së mendimit, futi në përdorim një varg fjalësh të huaja, të cilat, pranë atyre amëtare, kuptohen pa shumë vështirësi, ndonëse, me një punë më këmbëngulëse, mund t'i zëvendësonte, në pjesën më të madhe, me përgjegjëset e tyre shqipe. Disa fjalëve të huaja diti t'u japë një veshje dhe frymë të shqipes aq sa të tingëllojnë si pjesë të fondit kombëtar. Duke theksuar trashëgiminë gjuhësore që na la, me të drejtë është thënë: «*Ai e tëharri shqipen letrare të variantit jugor, të përpunuar prej Rilindasve të mëdhenj të shekullit të kaluar, nga elementë e tipare arkaike e ngushtësisht dialektore, nga variante të shumta morfologjike, i dha asaj një karakter më të përgjithshëm, më të njëzuar, më të stabilizuar, dhe e bëri më të lakueshme e më të kristalizuar. Ai është, përveç kësaj, ndër pasuruesit më të shquar e më dorëmbarë të visarit leksikor të gjuhës sonë letrare e të mjeteve shprehëse të saj. . . Ai farkoi sa e sa neologjizma, u dha formë shqipe shumë fjalëve të huaja, sajoi kombinime të ndryshme fjalësh me një ndjenjë të hollë të natyrës së gjuhës sonë e, sidomos, me një shije të rrallë artistike*»<sup>33</sup>.

Si i tillë, ai mbetet një nga ata mjeshtra, që i



Fan S, Noli, bust nga Dh. Çami





dhanë tonin shkrimit shqip në periudhën e viteve pas Rilindjes, në gjysmën e parë të shekullit tonë

Te Fan S. Noli ne shohim njeriun, patriotin, dijetarin dhe artistin, të rritur nëpërmjet përpjekjeve të mëdha kundër vështirësive dhe pengesave në rrugën e gjatë të jetës, kundër reaksionit çifligaro-borgjez, brenda vendit, dhe kundër imperializmit ndërkombëtar. E deshi popullin dhe atdheun me zjarrin e zemrës së një patrioti demokrat revolucionar. Atyre u kushtoi jetën dhe veprimtarinë. Ai qe një patriot i shquar dhe luftëtar i zjarrtë për pavarësinë kombëtare, tërësinë tokësore, zhvillimin demokratik dhe lulëzimin e kulturës përparimtare. Ai bëri pjesë në atë rrymë, që vazhdoi, në kushtet e luftës së popullit shqiptar për pavarësi, tërësi tokësore dhe pushtet demokratik, epokën e Rilindjes shqiptare. Si veprimtar patriot, dijetar dhe artist, ai u rrit në gjirin e lëvizjes demokratike revolucionare antifeydale dhe antiimperialiste, përparoi me të dhe i dha një shtytje të mëtejshme mendimit, diturisë, kulturës dhe artit përparimtar shqiptar, duke arritë deri në përkrahjen morale të Luftës nacionalçlirimtare dhe të revolucionit tonë demokratik popullor.

Ne çmojmë lartë kontributin e tij të shquar, me veprat më të shëndosha, në fushën e poezisë dhe të prozës artistike, të fletorizmit dhe të gojëtarisë, të dramaturgjisë dhe të shqipërimit, të historishkrimit dhe të mendimit kritik letrar, të kompozimit dhe të mendimit kritik muzikor, të gjuhës letrare dhe të stilistikës poetike. Por në jetën dhe në veprimtarinë e tij, në botëkuptimin e tij filozofik dhe në krijimtarinë e tij të shumanshme, ne hasëm edhe mjaft anë negative, që rrjedhin nga presioni i ide-

ologjive sunduese borgjeze, nga pikëpamje jo të drejta rreth luftës së klasave dhe nga të meta të ndryshme të karakterit subjektiv. Këto anë negative, pikëpamje dhe veprime jo të drejta, ne i kritikojmë, sepse janë të huaja për masat punonjëse, që ndërtojnë socializmin.

Me veprat e veta më të shquara Fan S. Noli pauroi thesarin e kulturës demokratike shqiptare dhe ushtroi një ndikim të dukshëm në zhvillimin e saj të mëtejshëm, që nga vitet 20-të të shekullit tonë, duke qenë kurdoherë një ndërlidhës i denjë i Rilindjes me të sotmen, i klasikës me modernen, i traditës me novatoren.

Me veprat e veta më të shëndosha, ai qëndron si një nga përfaqësuesit më me emër të gjenisë shqiptare në botë, si një nga ata autorë, veprat e të cilëve, pasi kanë hedhë disa themele në kulturën kombëtare, kanë dalë jashtë megjeve të atdheut dhe, në mënyrë modeste por të dukshme, kanë zënë vend në radhën e kontributit që popujt e ndryshëm, të mëdhenj dhe të vegjël, kanë sjellë dhe sjellin në visarin e përbashkët të kulturës botërore.

---

1 «Manchester Guardian», 27 qershor 1924, sp. «Ligjëron Fan Noli», f. 6.

2 Newman Ernest, në «Sunday Times», 26 mars 1950, sp. «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 54.

3 Brahimi R., «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 23

4 Agolli D., *Një mësonjës i madh i vargut*, «Nëndori», Nr. 4, 1965

5 Kadare I., *Marathonomaku i madh*, «Drita», 21 mars 1965, f. 3.

6 Shuteriqi Dh. S., «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 19.

7 Çabej E.; «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 22.

8 Domi M., *Mjeshtri i madh i fjalës shqipe*, «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 27

- 9 Shaplllo D., *Krenohemi me emrin e madh të Fan Nolit*, «Nëndori» Nr. 4, 1965, f. 31.
- 10 *Ligjëron Fan Noli*, mbledhur nga Lefter L. Dilo, f. 17.
- 11 Shuteriqi Dh. S., «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 20.
- 12 *Ligjëron Fan Noli*, ff. 15-16.
- 13 «New York Times», sp. *Ligjëron Fan Noli*, f. 81
- 14 «Manchester Guardian», sp. *Ligjëron Fan Noli*, f. 7.
- 15 Kosova B., *Homazh artistit të madh*, «Drita», 21 mars 1965, f. 3.
- 16 Bulka N., *Noli na la...*, «Drita», 21 mars 1965, f. 3,
- 17 Rappaport Dr. A., sp. «Nëndori», Nr. 4. 1965, f: 56
- 18 Çabej E., «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 21
- 19 Shaplllo D., *Krenohemi me emrin e madh të Fan Nolit*, «Nëndori» Nr. 4, 1965, f. 31.
- 20 Buda A., «Nëndori», Nr. 4 1965 f. 26
- 21 Buda A., «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 26.
- 22 Buda A., *Gjergj Kastrioti — Skënderbeu dhe epoka e tij*, referat i mbajtur në emër të Institutit të historisë e të gjuhësisë të USHT, «Konferenca 11 e studimeve albanologjike», Tiranë, janar 1968, f. 22 (botim i poligrafuar).
- 23 Trako K., *Fan S. Noli — kompozitor dhe muzikolog*, «Nëndori», Nr. 4. 1965, f.23.
- 24 Sokoli R., *Fan S. Noli kompozitor dhe muzikolog* «Zëri i rinisë», 30. 9. 1970.
- 25 Trako K., *Fan S. Noli — kompozitor dhe muzikolog*, «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 24.
- 26 Sibelius Jan, sp. «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 54.
- 27 Shaw Georg Bernard, sp. «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 54.
- 28 Naun Thomas, sp. «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 54.
- 29 Squires Duane J., sp. «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 54,
- 30 Conant Prof. Kemeth, sp. «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 55
- 31 Moedly Prof. Robert, sp. «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 55,
- 32 Driu Kwater Prof. Geneva, sp. «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 54.
- 33 Domi M., *Mjeshtri i madh i fjalës shqipe*, «Nëndori», Nr. 4, 1965, f. 27.
-